


ZGJEDHJET 2025 NË SHQIPËRI: VULNERABILITETET NDAJ NDËRHYRJEVE TË HUAJA DHE MANIPULIMIT TË INFORMACIONIT



Dhjetor 2025

BIRN

Balkan
Investigative
Reporting
Network

ALBANIA

**ZGJEDHJET 2025
NË SHQIPËRI:
VULNERABILITETET
NDAJ NDËRHJRJEVE
TË HUAJA DHE
MANIPULIMIT TË
INFORMACIONIT**

Dhjetor 2025

Publikuar nga: Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri
Str. Nikolla Jorga, No. 8/8, Tirana, Albania

<http://birn.eu.com/>

Autorë: Kristina Voko
Besar Likmeta

Redaktorë: Megi Reçi
Marsida Gjoncaj

Përkthimi: Alma Koçi



Versioni elektronik i këtij botimi është i disponueshëm nën licencën Creative Commons Attribution-NonCommercial-ShareAlike 4.0. Ju mund ta kopjoni, shpërndani dhe transmetoni botimin, si dhe ta rimodeloni apo përshtasni, me kusht që përdorimi të jetë vetëm jofitimprurës, që t'i atribuoni në mënyrë të duhur botimit dhe që ta shpërndani nën të njëjtën licencë. Për më shumë informacion, vizitoni faqen zyrtare të Creative Commons: <http://creativecommons.org/licenses/by-nc-sa/4.0/>.

PERMBAJTJE

LISTA E SHKURTESAVE	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9
HYRJE	11
Qëllimi dhe metodologjia	12
HARTËZIMI I VULNERABILITETEVE TË FIMI-t ZGJEDHOR NË SHQIPËRI	15
Fusha 1: Vulnerabilitetet sistemike të procesit zgjedhor dhe besimit publik	15
Besimi i ulët në institucione	16
Rregullsia formale e procesit zgjedhor dhe pabarazia e garës	17
Delegjitimimi i konkurrencës politike përmes disinformimit dhe diskursit polarizues	21
Ndikimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit mbi procesin zgjedhor	26
Fusha 2: Kuadri rregullator dhe financimi i partive politike	28
Kuadër rregullator i paqëndrueshëm dhe reforma të vonuara	29
Boshllëqe në rregullimin e financimit të partive dhe fushatave	30
Mungesa e përafrimit me standardet ndërkombëtare	33
Fusha 3: Media dhe informacioni zgjedhor midis pluralizmit formal dhe rregullimit të fragmentuar	37
Mungesa e pluralizmit dhe pavarësisë së medias	38
Kuadër ligjor i kufizuar për median dhe mbulimin mediatik të fushatës	40
Reklamat politike audiovizive dhe deformimi i konkurrencës zgjedhore	43
Hapësira e parregulluar e medias online dhe ekspozimi ndaj disinformimit	47
Prania dhe ndikimi i mediave të huaja në hapësirën informative shqiptare	50

Fusha 4: Hapësira digjitale, platformat dhe rreziku i manipulimit të informacionit zgjedhor	52
Mungesa e kuadrit ligjor për rregullimin e platformave digjitale	53
Pabarazia në burime dhe kufizimet e vetërregullimit të fushatës digjitale	55
Mungesë transparence dhe llogaridhënieje për reklamat politike digjitale	58
Palët e treta dhe ndërhyrja jo-transparente në fushatat digjitale	61
Fusha 5: Digjitalizimi i proceseve zgjedhore dhe siguria kibernetike	64
Digjitalizimi i proceseve zgjedhore dhe rreziqet ndaj manipulimit të informacionit	65
Siguria kibernetike e infrastrukturës zgjedhore dhe ekspozimi ndaj sulmeve hibride	69
PËRFUNDIME	71

LISTA E SHKURTESAVE

AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
CEC	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
EEAS	Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm
FIMI	Manipulimi dhe ndërhyrja e huaj në informacion
International IDEA	Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore
LGBTQ+	Lezbike, gej, biseksualë, transgjinerë dhe queer
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 në Shqipëri u zhvilluan në një mjedis politik, mediatik dhe digjital që ka pësuar ndryshime të thella krahasuar me ciklet e mëparshme zgjedhore. Përtej sfidave tradicionale që lidhen me administrimin zgjedhor, barazinë e garës dhe transparencën financiare, këto zgjedhje u karakterizuan nga një ekspozim në rritje ndaj formave bashkëkohore të manipulimit të informacionit dhe ndërhyrjeve të huaja në mjedisin informativ. Ky raport analizon vulnerabilitetet sistemike që mund të shfrytëzohen për qëllime ndikimi malinj në procesin zgjedhor në Shqipëri, por nuk synon të evidentojë apo evidenton praninë e ndërhyrjes së huaj në çdo rast.

Analiza tregon se rreziqet e lidhura me Ndërhyrjet e Huaja dhe Manipulimin e Informacionit (FIMI) nuk shfaqen si fenomene të izoluar apo episodike, por si rezultat i ndërveprimit të dobësive strukturore në funksionimin dhe zbatimin e mekanizmave demokratikë. Kuadri ligjor dhe financiar i zgjedhjeve, mjedisi mediatik dhe digjital, dinamika e diskursit politik dhe shoqëror, si dhe dimensionet ndërkufitar të fushatës dhe komunikimit politik krijojnë së bashku një konfigurim që rrit vulnerabilitetin ndaj ndikimit të fshehtë, amplifikimit të koordinuar të narrativave dhe kontestimit të legjitimitetit të procesit zgjedhor.

Një nga gjetjet qendrore të raportit është se arkitektura rregullatore shqiptare ofron parime formale për integritetin zgjedhor, por mbetet pjesërisht e papërgatitur për t'iu përgjigjur ndaj realiteteve të fushatave moderne. Paqëndrueshmëria e kuadrit ligjor, ndryshimet e vonshme gjatë ciklit zgjedhor dhe boshllëqet në rregullimin e financimit politik dhe reklamimit digjital krijojnë pasiguri dhe pabarazi funksionale në garë. Këto dobësi nuk kanë vetëm implikime për barazinë e konkurrimit zgjedhor, por rrisin edhe leverdinë e ndikimit të maskuar përmes palëve të treta, rrjeteve "surrogatë" dhe shpenzimeve digjitale jo transparente.

Raporti evidenton se transparenca financiare funksionon kryesisht si mekanizëm procedural dhe *ex post* (pas përfundimit të procesit zgjedhor), jo si instrument i mirëfilltë llogaridhënieje gjatë periudhës kur ndikimi financiar është më intensiv (periudha para dhe gjatë fushatës). Raportimi i vonuar, auditimi pas përfundimit të garës dhe mungesa e sanksioneve dekurajuese krijojnë një kulturë të zbatimit formal të detyrimeve që rezultojnë në transparencë dhe llogaridhënie sipërfaqësore. Nga perspektiva e FIMI-t, kjo dobësi ka pasoja të dyfishta: nga njëra anë, krijon hapësira për financime dhe shpenzime të paidentifikueshme; nga ana tjetër, ushqen narrativa delegjitimuese që e paraqesin procesin zgjedhor si të manipuluar ose të kapur nga interesa keqdashës.

Mjedisi mediatik dhe digjital i përforcon këto rreziqe. Fragmentimi i burimeve të informacionit, polarizimi i diskursit dhe modeli ekonomik i bazuar në vëmendje krijojnë kushte ku përmbajtja emocionale, antagonistet ose manipulueset përhapet më shpejt dhe me më pak kosto. Mungesa e rregullimit për reklamën politike online, rolin e influencerëve dhe përdorimin e faqeve ndërmjetëse e zbehin kufirin midis komunikimit politik transparent dhe ndikimit të fshehtë.

Këto dinamika bëhen edhe më komplekse në kontekstin e fushatave që synojnë diasporën, ku natyra ndërkufitare e aktivitetit digjital e vështirëson identifikimin e burimeve të financimit dhe përgjegjësisë.

Një gjetje tjetër e rëndësishme lidhet me dimensionin ndërkombëtar të ndikimit politik, veçanërisht përmes lobimit jashtë vendit dhe përdorimit të shërbimeve profesionale të PR-it dhe komunikimit strategjik. Mungesa e një kuadri rregullator për lobimin dhe transparencën e aktiviteteve ndërkufitare të aktorëve politikë, krijon hapësira për projektimin e narrativave politike të kontestuara në arenën ndërkombëtare, veçanërisht në periudhën paszgjedhore. Këto praktika nuk synojnë domosdoshmërisht të ndryshojnë rezultatet zyrtare të zgjedhjeve, por të ndikojnë perceptimet, të sfidojnë legjitimitetin dhe të thellojnë polarizimin.

Duke u bazuar në metodologjinë globale të zhvilluar nga Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Ndihmë Zgjedhore (International IDEA), raporti identifikon se një pjesë e konsiderueshme e mundësuesve dhe nxitësve të FIMI-t zgjedhor janë të pranishëm në kontekstin shqiptar. Vulnerabilitetet e identifikuara kanë natyrë institucionale, rregullatore, mediatike, digjitale dhe shoqërore, ndërsa nxitësit ekonomikë dhe ndërkufitarë e bëjnë manipulimin informativ jo vetëm të mundshëm, por edhe të leverdishëm. Në këtë kontekst, rreziku i FIMI-t nuk lidhet me një dobësi të vetme, por me efektin kumulativ të disa faktorëve që ndërveprojnë dhe përforcojnë njëri-tjetrin.

Si përfundim, gjetjet e këtij raporti tregojnë se rezilienca zgjedhore në Shqipëri mbetet e pjesshme dhe e pabarabartë. Sistemi zgjedhor është më i përgatitur për të adresuar shkeljet klasike dhe formale, por më pak i pajisur për të përballuar format hibride të ndikimit që kombinojnë financimin jo-transparent, amplifikimin digjital, ndërmjetësimin narrativ dhe veprimin ndërkufitar. Në këtë kuptim, FIMI nuk shfaqet si një kërcënim i jashtëm i shkëputur nga realiteti vendor, por si një fenomen që shfrytëzon boshllëqe ekzistuese dhe i kthen ato në rreziqe demokratike.

Ky raport ofron një bazë analitike për të zgjeruar kuptimin e këtyre dinamikave dhe për të reflektuar mbi mënyrat se si integriteti zgjedhor dhe rezilienca demokratike mund të forcohen në të ardhmen. Duke dokumentuar vulnerabilitetet e shfaqura gjatë zgjedhjeve të vitit 2025, ai synon të kontribuojë në një debat më të informuar publik dhe institucional mbi mbrojtjen e proceseve zgjedhore nga manipulimi informativ dhe ndërhyrjet e huaja, në një mjedis gjithnjë e më kompleks dhe të ndërlidhur.

HYRJE

Zgjedhjet përbëjnë mekanizmin themelor përmes të cilit qytetarët ushtrojnë sovranitetin e tyre politik, zgjedhin përfaqësuesit dhe mbajnë përgjegjësinë përfaqësuesit e tyre në pushtet. Përtej funksionit të tyre procedural, zgjedhjet janë burimi kryesor i legjitimitetit demokratik, pasi garantojnë një transferim paqësor të pushtetit dhe përforcojnë besimin publik në institucionet shtetërore. Për këtë arsye, integriteti i proceseve zgjedhore i bazuar në parimet e barazisë së garës, transparencës, gjithëpërfshirjes dhe besueshmërisë së informacionit publik, është thelbësor për funksionimin e një demokracie.

Në Shqipëri, këto parime janë të sanksionuara në Kushtetutë¹ dhe në Kodin Zgjedhor², të cilat parashikojnë se qeverisja demokratike mbështetet në zgjedhje të lira dhe të ndershme, ku vota pasqyron vullnetin e qytetarëve. Në terma formalë, kuadri ligjor shqiptar është në përputhje të përgjithshme me standardet bazë ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Megjithatë, tashmë zgjedhjet nuk përballen më vetëm me rreziqe tradicionale të manipulimit, presionit ose shkeljeve procedurale nga aktorë vendas. Ato zhvillohen gjithnjë e më shumë në një mjedis informacioni të fragmentuar, digjital dhe ndërkufitar, ku ndikimi politik mund të ushtrohet në mënyra indirekte, të padukshme dhe të vështira për t'u atribuar.

Në këtë kontekst, FIMI konsiderohet nga studiuesit si një nga rreziqet më serioze për proceset demokratike në nivel global. Sipas përkufizimit të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm European (EEAS), FIMI përfaqëson sjellje të koordinuara, manipuluese dhe të qëllimshme nga aktorë të huaj–shtetërorë ose jo-shtetërorë, përfshirë aktorë ndërmjetës–që synojnë të ndikojnë negativisht mjedisin informativ, proceset politike dhe institucionet demokratike të një vendi.³ Në periudhat zgjedhore, këto ndërhyrje mund të shtrembërojnë debatin publik, të thellojnë polarizimin, të minojnë besimin në institucione dhe, në fazën paszgjedhore, të kontestojnë legjitimitetin e rezultateve.

Shqipëria nuk është imune ndaj këtyre zhvillimeve. Gjatë dekadës së fundit, vendi ka përjetuar një sërë episodesh që kanë ekspozuar vulnerabilitete strukturore ndaj ndikimit të huaj dhe manipulimit të informacionit: nga lobimet e dyshimta dhe financimet jotransparente, te sulmet kibernetike të shoqëruara me fushata dezinformuese dhe përdorimi i rrjeteve sociale dhe mediave për amplifikimin e narrativave polarizuese. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 u zhvilluan në

¹ Republika e Shqipërisë. (1998). *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë* (Ligji nr. 8417, 21 tetor 1998, i ndryshuar). <https://kqz.gov.al/pdf/kushtetuta-ndryshuar.pdf>

² Republika e Shqipërisë. (2008). *Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë* (Ligji nr. 10 019, 29 dhjetor 2008, i amenduar). <https://kqz.gov.al/pdf/kodi-zgjedhor.pdf>

³ European External Action Service. (2025). *2024 Report on EEAS Activities to Counter Foreign Information Manipulation and Interference (FIMI)* [Raporti i vitit 2024 mbi aktivitetet e EEAS në luftën kundër manipulimit dhe ndërhyrjes së huaj informative (FIMI)]. <https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/2025/documents/2024%20Report%20on%20EEAS%20Activities%20to%20Counter%20FIMI.pdf>

këtë mjedis kompleks, të karakterizuar nga polarizim i lartë politik, transformim i shpejtë i fushatave në hapësirën digjitale dhe me një dimension të ri të fushatës drejt diasporës. Investigimet mbi reklamat e fshehta dhe/ose të financuara në mënyrë jotransparente nga palë të treta për të ndikuar në votën e diasporës, ilustrojnë qartë vështirësitë e atribuimit të përgjegjësisë dhe transparencës në këtë hapësirë.^{4 5}

Në të njëjtën kohë, vlerësimet ndërkombëtare për zgjedhjet e fundit në Shqipëri theksojnë se, pavarësisht disa ndryshimeve, boshllëqe të rëndësishme mbeten të pranishme dhe ndikojnë barazinë e garës dhe transparencën—përfshirë aspekte që lidhen me financimin e fushatës, mbulimin mediatik, si dhe zbatimin/operacionalizimin e disa rekomandimeve të mëparshme.⁶ Ndaj, një vlerësim i strukturuar i vulnerabiliteteve ndaj FIMI-t është i domosdoshëm për të kuptuar jo vetëm ngjarjet ose rastet ilustruese, por gjithashtu kushtet sistemike që e bëjnë mjedisin zgjedhor më të ekspozuar ndaj ndërhyrjeve informative dhe ndikimeve të huaja.

Qëllimi dhe metodologjia

Ky raport është hartuar nga BIRN Albania për të ofruar një analizë të thelluar dhe të krahasueshme në nivel ndërkombëtar të vulnerabiliteteve të Shqipërisë ndaj FIMI-t zgjedhor, duke u bazuar në metodologjinë globale të zhvilluar nga International IDEA.⁷ Kjo metodologji është projektuar si një mjet analitik për aktorët kombëtarë—veçanërisht organizatat e shoqërisë civile—për të kuptuar se cilat kushte e bëjnë një proces zgjedhor të cenueshëm ndaj manipulimit informativ dhe ndërhyrjes së huaj, dhe si këto kushte ndërveprojnë me njëra-tjetrën.

Metodologjia e International IDEA identifikon dy kategori kryesore faktorësh:

- faktorë mundësues që përfaqësojnë kushte strukturore ose institucionale që krijojnë terren të favorshëm për FIMI; dhe

⁴ Likmeta, B. (2025, 24 janar). Qiellgërvishtës dhe reklama: Fushata e fshehtë në Facebook për votën e Diasporës. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/01/24/qiellgervishtes-dhe-reklama-fushata-e-fshehte-ne-facebook-per-voten-e-diaspores/>

⁵ Likmeta, B. (2025, 12 prill). Takim ekskluziv: Edi Rama bën fushatë të financuar nga 'palë të treta' me diasporën. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/04/12/takim-ekskluziv-edi-rama-ben-fushate-te-financuar-nga-pale-te-treta-me-diasporen/>

⁶ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odihr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

⁷ International IDEA. (2025). *Analysing Enablers and Incentives of Election-Related Foreign Information Manipulation and Interference: A Global Methodology* [Analiza e faktorëve dhe nxitësve të manipulimit dhe ndërhyrjes së huaj të informacionit lidhur me zgjedhjet: Një metodologji globale]. <https://www.idea.int/publications/catalogue/analysing-enablers-and-incentives-election-related-foreign-information>

- faktorë nxitës ekonomikë, politikë ose operacionalë që e bëjnë ndërhyrjen të leverdishme për aktorët manipulues.

Në zbatim të kësaj metodologjie, BIRN Albania ka ndërthurur disa burime dhe metoda kërkimore. Analiza mbështetet në literaturë dhe dokumente parësore nga organizata ndërkombëtare—përfshirë raportet e Zyrës e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/OHHR) për zgjedhjet 2025, dokumente të EEAS mbi FIMI-n dhe metodologjinë e International IDEA-s—si dhe në gjetjet e monitorimit të vazhdueshëm të mjedisit mediatik dhe digjital gjatë periudhës parazgjedhore, fushatës dhe pas zgjedhjeve. Ky i fundit, ka mundësuar identifikimin dhe dokumentimin e praktikave konkrete, të dhënave të verifikueshme dhe modeleve të përsëritura që lidhen me vulnerabilitetet e shfaqura gjatë zgjedhjeve të vitit 2025.

Për më tepër, raporti përdor burime publike dhe investigime gazetareske, për të ilustruar hendekun midis rregullimit formal dhe funksionimit real të ekosistemit të ndikimit online, përfshirë dimensionin ndërkufitar dhe fushatat që synojnë diasporën. Gjetjet nga literatura u pasuruan më tej me të dhëna të ofruara nga organizatat vendase të përfshira në monitorimin e zgjedhjeve, si dhe të dhëna të ofruara nga vetë KQZ-ja. Për këtë arsye, para finalizimit të raportit, BIRN Albania organizoi një takim validues më 22 dhjetor 2025 me këta aktorë pranë ambienteve të KQZ-së.

Në këtë kuptim, pjesa analitike e raportit duhet lexuar si një diagnozë strukturore e vulnerabiliteteve që u shfaqën ose u konfirmuan gjatë zgjedhjeve të vitit 2025.

Në këtë raport, BIRN Albania është fokusuar në pesë fusha tematike: i) vulnerabilitete sistemike të procesit zgjedhor dhe besimit publik, ii) kuadri rregullator dhe financimi i partive, iii) media, rregullimi dhe informacioni zgjedhor, iv) hapësira digjitale, platformat dhe rreziku i manipulimit të informacionit zgjedhor, v) digjitalizimi i proceseve zgjedhore dhe siguria e sistemeve. Po ashtu janë identifikuar dhe analizuar 18 vulnerabilitete kryesore, të përzgjedhura në bazë të zbatueshmërisë së tyre për kontekstin shqiptar sipas evidencave të mbledhura gjatë ciklit zgjedhor 2025. Në fund të analizës së secilit vulnerabilitet, raporti bën një lidhje të qartë me elementët përkatës të metodologjisë së IDEA-s, duke specifikuar se cilët mundësues dhe/ose nxitës reflektohen në praktikë dhe si këta faktorë globalë manifestohen në mënyrë të kontekstualizuar në Shqipëri. Për të orientuar leximin e raportit, lista e plotë e **16 mundësuesve dhe 6 nxitësve të FIMI-t sipas International IDEA paraqitet në Grafikon 1 në vijim.**

Grafiku 1: Faktorët mundësues të FIMI-t zgjedhor

Mundësuesi 1. Mungesë sistematike e besimit tek institucionet demokratike

Mundësuesi 2. Rregullim i pamjaftueshëm mbi financimin politik

Enabler 3. Diskurs publik i polarizuar dhe i ndarë

Mundësuesi 4. Diskurs politik përjashtues dhe konfrontues

Mundësuesi 5. Prania e përfaqësuesve vendorë që veprojnë si *proxy*

Mundësuesi 6. Ndjeshmëria e audiencës ndaj manipulimit

Mundësuesi 7. Mungesë e pluralizmit dhe pavarësisë së mediave

Mundësuesi 8. Ndikimi i mediave të lidhura me interesa të huaja

Mundësuesi 9. Gazetari e dobët dhe standarde të ulëta gazetareske

Mundësuesi 10. Gazetari e dobët dhe standarde të ulëta gazetareske

Mundësuesi 11. Mjedisë digjitale të fragmentuara të informacionit


Mundësuesi 12. Mundësia për t'u shfrytëzuar e teknologjive digjitale dhe të rrjeteve sociale

Mundësuesi 13. Politika jo të qëndrueshme dhe të buta të moderimit

Mundësuesi 14. Autoritete rregullatore joefektive

Mundësuesi 15. Boshllëqe në rregullimin e medias dhe internetit

Mundësuesi 16. Zbatim i paqartë i normave ndërkombëtare



Metodologjia ofron një kornizë analitike të strukturuar dhe të bazuar në vlerësimin e rrezikut, por nuk synon të verifikojë në mënyrë empirike praninë, autorësinë apo ndikimin e matshëm të ndërhyrjeve të huaja në informacion. Në të njëjtën linjë, raporti nuk synon të vërtetojë në mënyrë empirike ndërhyrje konkrete, por të ofrojë një analizë sistematike të kontekstit politik, institucional, mediatik dhe shoqëror, me qëllim identifikimin e faktorëve strukturorë që krijojnë kushte favorizuese për ndërhyrjet e mundshme në proceset zgjedhore. Vëmendja fokusohet te vulnerabiliteti dhe mekanizmat përmes të cilëve aktorë të jashtëm, drejtpërdrejtë ose nëpërmjet rrjeteve ndërmjetëse vendase, mund të ndikojnë në formësimin e debatit publik, të intensifikojnë polarizimin politik dhe të minojnë besimin në institucionet dhe procedurat demokratike.

Duke qenë se analiza mbështetet kryesisht në qasje cilësore dhe interpretime të varura nga konteksti, gjetjet e raportit duhet të interpretohen si një vlerësim analitik i rrezikut dhe i nivelit të përgatitjes institucionale. Qëllimi përfundimtar është të kontribuojë në një kuptim më të thelluar të dinamikave dhe të rreziqeve, të informojë debatin publik dhe institucional, si edhe të shërbejë si bazë për forcimin e reziliencës demokratike të proceseve zgjedhore në Shqipëri.

HARTËZIMI I VULNERABILITETEVE TË FIMI-t ZGJEDHOR NË SHQIPËRI

Cikli zgjedhor i vitit 2025 ekspozoi disa vulnerabilitete strukturore të procesit zgjedhor dhe të mjedisit informativ në Shqipëri. Ky seksion fokusohet te “pikat e dobëta” të identifikuar (rregullatore, institucionale, financiare, mediatike dhe digjitale) që krijojnë hapësirë për ndërhyrje të mundshme malinje.

Gjetjet janë organizuar në pesë fusha analitike të përshtatura me kontekstin vendas, secila e ndarë në vulnerabilitetet identifikueshme dhe të përshkrueshme. Ky organizim synon të shmangë mbivendosjet midis temave dhe të ofrojë një lexim progresiv: nga kushtet bazë të integritetit zgjedhor dhe besimit publik, te kuadri rregullator dhe financimi politik, mjedisi mediatik dhe ai digjital dhe dimensionet ndërkufitare që shfaqen më qartë në fushatat digjitale (përfshirë komunikimin dhe targetimin e diasporës).

Në këtë mënyrë, seksioni i mëposhtëm sintetizon se ku ndodhen vulnerabilitetet kryesore, si ndërveprojnë ato dhe pse, në kushtet e një ekosistemi komunikimi gjithnjë e më të digjitalizuar.

Fusha 1

Vulnerabilitetet sistemike të procesit zgjedhor dhe besimit publik

Procesi zgjedhor në Shqipëri zhvillohet në një mjedis politik dhe institucional të karakterizuar nga besim i ulët publik ndaj institucioneve, kontestime të vazhdueshme mbi integritetin e garës dhe perceptime të përhapura për ndikim të faktorëve joformalë në konkurrencën politike. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, këto elemente u reflektuan si në diskursin parazgjedhor ashtu edhe në mënyrën se si u vlerësua dhe u interpretua procesi zgjedhor gjatë dhe pas ditës së votimit.

Vulnerabilitetet institucionale dhe tensionet politike krijojnë një mjedis ku narrativa për pabarazi të garës, manipulim dhe mungesë legjitimiteti gjejnë terren të favorshëm për t’u përhapur. Në këtë kontekst, manipulimi i informacionit dhe ndërhyrjet e mundshme informative nuk operojnë në vakum, por ndërveprojnë me mosbesimin ekzistues, polarizimin politik dhe perceptimet për korrupsion dhe ndikim kriminal në zgjedhje.

Kjo fushë analizon katër vulnerabilitete kryesore:

- besimin e ulët në institucione;

- vlerësimin e procesit zgjedhor dhe pabarazinë e perceptuar të garës politike;
- delegjitimimin e konkurrencës politike përmes disinformimit dhe diskursit polarizues; dhe
- ndikimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit zgjedhor mbi procesin zgjedhor.

Së bashku, këto vulnerabilitete kontribuojnë në një mjedis politik ku procesi zgjedhor shihet si i kontestueshëm dhe i ekspozuar ndaj ndikimeve të padrejta, duke rritur ndjeshmërinë ndaj ndërhyrjeve informative që synojnë të minojnë besimin publik dhe stabilitetin demokratik.

Besimi i ulët në institucione

**Besimi i ulët
në institucione
krijon terren të
favorshëm për
FIMI të lidhur me
zgjedhjet.**

Besimi publik në institucionet publike në Shqipëri është i ulët dhe përbën një nga vulnerabilitetet kryesore për integritetin zgjedhor. Raporti i Komisionit Evropian për Shtetin e së Drejtës (2025) thekson se niveli i ulët i besimit në institucione ushqehet nga procese të zgjata gjyqësore, rezultate të pabarabarta në proceset llogaridhënëse dhe mungesa e transparencës në ndjekjen e akuzave ndaj zyrtarëve publikë.⁸ Edhe pse raporti nuk kryen një vëzhgim zgjedhor në kuptimin e ngushtë, ai nënvizon se besueshmëria institucionale mbetet veçanërisht e brishtë në çështje politikisht të ndjeshme, pikërisht ato që gjatë periudhave zgjedhore përdoren për të certifikuar, kontestuar ose delegjitimuar rezultatet dhe proceset. Në këtë kuptim, vulnerabilitetet e shtetit të së drejtës nuk janë thjesht problem i qeverisjes së përditshme, por ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si perceptohet drejtësia dhe legjitimiteti i zgjedhjeve.

Ky vlerësim përforcohet nga Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë i vitit 2025, i cili konstaton se besimi publik në institucionet demokratike mbetet i kufizuar për shkak të perceptimit të politizimit të institucioneve dhe mungesës së ndëshkueshmërisë efektive për shkeljet.⁹ Në një kontekst të tillë, institucionet zgjedhore, organet e drejtësisë dhe mekanizmat mbikëqyrës nuk perceptohen gjithmonë si arbitra të pavarur, por si aktorë të ekspozuar ndaj presioneve politike. Kjo situatë krijon një hendek mes legjitimitetit formal dhe legjitimitetit të perceptuar: edhe kur procedurat ndiqen, rezultati nuk gëzon domosdoshmëri besim shoqëror.

Treguesit ndërkombëtarë të qeverisjes dhe besimit publik e konfirmojnë këtë

⁸ European Commission. (2025). *Rule of Law Report 2025 – Chapter on Albania* [Raporti për Sundimin e Ligjit 2025 – Kapitulli për Shqipërinë]. https://commission.europa.eu/document/download/3732ae59-5ab4-48a6-a3e6-0ef9aa593863_en

⁹ European Commission. (2025). *Report on Albania 2025* [Raporti për Shqipërinë 2025]. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en

prirje afatgjatë.¹⁰ Indekset e Transparency International dhe Freedom House vazhdojnë të evidentojnë probleme serioze me perceptimin e korrupsionit, kapjen e institucioneve dhe cilësinë e demokracisë, ndërsa studimet më të fundit tregojnë se edhe grupmoshat e reja, përfshirë të rinjtë dhe votuesit për herë të parë, shfaqin një kombinim shqetësues të entuziazmit normativ për demokracinë dhe mosbesimit praktik ndaj institucioneve që e administrojnë atë.^{11 12} Analizat e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) mbi administratën publike në Shqipëri theksojnë gjithashtu se vulnerabilitetet në profesionalizëm, transparencë dhe llogaridhënie vazhdojnë të minojnë besimin qytetar.^{13 14} Në një mjedis të tillë, mosbesimi institucional nuk është thjesht tipar kontekstual, por një faktor aktiv që e bën publikun më të ndjeshëm ndaj narrativave delegjitime, veçanërisht gjatë zgjedhjeve.

Ky vulnerabilitet lidhet drejtpërdrejt me **Mundësuesin 1. Mungesë sistematike e besimit tek institucionet demokratike** sipas metodologjisë së International IDEA. Një mjedis i tillë mosbesimi nuk gjeneron vetë FIMI-n, por e mundëson atë strukturalisht, duke rritur gatishmërinë e publikut për të pranuar dhe amplifikuar interpretime manipuluese të procesit zgjedhor.

Rregullsia formale e procesit zgjedhor dhe pabarazia e garës

Në vlerësimin e përgjithshëm, zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 u administruan në mënyrë kryesisht të rregullt dhe u zhvilluan në një kuadër që lejon “përgjithësisht zgjedhje të lira dhe të ndershme”, por u shoqëruan nga një seri problemesh të përsëritura që e dobësojnë cilësinë e garës dhe rrisin vulnerabilitetin ndaj manipulimit informativ. OSBE/ODIHR e përmbledh këtë dualitet duke evidentuar se zgjedhjet ishin konkurruese dhe të organizuara profesionalisht, por u zhvilluan pa një fushë loje të barabartë, me shqetësime për abuzimin me burimet publike, presion ndaj votuesve/

Rregullsia
procedurale
pa barazi
konkurruese
dobëson
qëndrueshmërinë
zgjedhore.

¹⁰ IDM. (2024). *Trust in Governance 2023 | Annual Public Opinion Poll in Albania* [Besimi në qeverisje 2023 | Anketa vjetore e opinionit publik në Shqipëri]. <https://idmalbania.org/publication-cpt/trust-in-governance-2023-annual-public-opinion-poll-in-albania/>

¹¹ Transparency International. (2025). *Corruption Perceptions Index 2024–2025: Albania* [Indeksi i perceptimit të korrupsionit 2024–2025: Shqipëria]. Berlin. <https://www.transparency.org/en/cpi>

¹² Freedom House. (2025). *Nations in Transit 2025: Albania* [Kombe në tranzit 2025: Shqipëria]. Washington, DC. <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2025>

¹³ OECD. (2025). *Public Administration in Albania 2024* [Administrata publike në Shqipëri 2024]. Paris: OECD Publishing. https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2025/01/public-administration-in-albania-2024_9ec56245/5577d117-en.pdf

¹⁴ Regional Cooperation Council (RCC). (2024). *Balkan Barometer 2024 – Public Opinion* [Balkan Barometer 2024 – Opinionet e publikut]. Sarajevo. <https://www.rcc.int/download/docs/BB2024-PO.pdf/c29cfed20c3776d280077cd17abc.pdf>

punonjësve të administratës publike dhe me boshllëqe të mbetura në zbatimin e rekomandimeve të hershme të OSBE/ODIHR për reformën zgjedhore.¹⁵

Të njëjtat shqetësime evidentohen qartë edhe në gjetjet e Komisionit Evropian për Shqipërinë: kuadri në tërësi mundëson zgjedhje “përgjithësisht të lira e të ndershme”, por ka mangësi të përsëritura si mungesa e fushës së barabartë të lojës, abuzimi me burimet publike, dhe fakti që reforma zgjedhore mbeti e pjesshme dhe nuk adresoi një numër rekomandimesh afatgjata¹⁶.

Në kontekstin e rreziqeve të FIMI-t, një vlerësim “proceduralisht i rregullt” i procesit zgjedhor nuk mjafton: nëse aktorët dhe publiku e perceptojnë garën si strukturalisht të pabarabartë, çdo incident (edhe kur është i izoluar) ka potencial të shndërrohet në “provë” për narrativa delegjitimimi, duke ulur pranimin shoqëror dhe duke rritur polarizimin.

Gjatë fushatës së vitit 2025, BIRN monitoroi dhe dokumentoi një seri praktikash që e materializojnë “pabarazinë e fushës së lojës” si përvojë konkrete të kandidatëve dhe votuesve. Raportimet mbi përdorimin e administratës dhe institucioneve publike për funksione që përngjasojnë me fushatë (p.sh. evente të prezantuar si “takime pune”, përdorim i faqeve zyrtare institucionale për komunikim propagandistik, apo angazhimi i drejtuesve të administratës publike si pjesë e “makinerive zgjedhore”) ilustrojnë se si avantazhi institucional kthehet në avantazh komunikimi, me efekt zinxhir në mbulimin mediatik dhe në aftësinë e subjekteve të tjera opozitare për të konkurruar në kushte të krahasueshme.¹⁷

Në të njëjtën linjë, raportimet mbi “patronazhimin” dhe presionin e perceptuar në nivel lokal e përkthejnë problematikën nga një debat abstrakt rregullator në një shqetësim të prekshëm kontrolli dhe varësie, i cili ndërvepron me gatishmërinë e qytetarëve për të marrë pjesë lirshëm ose për të besuar se vota e tyre është e barabartë.¹⁸

Gjithashtu, masat me efekt të drejtpërdrejtë social-ekonomik pranë ditës së zgjedhjeve—si përdorimi i “kartës” së faljes së gjobave dy ditë para zgjedhjeve—ushqejnë perceptimin se shteti dhe politika ndërthuren në mënyrë instrumentale në funksion të rezultatit, duke e bërë më të lehtë që aktorët politikë ose rrjetet online të prodhojnë narrativa për “blerje/ndikim vote” dhe “shtet elektoral”, pavarësisht kompleksitetit ligjor të çdo rasti.¹⁹

¹⁵ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odihr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

¹⁶ European Commission. (2025). *Report on Albania 2025* [Raporti për Shqipërinë 2025]. Bruksel. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en

¹⁷ Erebara, Gj. (2025, 20 shkurt). Miting elektoral i prezantuar si takim pune, Rama hap fushatën me punëtorët e bashkisë. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/02/20/miting-elektoral-i-prezantuar-si-takim-pune-rama-hap-fushaten-me-punetoret-e-bashkise/>

¹⁸ Erebara, GJ. (2025, 1 maj). Zgjedhje nën hijen e patronazhistit në Fier. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/01/zgjedhje-nen-hijen-e-patronazhistit-ne-fier/>

¹⁹ Gjoka, B. (2025, 9 maj). Rama luan kartën e faljes së gjobave 2 ditë para zgjedhjeve. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/09/rama-luan-karten-e-faljes-se-gjobave-2-dite-para-zgjedhjeve/>

Këto elemente, të marra së bashku, e zhvendosin vlerësimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme nga një pyetje vetëm procedurale në një çështje legjitimiteti publik: sa më i madh të jetë hendeku mes rregullit formal dhe përjetimit të pabarazisë në terren, aq më i lartë bëhet vulnerabiliteti ndaj manipulimit informativ.

Një shtresë tjetër e këtij vulnerabiliteti lidhet me pavarësinë dhe efektivitetin e institucioneve mbikëqyrëse ndaj këtyre proceseve. Komisioni Evropian evidenton se polarizimi politik dhe politizimi në emërime në institucione të pavarura mbeten problematikë dhe mbikëqyrja parlamentare e ekzekutivit është e dobët—kushte që dëmtojnë, ndër të tjera, perceptimin e neutralitetit institucional në momente zgjedhore.²⁰

Në praktikë, ky kontekst krijon një hapësirë të lirë që aktorë të interesuar ta paraqesin çdo vendimmarrje, çdo vonesë, ose çdo interpretim proceduror si të motivuar politikisht. Kjo lidhet drejtpërdrejt me logjikën e FIMI-t: kur standardet perceptohen si të paqarta ose të pazbatuara në mënyrë të barabartë, informacioni manipulativ nuk ka nevojë të provojë një mashtrim specifik; mjafton të nxisë dyshim se “sistemi është i kapur”.

Ky vulnerabilitet ndërthuret kryesisht me **Mundësuesin 1. Mungesë sistematike e besimit tek institucionet demokratike** dhe **Mundësuesin 2. Rregullim i pamjaftueshëm mbi financimin politik**. Përdorimi i burimeve shtetërore, presioni administrativ dhe zbatimi i pabarabartë i rregullave të fushatës kontribuojnë në perceptimin se konkurrenca politike nuk zhvillohet në kushte të barabarta. Edhe kur procedurat formale respektohen, hendeku mes rregullimit ligjor dhe praktikës ushqen dyshimin publik mbi integritetin e procesit. Ky hendek krijon kushte të favorshme për instrumentalizim informativ, pasi incidentet reale ose të perceptuara përdoren për të mbështetur narrativa se zgjedhjet janë të paracaktuara ose të manipuluar.

Rasti ilustrues në vijim ilustron se si vulnerabilitetet në administrimin, komunikimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore gjatë fazës pas-zgjedhore të vitit 2025 e shndërruan një proces formal ligjor në një burim të zgjatur pasigurie dhe mosbesimi publik, duke krijuar hapësirë për kontestim dhe narrativa delegjitimimi të procesit zgjedhor.

²⁰ European Commission. (2025). *Report on Albania 2025* [Raporti për Shqipërinë 2025]. Bruksel. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en

Rast ilustrues: Kundërshtitë mbi rezultatet zgjedhore dhe procesi i rinumërimit

Gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025, vulnerabiliteti kryesor ndaj manipulimit të informacionit nuk lidhej me një incident të vetëm, por me dinamikën e zgjatur dhe të paqartë të fazës pas-zgjedhore. Numërimi i vonuar i votës së diasporës, volumi i lartë i ankimeve, vendimmarrja e fragmentarizuar institucionale dhe rinumërimet selektive krijuan një cikël të gjatë pasigurie procedurale, i cili u reflektua drejtpërdrejt në debatin publik dhe u shfrytëzua për narrativa delegjitimimi.²¹

Zgjatja e procesit të numërimit²², e shoqëruar me mungesë komunikimi të qartë institucional, rriti hapësirën për spekulime dhe dyshime mbi integritetin e zgjedhjeve. Ankesa të artikuluara politikisht dhe tërheqja e tyre pas sinjaleve nga lidhshipi i partive politike²³ forcuan perceptimin e politizimit të mekanizmave ligjorë. Rinumërimet, ndonëse teknikisht të justifikuar, u perceptuan si vazhdim i betejës politike, duke e mbajtur rezultatin “të hapur” për kontestim.²⁴

Zbulimi i mospërputhjeve konkrete gjatë rinumërimit në Fier, edhe pse i lokalizuar, u shndërrua në provë simbolike për narrativa më të gjera mbi manipulim sistemik, ndërsa reagimet relativizuese ushqyen më tej cinizmin publik. Edhe pas certifikimit të rezultateve²⁵ ²⁶, vazhdimi i ankimimeve dhe kritikave institucionale nxori në pah hendekun mes legjitimitetit formal dhe legjitimitetit të perceptuar.²⁷ ²⁸

Në tërësi, rasti tregon se vulnerabilitetet procedurale dhe mangësitë në komunikimin me publikun gjatë fazës pas-zgjedhore, në një kontekst polarizimi dhe besimi të ulët institucional, mund të shndërrohen lehtësisht në vulnerabilitete, duke krijuar terren të favorshëm për manipulim të informacionit dhe minim të besimit publik në procesin zgjedhor.

²¹ Gjoka, B. (2025, 28 gusht). Certifikohet rezultati i zgjedhjeve, por kontestimet vazhdojnë. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/08/28/certifikohet-rezultati-i-zgjedhjeve-por-kontestimet-vazhdojne/>

²² Gjoka, B. (2025, 17 qershor). Rinumërimi i kutive të 11 majit do të zgjasë deri në korrik. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/06/17/rinumerimi-i-kutive-te-11-majit-do-te-zgjase-deri-ne-korrik/>

²³ Gjoka, B. (2025, 20 maj). Pas mesazhit të Ramës, kandidatët e PS tërhiqen nga ankesat për votat. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/20/pas-mesazhit-te-rames-kandidatet-e-ps-terhiqen-nga-ankesat-per-votat/>

²⁴ Hoxhaj, E. (2025, 15 maj). Numërimi i votës së diasporës kthehet në një maratonë. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/15/numerimi-i-votes-se-diaspores-kthehet-ne-nje-maratone/>

²⁵ Gjoka, B. (2025, 1 shtator). PD kërkon anulimin e rezultatit të 11 majit në Kolegjin Zgjedhor. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/09/01/pd-kerkon-anulimin-e-rezultatit-te-11-majit-ne-kolegjin-zgjedhor/>

²⁶ Gjoka, B. (2025, 7 tetor). Opozita kritikon rolin e KQZ në zgjedhjet e 11 majit. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/10/07/opozita-kritikon-rolin-e-kqz-ne-zgjedhjet-e-11-majit/>

²⁷ Gjoka, B. (2025, 2 korrik). Rinumërimi në Fier zbulon trafikim votash brenda listave të hapura të PS dhe PD. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/07/02/rinumerimi-ne-fier-zbulon-trafikim-votash-brenda-listave-te-hapura-te-ps-dhe-pd/>

²⁸ Karaj, V. (2025, 2 korrik). Balluku fajëson lodhjen e numëruesve për tjetërsimin e qindra votave në Fier. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/07/02/balluku-fajeson-lodhjen-e-numeruesve-per-tjetersimin-e-qindra-votave-ne-fier/>

Delegjitimimi i konkurrencës politike përmes disinformimit dhe diskursit polarizues

Polarizimi strukturor amplifikon disinformimin delegjitimues mbi zgjedhjet.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 u zhvilluan në një mjedis diskutimi publik të karakterizuar nga polarizim i thellë politik, fragmentarizim i informacionit dhe një kulturë e rrënjosur e komunikimit konfrontues. Raporti i OSBE/ODIHR vëren se konkurrenca politike u zhvillua në një klimë ku retorika përjashtuese, sulmet personale dhe narrativa delegjitimuese zëvendësuan shpesh debatin programor, ndërsa qasja e votuesve në informacion të pavarur dhe të larmishëm u kufizua nga një mjedis mediatik i përqendruar dhe politikisht i varur.²⁹ Në të njëjtën linjë, raporti i Komisionit Evropian konstaton se polarizimi politik dhe mungesa e dialogut konstruktiv vazhdojnë të minojnë cilësinë e procesit demokratik, duke ndikuar jo vetëm funksionimin institucional, por edhe perceptimin publik mbi legjitimitetin e aktorëve politikë dhe vetë zgjedhjeve.³⁰

Ky diskurs i polarizuar nuk është episodik, por strukturor dhe i rrënjosur. Trashëgimia e periudhës totalitare, e karakterizuar nga besnikëria ndaj liderit, patronazhi politik dhe ndarja binare “ne kundër atyre”, ka prodhuar një diskurs publik ku shumë çështje politike, shoqërore apo institucionale filtrohet përmes identitetit partiak. Tema si integrimi në BE, reforma në drejtësi, korrupsioni, identiteti fetar, barazia gjinore dhe të drejtat e komunitetit LGBTQ+ shndërrohen rregullisht në pika ndezëse emocionale, të cilat aktorë politikë dhe ndërmjetësit digjitalë i përdorin për mobilizim, polarizim dhe diskreditim.

Analiza cilësore e monitorimit të medias audiovizive gjatë fushatës zgjedhore tregon se emisionet politike dhe formatet e debatit kontribuuan në këtë fragmentarizim përmes strukturave konfrontuese, përzgjedhjes të një numri të kufizuar aktorësh dhe kornizimit të çështjeve si përplasje morale ose identitare, jo si debate politike të bazuara në politika publike.³¹ Në vend që të funksiononin si hapësira për pluralizëm dhe ndërmjetësim informativ, shumë formate mediatike riprodhuan dhe amplifikuan ndarjet ekzistuese, duke normalizuar një gjuhë delegjitimimi dhe duke lënë pak hapësirë për aktorë alternativë, parti të vogla ose zëra kritikë. Një prirje e ngjashme u evidentua edhe në mediat online, ku mbulimi u dominua nga deklarata politike, kundërdeklarata dhe opinione, shpesh të shkëputura nga verifikimi faktik dhe nga konteksti i gjerë politik.³² Ky

²⁹ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odhr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

³⁰ European Commission. (2025). *Report on Albania 2025* [Raporti për Shqipërinë 2025]. Bruksel. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en

³¹ Voko, K., Lelo, E., & Shehu, J. (2025). *Audiovisual Media Monitoring Report: Parliamentary Elections in Albania 2025* [Monitorimi i mediave audiovizive: Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri 2025]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/12/Audiovisual-Media-Monitoring-ENG.pdf>

³² Voko, K., Babameto, S. & Keta, V. (2025). *Online Media Monitoring during the 2025 Parliamentary Elections* [Monitorimi i mediave online gjatë zgjedhjeve parlamentare 2025]. BIRN Albania. Tiranë. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/12/Online-Media-Monitoring-ENG.pdf>

Iloj mbulimi krijoi “ishuj narrativë” dhe përforcoi logjikën e ofrimit të informacionit të fragmentuar, ku audiencat ekspozohen kryesisht ndaj përmbajtjeve që konfirmojnë bindjet ekzistuese.

Kjo klimë e diskutimit publik ndërvepron drejtpërdrejt me faktorë të tjerë që rrisin ndjeshmërinë e publikut ndaj manipulimit, si edukimi i ulët mediatik. Shqipëria renditet ndër shoqëritë më pak rezistente ndaj disinformimit në Evropë, sipas Media Literacy Index 2023, duke reflektuar nivele të ulëta të aftësive kritike mediatike, besim të kufizuar ndërpersonal dhe institucional, si dhe një mjedis me liri të kufizuar mediatike.³³ Studime të NATO-s dhe analiza rajonale tregojnë se audiencat shqiptare shfaqin predispozita ndaj autoritetit, konfirmimit të bindjeve ekzistuese dhe narrativave “ne kundër atyre”, të cilat mund të shfrytëzohen nga aktorë vendas ose të huaj për të amplifikuar mesazhe polarizuese dhe delegjitimuese.³⁴ Në këtë kuptim, diskursi polarizues nuk është thjesht një problem komunikimi politik, por një mundësues kyç i FIMI-t, që e bën hapësirën publike më pranuese dhe të ndjeshme ndaj disinformimit dhe manipulimit emocional.

Struktura e tregut mediatik e thellon më tej këtë vulnerabilitet. Sipas Komisionit Evropian dhe Media Pluralism Monitor, përqendrimi i lartë i pronësisë së medias, mungesa e transparencës së financimit dhe ndërthurja e interesave politike dhe ekonomike kanë dobësuar pluralizmin dhe pavarësinë editoriale të medias në Shqipëri.³⁵ OSBE/ODIHR thekson se gjatë zgjedhjeve të vitit 2025, qasja e votuesve në informacion të pavarur dhe të larmishëm u minua nga varësia e mediave ndaj interesave politike dhe të biznesit, si dhe nga shkeljet e përsëritura të rregullave për reklamimin dhe mbulimin zgjedhor.³⁷ Në këtë mjedis, mediat jo vetëm pasqyrojnë diskursin polarizues, por shpesh bëhen pjesë aktive e tij, duke ulur aftësinë e publikut për të dalluar mes informacionit, opinionit dhe propagandës.

Në këtë kontekst të fragmentarizuar dhe polarizues, aktorët e rinj politikë dhe gratë në politikë u shfaqën veçanërisht të ekspozuar ndaj praktikave delegjitimuese. Diskursi dominues, i ndërtuar rreth dy poleve (partive politike) kryesore, krijoi pak hapësirë për alternativa të reja dhe i kornizoi ato si jo-autentike, të dyshimta

³³ Open Society Institute – Sofia. (2023). *Media Literacy Index 2023: How Resilient Are European Societies to Disinformation* [Indeksi i alfabetizimit mediatik 2023: Sa rezistente janë shoqëritë evropiane ndaj dezinformimit]. <https://osis.bg/wp-content/uploads/2023/06/MLI-report-in-English-22.06.pdf>

³⁴ NATO Strategic Communications Centre of Excellence. (2020). *Russia's Footprint in the Western Balkans* [Gjurmët e Rusisë në Ballkanin Perëndimor]. Riga. <https://stratcomcoe.org/publications/russias-footprint-in-the-western-balkans/146>

³⁵ European Commission. (2025). *Report on Albania 2025* [Raporti për Shqipërinë 2025]. Bruksel. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en

³⁶ Likmeta, B., & Voko, K. (2025). *Monitoring Media Pluralism in the European Union: Results of the MPM2025 - Country report: Albania* [Monitorimi i Pluralizmit të Medias në Bashkimin Evropian: Rezultatet e MPM2025 – Raporti i Shqipërisë]. European University Institute, Centre for Media Pluralism and Media Freedom (CMPF). Florence. <https://cadmus.eui.eu/entities/publication/f5be0d78-00ae-4b29-aadb-b487390fcbf2>

³⁷ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odihr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

ose kërcënuese për rendin ekzistues—duke hapur rrugë për fushata disinformimi në media dhe online. Në mënyrë të ngjashme, pabarazitë ekzistuese gjinore në pjesëmarrjen në hapësirën publike dhe përfaqësim u përforcuan nga një diskurs publik në media dhe online që përdori stereotipe, insinuata dhe sulme personale për të delegjitimuar gratë candidate, veçanërisht kur ato fitonin dukshmëri.

Ky vulnerabilitet korrespondon drejtpërdrejt me **Mundësuesin 3. Diskurs publik i polarizuar dhe i ndarë** dhe **Mundësuesin 4. Diskurs politik përjashtues dhe konfrontues** të metodologjisë së International IDEA-s. Polarizimi i thellë dhe kultura antagoniste e komunikimit politik krijojnë një mjedis ku delegjitimimi i kundërshtarit perceptohet si praktikë normale e konkurrencës. Në këtë kontekst, disinformimi, sulmet reputacionale dhe narrativat përjashtuese, sidomos ndaj aktorëve të rinj dhe grave në politikë, gjejnë terren të gatshëm për qarkullim dhe pranueshmëri. Diskursi polarizues nuk është thjesht tipar kontekstual, por një mekanizëm aktiv që ul rezistencën ndaj manipulimit të informacionit gjatë fushatave zgjedhore.

Rastet ilustruese në vijim ilustrojnë se si këto dinamika nuk ishin incidente të izoluara, por manifestime konkrete të një vulnerabiliteti strukturor, ku polarizimi, disinformimi dhe mungesa e pluralizmit mediatik u ndërthurën për të minuar integritetin e konkurrencës politike gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025.

Rast ilustrues: Fushatat disinformuese në hapësirën digjitale kundër aktorëve të rinj politikë

Gjatë fushatës parlamentare të vitit 2025, BIRN Albania dokumentoi një model të përsëritur sulmesh digjitale anonime ndaj aktorëve të rinj politikë, të karakterizuara nga pretendime manipuluese, amplifikim i koordinuar i përmbajtjeve të dëmshme dhe abuzim me mekanizmat e moderimit të platformave. Edhe pse autorët nuk u identifikuan publikisht, metodat ishin të qëndrueshme, të shtrira në kohë dhe në disa platforma, duke sugjeruar një praktikë të konsoliduar delegjitimimi përmes dezinformimit.

Në janar 2025, një faqe anonime në Instagram vuri në shënjestër partinë e re Lëvizja Bashkë përmes përmbajtjeve të maskuara si satirë, por që synonin ta paraqisnin lëvizjen dhe drejtuesit e saj si jo seriozë ose moralisht të komprometuar³⁸. Në prill, të njëjtat mekanizma u përdorën kundër Partisë Mundësia, përmes profileve anonime në Facebook që përhapën akuza të rreme ose insinuata për “agjenda të fshehta”, duke e kornizuar partinë si projekt të maskuar interesash të padukshme³⁹. Sulme të ngjashme u evidentuan edhe ndaj Nisma Shqipëria Bëhet, përmes shënjestrit personal të figurave të saj dhe riprodhimit të së njëjtës kornizë delegjitimimi në disa llogari.⁴⁰

Përdorimi i sulmeve digjitale vijoi edhe pas zgjedhjeve, kur u raportua bllokimi i përkohshëm i llogarisë në Facebook të Arlind Qorit, drejtues i Lëvizja Bashkë, pas raportimeve të rreme të koordinuara⁴¹, duke demonstruar kalimin nga synimi për të ndikuar opinionin publik te ndërprerja faktike e kanalit të komunikimit politik të një aktori të caktuar, përmes abuzimit me vulnerabilitetet e sistemeve automatike të platformave. Këto të fundit, shpesh dështuan t'i identifikojnë metodat e manipulimit të përdorura për disinformim dhe censurë.

Raportimet e BIRN-it tregojnë gjithashtu se taktika të ngjashme u përdorën edhe ndaj partisë në pushtet, përmes një akuze e cila mori vemendje të lartë dhe qarkulloi gjatë fushatës, por u përgënjeshtroa më pas përmes verifikimit të burimeve. Ky rast paralel tregon se delegjitimimi përmes pretendimeve delegjitimuese me atribuim të paqartë, të mbështetura te viraliteti për t'i paraprirë llogaridhënies, përbën një mekanizëm transversal të manipulimit informativ, që nuk kufizohet vetëm tek aktorët e rinj.⁴²

³⁸ Likmeta, B. (2025, 31 janar). Kukull me çorape: Faqja anonime në Instagram shpërndan dezinformimin për Lëvizjen Bashkë. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/01/31/kukull-me-corape-faqja-anonime-ne-instagram-shperndan-dezinformimin-per-levizjen-bashke/>

³⁹ Karaj, V. (2025, 1 prill). Profili anonim në Facebook shpërndan dezinformim kundër partisë “Mundësia”. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/04/01/profili-anonim-ne-facebook-shperndan-dezinformim-kunder-partise-mundesia/>

⁴⁰ Karaj, V. (2025, 4 prill). Profilet anonime targetojnë edhe drejtuesit e “Nisma Shqipëria Bëhet”. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/04/04/profilet-anonime-targetojne-edhe-drejtuesit-e-nisma-shqiperia-behet/>

⁴¹ Karaj, V. (2025, 20 maj). Llogaria Facebook e Arlind Qorit u bllokua pas sulmit me raporte të rreme. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/20/llogaria-facebook-e-arlind-qorit-u-blokua-pas-sulmit-me-raporte-te-rreme/>

⁴² Karaj, V. (2025, 4 prill). Kush fshihet pas akuzave të PD se ‘Edi Rama zotëron një orë me vlerë 1.4 milionë euro’. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/04/04/kush-fshihet-pas-akuzave-te-pd-se-edi-rama-zoteron-nje-ore->

Në tërësi, këto raste evidentojnë një formë të përhapur të shtypjes së konkurrencës përmes dezinformimit, e ndërtuar mbi narrativa delegjitimuese, anonimitet dhe manipulim digjital, e cila rriti koston dhe sfidat e pjesëmarrjes veçanërisht për aktorët e rinj politikë në një mjedis me besim të ulët dhe polarizim të lartë.

Rast ilustrues: Disinformi me bazë gjinore dhe pjesëmarrja e pabarabartë në zgjedhjet 2025

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 në Shqipëri treguan se dezinformimi me bazë gjinore përbën një vulnerabilitet strukturor zgjedhor që amplifikon pabarazitë ekzistuese dhe deformat konkurrencën politike. Gratë hynë në garë në kushte të pabarabarta: ato përbënin 38.7% të kandidatëve dhe ishin të pozicionuara në mënyrë të pabarabartë në lista. Kandidatet gra morën ndjeshëm më pak vota në listat e hapura krahasuar me burrat (26.4% kundrejt 73.6%).

Monitorimi i fushatës tregoi se gratë ishin seriozisht të nën-përfaqësuar në media, duke zënë vetëm 9.9% të mbulimit në lajme, 24.69% në emisione politike dhe 8.6% në transmetime *live*. Ky nivel i ulët dukshmërie kufizoi aftësinë e tyre për të formësuar diskursin publik dhe për t'iu përgjigjur narrativave armiqësore, duke e bërë dezinformimin gjinor më efektiv si mekanizëm delegjitimimi—jo si një fenomen i izoluar, por si shumëfishim i përjashtimit sakaq ekzistues.⁴³

Në mjedisin online, gratë u ekspozuan ndaj niveleve më të larta të përmbajtjeve fyese dhe denigruese, të fokusuara jo te pozicionet apo veprimet e tyre politike, por tek atributet personale, morali dhe rolet gjinore. Këto narrativa në përgjithësi nuk synonin bindjen e votuesve, por dëmtimin e besueshmërisë dhe dekurajimin e pjesëmarrjes politike.

Efektet ishin kumulative: sa më shumë rritej dukshmëria e grave, aq më intensive bëheshin sulmet. Monitorimi dokumentoi abuzim të vazhdueshëm online dhe ngacmime të koordinuara, veçanërisht në rrjetet sociale, duke i çuar shumë kandidatë të kufizonin angazhimin publik.⁴⁴ Këto dinamika ndikuan edhe perceptimet më të gjera shoqërore, duke forcuar mosbesimin dhe duke sinjalizuar se pjesëmarrja politike e grave shoqërohet me kosto të larta personale.

Nga perspektiva e FIMI-t, këto të dhëna tregojnë se dezinformimi gjinor shfrytëzon

[me-vlere-1-4-milione-euro/](#)

⁴³ UN Women Albania, EDM, & BIRN Albania. (2025). *Women in Politics 2025 – Factsheet and Media Monitoring Findings, including data on candidate visibility, media coverage, and gender-based disparities in political communication* [Gratë në politikë 2025 – Fletë informuese dhe gjetjet e monitorimit të mediave, duke përfshirë të dhëna mbi dukshmërinë e kandidatëve, mbulimin mediatic dhe diferencat gjinore në komunikimin politik]. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2025-12/en_women_in_politics_factsheet_web.pdf

⁴⁴ Karaj, V. (2025, 6 qershor). Pas perdes së fushatës: Gratë kandidatë u sulmuan me gjuhë seksiste dhe denigruese. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/06/06/pas-perdes-se-fushates-grate-kandidate-u-sulmuan-me-gjuhe-seksiste-dhe-denigruese/>

njëkohësisht përfaqësimin e pabarabartë, hapësirën asimetrike mediatike, llogaridhënien e dobët të platformave dhe diskursin e polarizuar. Ai funksionon si vulnerabilitet sistemik, duke rritur koston e pjesëmarrjes për gratë, duke ngushtuar pluralizmin zgjedhor dhe duke minuar legjitimitetin demokratik.

Perceptimi i
korrupsionit
zgjedhor ushqen
narrativa
për kapjen e
demokracisë.

Ndikimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit mbi procesin zgjedhor

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 u zhvilluan në një kontekst ku ndërthurja mes politikës, korrupsionit dhe ndikimeve informale, përfshirë krimin e organizuar, mbeti një shqetësim i vazhdueshëm për integritetin e procesit zgjedhor. Edhe pse institucionet përgjegjëse ndërmorën disa hapa për të parandaluar dhe hetuar krimet zgjedhore, raportet ndërkombëtare dhe vlerësimet vendase theksojnë se perceptimi publik mbi ndikimin e aktorëve informalë dhe ndëshkueshmërinë e kufizuar vazhdon të minojë besimin në garën zgjedhore. Ky hendek mes veprimit institucional dhe besimit shoqëror krijon një terren veçanërisht të favorshëm për narrativa delegjitimimi dhe manipulim informacioni.

Raporti i OSCE/ODIHR vëren se, edhe pse zgjedhjet u administruan në mënyrë përgjithësisht të rregullt, akuzat për blerje vote, presion ndaj votuesve dhe përfshirje të aktorëve kriminalë mbetën të pranishme në diskursin publik, veçanërisht në zona të vendit me ndikim të lartë të grupeve kriminale. Raporti thekson se këto akuza, pavarësisht nëse provohen apo jo në mënyrë përfundimtare, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në perceptimin e barazisë së garës dhe në pranueshmërinë e rezultatit zgjedhor, sidomos në një mjedis të polarizuar politikisht.⁴⁵ Në të njëjtën linjë, Komisioni Evropian nënvizon se korrupsioni dhe ndërhyrjet informale në proceset zgjedhore mbeten një rrezik strukturor, ndërsa progresi në ndëshkimin efektiv të tyre perceptohet si i ngadaltë dhe i pabarabartë, duke ndikuar negativisht në besimin publik.⁴⁶

Në nivel kombëtar, roli i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) është identifikuar si kyç për mbrojtjen e integritetit zgjedhor. Në shkurt 2025, SPAK-u publikoi një Strategji të Posaçme për Hetimin dhe Parandalimin e Krimeve Zgjedhore, me objektiva që përfshinin identifikimin e hershëm të veprave penale, parandalimin e korrupsionit, rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe bashkëpunimin me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, median dhe

⁴⁵ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odhr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

⁴⁶ European Commission. (2025). *Report on Albania 2025 [Raporti për Shqipërinë 2025]*. Bruksel. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en

shoqërinë civile.⁴⁷ Megjithatë, vetë strategjia dhe deklaratat publike të SPAK-ut theksojnë sfida të rëndësishme, si presioni i mundshëm politik, vonesat procedurale, disinformimi në media dhe vështirësitë në hetimin shkeljeve mbi votën e diasporës dhe ndërhyrjeve të huaja, duke nënvizuar se mbrojtja e integritetit zgjedhor kërkon veprim të koordinuar institucional.⁴⁸

Analizat dhe investigimet e BIRN në Durrës, Elbasan, Dibër dhe qarqe të tjera tregojnë përmes shembujve empirikë se krimi i organizuar funksionon si “aktor i padukshëm” i zgjedhjeve, duke ndikuar përmes rrjeteve lokale, frikësimit, ndërmjetësimit të votës ose mbështetjes selektive të kandidatëve.⁴⁹ ⁵⁰ Paralelisht, rastet e kandidatëve nën hetim për korrupsion dhe përplasjet mes politikës dhe drejtësisë nxorën në pah një dimension shtesë të vulnerabilitetit: normalizimin e pranisë së figurave problematike në garë, duke e zhvendosur debatin publik nga standardet e integritetit të konfliktet politike mbi legjitimitetin e institucioneve të drejtësisë.⁵¹

Një element kritik për FIMI-n nuk është vetëm ekzistenca e këtyre fenomeneve, por mënyra se si ato përkthehen në narrativë publike. Volumi i lartë i procedimeve penale për krime zgjedhore, p.sh. dhjetëra çështje të regjistruara dhe dhjetëra të tjera ende në hetim pas zgjedhjeve, pa rezultate të shpejta dhe të qarta përfundimtare, ushqen perceptimin e pandëshkueshmërisë.⁵² ⁵³ Kjo krijon një hapësirë ku çdo incident lokal ose gjetje e pjesshme shndërrohet lehtësisht në “provë” të manipulimit sistemik, duke u amplifikuar nga aktorë politikë, media të pozicionuara politikisht ose profile anonime në rrjetet sociale.

Në këtë kuptim, ndikimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit zgjedhor përbën një vulnerabilitet strukturor ndaj FIMI-t: ai ul besimin në institucione, relativizon rezultatin zgjedhor dhe e bën publikun më pranues ndaj narrativave që delegjitimojnë procesin demokratik. Edhe kur institucionet reagojnë, mungesa e transparencës së mjaftueshme dhe vonesat në ndëshkim e dobësojnë efektin e masave, duke e lënë hapësirën informative të ekspozuar ndaj manipulimit.

⁴⁷ Hoxhaj, E. (2025, 29 janar). SPAK ngre një strukturë hetimore të posaçme për krimet zgjedhore. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/01/29/spak-ngre-nje-strukture-hetimore-te-posacme-per-krimet-zgjedhore/>

⁴⁸ Hoxhaj, E. (2025, 21 shkurt). Strategjia e SPAK kundër korrupsionit zgjedhor dhe përfshirjes së krimit të organizuar. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/02/21/strategjia-e-spak-kunder-korrupsionit-zgjedhor-dhe-perfshirjes-se-krim-it-te-organizuar/>

⁴⁹ Bogdani, A. (2025, 8 maj). Krimi i organizuar, partia e padukshme e zgjedhjeve në Durrës. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/08/krimi-i-organizuar-partia-e-padukshme-e-zgjedhjeve-ne-durres/>

⁵⁰ Emiri, G. (2025, 11 maj). Krimi i organizuar ‘orientoi’ votën në Durrës. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/11/krimi-i-organizuar-orientoi-voten-ne-durres/>

⁵¹ Karaj, V. (2025, 21 prill). Politika sfidon drejtësinë me kandidatët nën hetim për çështje korrupsioni. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/04/21/politika-sfidon-drejt-esine-me-kandidatet-nen-hetim-per-ceshtje-korrupsioni/>

⁵² Hoxhaj, E. (2025, 9 maj). Regjistrohen 58 çështje penale për krime zgjedhore, nga të cilat 37 për korrupsion në zgjedhje. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/09/regjistrohen-58-ceshtje-penale-per-krime-zgjedhore-nga-te-cilat-37-per-korrupsion-ne-zgjedhje/>

⁵³ Barjamemaj, A. (2025, 26 qershor). Dumani thotë se 43 procedime për krime zgjedhore janë ende në hetim. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/06/26/dumani-thote-se-43-procedime-per-krime-zgjedhore-jane-ende-ne-hetim/>

Ky vulnerabilitet lidhet kryesisht me **Mundësuesin 1. Mungesë sistematike e besimit tek institucionet demokratike** dhe **Mundësuesin 6. Ndjeshmëria e audiencës ndaj manipulimit**. Prania e akuzave për korrupsion zgjedhor, përfshirja e krimit të organizuar në zgjedhje dhe numri i lartë i procedimeve penale—të shoqëruara me hetime të zgjatura dhe rezultate të kufizuara—ushqejnë perceptimin se shkeljet zgjedhore nuk ndëshkohen në mënyrë efektive. Ky perceptim rrit mosbesimin publik dhe e bën audiencën më të prirur të besojë narrativa që i paraqesin zgjedhjet si të kapura ose të kontrolluara nga interesa kriminale.

Fusha 2

Kuadri rregullator dhe financimi i partive politike

Kuadri rregullator dhe financiar i zgjedhjeve në Shqipëri përcakton rregullat e konkurrencës politike, transparencën e burimeve financiare dhe mekanizmat e mbikëqyrjes institucionale. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, ky kuadër u karakterizua nga paqëndrueshmëri normative, ndryshime të vonshme ligjore dhe boshllëqe të vazhdueshme në rregullimin dhe zbatimin e financimit politik.

Megjithëse ekziston një arkitekturë formale ligjore, praktika tregon se dizajni rregullator dhe zbatueshmëria e tij nuk janë përshtatur plotësisht me realitetet e fushatave bashkëkohore, veçanërisht në lidhje me financimin digjital, rolin e palëve të treta dhe dimensionet ndërkufitare të komunikimit politik. Kjo krijon hapësira për pabarazi strukturore, mungesë transparence dhe ndikim të paatribuar, elemente që janë veçanërisht të ndjeshme nga perspektiva e FIMI-t.

Kjo fushë fokusohet në tre vulnerabilitete kryesore:

- paqëndrueshmërinë e kuadrit rregullator dhe ndryshimet e vonshme që rikonfigurojnë parametrat e garës zgjedhore; dhe
- boshllëqet në rregullimin dhe zbatimin e financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore, përfshirë palët e treta dhe shpenzimet digjitale;
- mospërafrimin e plotë me standardet europiane dhe ndërkombëtare për transparencën, reklamimin politik online dhe aktivitetet ndërkufitare.

Në tërësi, këto vulnerabilitete krijojnë një mjedis rregullator ku ndikimi financiar dhe narrativ mund të ushtrohet në mënyrë të maskuar, duke cenuar barazinë e garës dhe duke rritur rrezikun e manipulimit të informacionit gjatë dhe pas zgjedhjeve.

Kuadër rregullator i paqëndrueshëm dhe reforma të vonuara

Reformat e shpeshta dhe të vonuara zgjedhore cenojnë sigurinë dhe mbikëqyrjen efektive.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar amendimeve të shpeshta përgjatë viteve, kryesisht përmes proceseve bipartizane që, në parim, kanë synuar konsensus politik dhe legjitimitet të gjerë. Në disa raste, këto procese janë shoqëruar edhe me përpjekje për konsultim me aktorë të tjerë, përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Megjithatë, vlerësimet e pavarura tregojnë se këto përpjekje shpesh kanë qenë formale, të fragmentuara ose të kufizuara në kohë, duke prodhuar rezultate minimale ose duke dështuar të adresojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse problematikat strukturore të sistemit zgjedhor. Proceset e reformës zgjedhore gjatë viteve të fundit janë karakterizuar nga mungesa e besimit mes palëve politike, ndërprerja e dialogut dhe perceptimi i gjerë publik se reformat po përdoren më shumë si instrument negociues sesa si mekanizëm për përmirësim të qëndrueshëm të integritetit zgjedhor.⁵⁴

Ndryshimet e miratuara gjatë 2024–2025 e ilustronë qartë këtë problematikë. Ndërhyrjet ligjore të lidhura me votimin nga jashtë territorit të vendit (diaspora) riformatuan procedurat dhe afatet për regjistrimin dhe administrimin e votës, duke shtuar kompleksitetin institucional në një fazë kritike të procesit zgjedhor.⁵⁵ Paralelisht, amendimet e shkurtit 2025 prekën drejtpërdrejt financimin dhe komunikimin zgjedhor: u rrit ndjeshëm tavanin e vetëfinancimit të kandidatëve (nga 1 në 3 milionë lekë), u zgjeruan kufijtë maksimalë të shpenzimeve të fushatës dhe u krijua një paqartësi ligjore duke përjashtuar shpenzimet e kandidatëve nga tavanin e përgjithshëm të shpenzimeve të subjekteve zgjedhore (partive politike), pa vendosur një kufi të veçantë për kandidatët. Këto ndryshime u miratuan vetëm pak muaj para zgjedhjeve dhe u shoqëruan me rritjen e kohës së reklamave televizive, duke rikonfiguruar në mënyrë të ndjeshme parametrat financiarë dhe mediatikë të garës.⁵⁶

⁵⁴ Gjoka, B. (2025, 18 nëntor). Reforma zgjedhore, palët nisin punën me mosbesim. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/11/18/reforma-zgjedhore-palet-nisin-punen-me-mosbesim/>

Gjoka, B. (2024, 6 shkurt). Skenar: Shoqëria civile mosbesuese ndaj politikës për reformën zgjedhore. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2024/02/06/skenar-shoqeria-civile-mosbesuese-ndaj-politikes-per-reformen-zgjedhore/>

Gjoka, B. (2024, 26 janar). Komisioni i reformës zgjedhore, Rama–Basha nis punën online. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2024/01/26/komisioni-i-reformes-zgjedhore-rama-basha-nis-punen-online/>

Gjoka, B. (2024, 28 qershor). Dialogu PS–PD për reformën zgjedhore drejt dështimit. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2024/06/28/dialogu-ps-pd-per-reformen-zgjedhore-drejt-deshtimit/>

Gjoka, B. (2024, 21 mars). Përfundon pa rezultat komisioni bipartizan për reformën zgjedhore. *Reporter.al*.

<https://www.reporter.al/2024/03/21/perfundon-pa-rezultat-komisioni-bipartizan-per-reformen-zgjedhore/>
Erebara, Gj. (2024, 2 mars). Ndërsa zgjedhjet afrohen, partitë parlamentare duken jo serioze në nismën për të reformuar Kodin Zgjedhor, thonë organizatat. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2024/03/02/ndersa-zgjedhjet-afrohen-partite-parlamentare-duken-jo-serioze-ne-nismen-per-te-reformuar-kodin-zgjedhor-thone-organizatat/>

⁵⁵ Venice Commission. (2025). *Albania: 2024 and 2025 Amendments to the Electoral Code* [Shqipëria: Amendamentet e vitit 2024 dhe 2025 në Kodin Zgjedhor]. <https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-REF%282025%29029-e>

⁵⁶ Barjamemaj, A. (2025, 11 shkurt). PS–PD miratojnë së bashku rritjen e financimeve dhe kohës televizive në fushatë. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/02/11/ps-pd-miratojne-se-bashku-rritjen-e-financimeve-dhe-kohes-televizive-ne-fushate/>

Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR vëren se, megjithëse disa rekomandime të përbashkëta të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias janë adresuar (si p.sh. ndryshime në pragun kombëtar për kandidatët e pavarur ose heqja e mundësisë për kandidim në disa zona zgjedhore), një numër i konsiderueshëm rekomandimesh të kahershme mbeten ende të paadresuara. Këto përfshijnë përbërjen e komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, raportimin e ndërmjetëm të financimit të fushatës, shtrirjen e rregullave të financimit të palët e treta, si dhe garancitë për mbulim të pavarur dhe pluralist mediatik. Mospërmbushja e këtyre rekomandimeve nënvizon një mungesë të qëndrueshme vullneti politik për reforma gjithëpërfshirëse dhe forcon hendekun mes standardeve ndërkombëtare dhe praktikës rregullatore vendase.⁵⁷

Ky vulnerabilitet lidhet drejtpërdrejt me **Mundësuesin 14. Autoritete rregullatore jo efektive**, pasi ndryshimet e shpeshta dhe të vonshme e bëjnë më të vështirë zbatimin e qëndrueshëm dhe mbikëqyrjen koherente të rregullave zgjedhore. Njëkohësisht, ai ndërvepron me nxitësit ekonomikë të ekosistemit të reklamimit politik, veçanërisht në mjedisin e pambikëqyrur/parregulluar digjital, ku rritja e kufijve të shpenzimeve dhe paqartësitë rregullatore rrisin leverdinë e ndikimit të fshehtë ose të ndërmjetësuar përmes aktorëve “surrogatë”.

Boshllëqe në rregullimin e financimit të partive dhe fushatave

Transparenca e
dobët financiare
lejon ndikim
elektoral nga aktorë
të tjerë.

Kuadri për financimin politik në Shqipëri rregullohet kryesisht nga Kodi Zgjedhor dhe ligji “Për partitë politike”. Megjithëse janë ndërmarrë disa ndryshime të pjesshme në vitet e fundit, nuk ka pasur reforma gjithëpërfshirëse që prej vitit 2020 dhe struktura bazë e sistemit mbetet e pandryshuar. Si rezultat, kuadri aktual vijon të prodhojë transparencë të kufizuar dhe pabarazi funksionale në garën zgjedhore, duke minuar barazinë e mundësive ndërmjet subjekteve dhe kandidatëve.

Një vulnerabilitet themelor i këtij sistemi është mbështetja pothuajse e plotë në raportimin pas-zgjedhor dhe auditimin *ex post*, duke kufizuar ndjeshëm transparencën në periudhën kur ndikimi financiar është më intensiv. Siç theksohet edhe në Dokumentin e Punës të BIRN Albania mbi Parandalimin e Ndërhyrjeve të Huaja, ligji kërkon dorëzimin e raporteve financiare vetëm pas përfundimit të procesit zgjedhor dhe nuk imponon mekanizma raportimi periodik ose “në kohë reale” gjatë fushatës. Kjo krijon vakume strukturore për gjurmueshmërinë

⁵⁷ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odihr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

e fondeve dhe shpenzimeve, përfshirë ato që lidhen me komunikimin digjital dhe reklamimin politik online.⁵⁸

Raporti i OSBE/ODIHR për zgjedhjet e 2025 e konfirmon këtë problematikë. Ai thekson se rekomandime kyçe të hershme mbi financimin e fushatave mbeten të paadresuara, duke përfshirë mungesën e raportimit të ndërmjetëm gjatë fushatës, mungesën e instrumenteve efektive për të siguruar publikimin e të dhënave mbi donacionet dhe huatë, si dhe shqetësime serioze mbi efektivitetin e auditimit. Sipas ODIHR-it, këto boshllëqe ndikojnë drejtpërdrejt transparencën dhe barazinë e mundësive për partitë dhe kandidatët, duke e bërë kuadrin jo vetëm formal, por edhe jo funksional në praktikë.⁵⁹

Problemi thellohet më tej në kontekstin e FIMI-t, sepse ndikimi zgjedhor nuk materializohet domosdoshmërisht përmes financimit të drejtpërdrejtë të partive politike. Përkundrazi, ai shpesh realizohet përmes palëve të treta, rrjeteve të komunikimit të paguar, kompanive të marketingut politik, faqeve “surrogatë”, influencerëve apo ndërmjetësve që blejnë reklamim online pa atribuum të qartë financiar.⁶⁰ Kuadri aktual nuk i rregullon në mënyrë të mjaftueshme këta aktorë, as në aspektin e transparencës së financimit dhe as në atë të raportimit dhe auditimit të shpenzimeve të tyre, siç demonstron në praktikë e analizuar në seksionet e mëposhtme.

Në këtë kuptim, vulnerabiliteti nuk është vetëm rregullator, por edhe strukturor dhe kulturor. Pavarësisht se ligji parashikon detyrime raportimi dhe auditimi nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), praktika e dy cikleve të fundit zgjedhore tregon se shumë subjekte dhe kandidatë i trajtojnë këto detyrime si formale, me kosto të ulët moszbatimi dhe pa pasoja reale për pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet pasuese. Në kushtet e mungesës së sanksioneve efektive dhe zbatimit selektiv ose të vonuar, transparencja financiare shndërrohet në një ushtrim dokumentues që prodhon “letër”, por jo domosdoshmërisht llogaridhënie të vërtetë.

Kjo situatë ka nxitur edhe diskutime të vazhdueshme mbi nevojën për rishikimin e Kodit Zgjedhor dhe ligjit për partitë politike. Diskursi publik i lidhur me procesin e integritetit evropian ka reflektuar presionin për forcimin e ndalimit të financimeve nga burime kriminale ose të huaja dhe për rritjen e transparencës financiare të partive politike, duke përfshirë diskutime mbi një ligj të ri për financimin politik

⁵⁸ BIRN Albania. (2025). *Working Paper: Parandalimi i ndërhyrjeve të huaja në proceset demokratike dhe zgjedhore në Shqipëri*. Tirana.

⁵⁹ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odhr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

⁶⁰ National Democratic Institute (NDI). (2025). *The Vulnerability of Albanian Politics to Foreign Interference* [Vulnerabiliteti i politikës shqiptare ndaj ndërhyrjeve të huaja]. <https://ndi.org/sites/default/files/2025-04/The-Vulnerability-of-Albanian-Politics-to-Foreign-Interference-%281%29.pdf>

në përputhje me standardet e BE-së.⁶¹ Megjithatë, pavarësisht këtyre sinjaleve dhe angazhimeve në nivel politik dhe strategjik, deri në fund të ciklit zgjedhor 2025 këto diskutime nuk janë materializuar në nisma konkrete ligjore, duke e lënë këtë vulnerabilitet strukturor të paadresuar.

Nga perspektiva e FIMI-t, këto boshllëqe krijojnë hapësirë reale për financime dhe shpenzime të paidentifikueshme, si dhe për narrativa delegjitimuese ndaj procesit zgjedhor, si i kompromentuar dhe financiar nga palë të dyshimta. Kjo e bën financimin politik jo vetëm një çështje rregulatore, por edhe një pikë kyçe për ndërhyrje informative dhe kontestim të legjitimitetit të procesit zgjedhor.

Ky vulnerabilitet lidhet drejtpërdrejt me **Mundësuesin 2. Rregullim i pamjaftueshëm mbi financimin politik**. Në kushtet e mbikëqyrjes së dobët dhe parandalimit të ulët, boshllëqet në kuadrin rregulator ndërthuren edhe me vulnerabilitetet në efektivitetin e autoriteteve rregulatore dhe boshllëqe në zbatim (në logjikë të afërt me Mundësuesit 14–15), si dhe me nxitës ekonomike të “ekonomisë së vemendjes” dhe industrisë së komunikimit politik digjital.

Rast ilustrues: Mungesa e transparencës financiare (zgjedhjet vendore 2023 dhe zgjedhjet parlamentare 2025)

Në zgjedhjet vendore të 14 majit 2023, analiza e BIRN Albania mbi raportet financiare të subjekteve zgjedhore evidentoi një model të qartë: raportimi është i vonuar, i pjesshëm dhe në disa raste praktikisht i pavlefshëm për mbikëqyrje. Sipas të dhënave të KQZ-së, në fund të qershorit 2024, 28 subjekte zgjedhore kishin dorëzuar raporte; tetë prej tyre deklarorin 0 të ardhura dhe 0 shpenzime, duke u përjashtuar nga analiza e mëtejshme.⁶² Ky “raportim zero” nuk është vetëm anomali teknike, por sinjalizon një kulturë të mungesës së llogaridhëniejes ku subjekti zgjedhor mund të ruajë statusin e tij ligjor, i pa penalizuar, pa reflektuar realisht koston e fushatës.

Gjithashtu, raportet pasuese të BIRN mbi transparencën financiare të kandidatëve për kryetar bashkie në 2023,⁶³ e përforcojnë të njëjtin model “përputhshmërie formale, pa përmbajtje”. Nga 144 kandidatë, vetëm 127 kishin dorëzuar raport financiar, nga të cilët, vetëm 90 kishin deklaruar të ardhura ose shpenzime për fushatën. Afërsisht 29% e kandidatëve raportues nuk pasqyronin asnjë aktivitet financiar zgjedhor. Në praktikë, kjo e bën të pamundur pasjen e një tabloje të

⁶¹ International IDEA. (2025). *Advancing political finance transparency in Albania: stakeholders unite for stronger electoral integrity* [Avancimi i transparencës së financimit politik në Shqipëri: Aktorët bashkohen për integritet zgjedhor më të fortë]. <https://www.idea.int/news/advancing-political-finance-transparency-albania-stakeholders-unite-stronger-electoral>

⁶² Voko, K., Likmeta, B., & Erebara, G. (2025, January). *Analysis of the Financial Reports of Electoral Subjects on the 2023 Electoral Campaign* [Analiza e raporteve financiare të subjekteve zgjedhore mbi fushatën elektorale 2023]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/01/Analysis-of-the-Financial-Reports-of-Electoral-Subjects-on-the-2023-Electoral-Campaign-.pdf>

⁶³ Voko, K., & Likmeta, B. (2025). *Analysis of the Financial Reports of Candidates for Local Government Units on the 2023 Election Campaign* [Analiza e raporteve financiare të kandidatëve për njësitë e qeverisjes lokale në fushatën zgjedhore 2023]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/02/ANALYSIS-OF-THE-FINANCIAL-REPORTS-OF-CANDIDATES-FOR-LOCAL-GOVERNMENT-UNITS-ON-THE-2023-ELECTION-CAMPAIGN-.pdf>

plotë të financimit të fushatës dhe normalizon faktin se mosraportimi (ose raportimi fiktiv) nuk përbën pengesë reale për konkurrimin politik.

Në mënyrë të ngjashme, pavarësisht se në garë ishin regjistruar 23,646 kandidatë për këshilla bashkiakë, shumica prej tyre nuk dorëzuan deklaramë ose deklaruan 0 shpenzime. Kjo rezultoi në një mesatare prej 17 Lekësh (më pak se 20 cent) të shpenzuara për kandidat—një tregues i fortë i nën-deklarimit ose mosdeklarimit të shpenzimeve. Ky hendek e zbeh funksionin e raportimit si mekanizëm transparence dhe e zhvendos debatin publik drejt dyshimit: nëse shpenzimet reale nuk pasqyrohen, atëherë burimet reale të financimit mbeten në “zona gri”.

Ky model vijoi të reflektohet edhe në zgjedhjet parlamentare 2025, ku nga 38 subjekte zgjedhore vetëm 32 kanë dorëzuar raporte financiare, ndërsa nga 2,046 kandidatë për deputetë më pak se 1,500 kanë dorëzuar raport financiar brenda afatit ligjor 4 nëntor 2025. Fakti që mosraportimi masiv nuk shoqërohet me pasoja që prekin të drejtën e subjekteve/kandidatëve për të garuar në ciklet e ardhshme, e konsolidon këtë vulnerabilitet si strukturor: aktorët racionalisht “llogaritin” se mosrespektimi i detyrimeve është i tolerueshëm.

Mungesa e përafrimit me standardet ndërkombëtare

Kuadri ligjor dhe rregullator shqiptar për fushatat zgjedhore është ndërtuar historikisht mbi një logjikë që privilegjon mediat tradicionale dhe aktorët politikë kryesorë. Gjithashtu, Kodi Zgjedhor nuk përmban dispozita të posaçme për fushatat online dhe nuk vendos detyrime të qarta për platformat digjitale në lidhje me identifikimin transparent të sponsorëve, burimeve të financimit dhe praktikave të targetimit të audiencës.⁶⁴

Ky boshllëk rregullator merr rëndësi të veçantë në kontekstin e procesit të integritimit evropian, pasi Shqipëria nuk e ka përafruar ende legjislacionin e saj zgjedhor me instrumentet kryesore të BE-së që synojnë rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë në mjedisin digjital. Ndërsa në Bashkimin Evropian këto rreziqe adresohen përmes Aktit të Shërbimeve Digjitale (DSA)⁶⁵ dhe Rregullores për Transparencën dhe Targetimin e Reklamimit Politik (TTPA),⁶⁶ kuadri shqiptar nuk rregullon përgjegjësitë e platformave digjitale në përgjithësi, apo mitigimin e rreziqeve sistematike digjitale në kontekstin zgjedhor në veçanti. Këto instrumente

**Boshllëqet
rregullatore në
sferën digjitale
eksponojnë
zgjedhjet ndaj
ndërhyrjeve
ndërkufitare.**

⁶⁴ BIRN Albania. (2025). *Working Paper: Parandalimi i ndërhyrjeve të huaja në proceset demokratike dhe zgjedhore në Shqipëri*. Tirane

⁶⁵ European Parliament & Council. (2022). *Regulation (EU) 2022/2065 on a Single Market For Digital Services and amending Directive 2000/31/EC (Digital Services Act)* [Rregullorja (BE) 2022/2065 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 19 tetor 2022 mbi një Treg të Vetëm për Shërbimet Digjitale dhe ndryshimi i Direktivës 2000/31/EC (Digital Services Act)]. <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2022/2065/oj/eng>

⁶⁶ European Parliament & Council. (2024). *Regulation (EU) 2024/900 on the transparency and targeting of political advertising* [Rregullorja (BE) 2024/900 mbi transparencën dhe targetimin e reklamave politike]. <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/summary/transparency-and-targeting-of-political-advertising.html>

ligjore të BE-së janë hartuar, ndër të tjera, për të kufizuar hapësirat ku ndërhyrja informative dhe ndikimi i fshehtë operojnë përmes reklamimit të paatribuar dhe mikro-targetimit të errët.⁶⁷

Në praktikë, mospërafrimi me *acquis* të BE-së në këtë fushë nuk është vetëm çështje formale e integritit, por një vulnerabilitet operacional. Mungesa e detyrimeve për transparencë dhe gjurmueshmëri krijon një kanal të favorshëm për ndikim të pidentifikueshëm, për fushata të koordinuara nga rrjete që veprojnë përtej juridiksionit kombëtar dhe për përdorimin e palëve të treta si ndërmjetës nga financuesit realë për përcjelljen e mesazhit politik. Këto boshllëqe ndërveprojnë edhe me nxitjet ekonomike të tregut të reklamimit online, ku platforma dhe ndërmjetës të ndryshëm përfitojnë nga monetizimi i vëmendjes pa mbartur përgjegjësi proporcionale për transparencën dhe integritetin e proceseve demokratike.

Kompleksiteti rritet më tej në kontekstin e fushatës drejt diasporës, ku targetimi i votuesve jashtë territorit kombëtar përmes reklamimit online dhe faqeve ndërmjetëse e bën edhe më të vështirë identifikimin e sponsorëve realë dhe burimeve të financimit, siç evidentohet nga rastet e dokumentuara të fushatave të fshehta ose të financuara nga palë të treta për të targetuar votuesit e diasporës.^{68 69}

Një aspekt i lidhur drejtpërdrejt me këtë vulnerabilitet është mungesa e rregullimit të aktiviteteve lobuese në Shqipëri dhe jashtë saj. Shqipëria nuk ka një ligj të posaçëm për lobimin, ndërsa në 2025 është publikuar për konsultim publik drafti i parë i një ligji të tillë.⁷⁰ Mungesa e një kuadri rregullator në këtë fushë nënkupton mungesën e përkufizimit ligjor të lobistit, mungesën e regjistrave publikë dhe mungesën e transparencës mbi marrëdhëniet mes zyrtarëve publikë, partive politike dhe aktorëve lobues vendas apo të huaj. Siç dëshmohet në hetime gjyqësore dhe raportime mediatike, kontratat lobuese dhe shpenzimet përkatëse kanë qenë burim kontestimi dhe dyshimesh për ndikim të padrejtë, veçanërisht kur përdoren për të ndërkombëtarizuar narrativa politike pas proceseve zgjedhore (shiko rastin ilustrues më poshtë).

Paralelisht, Shqipëria ka miratuar instrumente strategjike dhe dokumente “të butë” (soft law) që e njohin qartë këtë hendek rregullator. Strategjia

⁶⁷ International IDEA. (2025). *Navigating the EU Digital Regulatory Framework – Part II* [Navigimi i kuadrit rregullator digjital të BE-së – Pjesa II]. <https://www.idea.int/sites/default/files/2025-10/navigating-eu-digital-regulatory-framework-part2.pdf>

⁶⁸ Likmeta, B. (2025, 24 janar). Qiellgërvishtës dhe reklama: Fushata e fshehtë në Facebook për votën e Diasporës. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/01/24/qiellgervishtes-dhe-reklama-fushata-e-fshehte-ne-facebook-per-voten-e-diaspores/>

⁶⁹ Likmeta, B. (2025, 12 prill). Takim ‘ekskluziv’: Edi Rama bën fushatë të financuar nga palë të treta me diasporën. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/04/12/takim-ekskluziv-edi-rama-ben-fushate-te-financuar-nga-pale-te-treta-me-diasporen/>

⁷⁰ Qeveria e Shqipërisë. (2025). *Projektligj “Për lobimin” – Konsultim public*. <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/890>

Kombëtare Kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030⁷¹ dhe Udhërrëfyeni për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike⁷² artikulojnë nevojën për rregullimin e fushatave digjitale, transparencën e reklamimit politik online, mbikëqyrjen e palëve të treta dhe forcimin e sanksioneve. Pavarësisht ekzistencës së standardeve ndërkombëtare të konsoliduara dhe angazhimeve në nivel strategjik për t'i harmonizuar, këto të fundit nuk janë përkthyer ende në detyrime ligjore të qarta, mekanizma zbatues dhe alokim të kapaciteteve të nevojshme institucionale.

Këto problematika lidhen drejtpërdrejt me **Mundësuesin 15. Boshllëqe në rregullimin emedias dhe internetit** dhe me **Mundësuesin 16. Zbatimi paqartë i normave ndërkombëtare**. Në funksion të ndërhyrjes informative, ky kombinim krijon një mjedis të favorshëm për operacione ndikimi që shfrytëzojnë paqartësinë rregullatore dhe mungesën e përgjegjësisë ndërkufitare.

Rast ilustrues: Lobimi jashtë vendit dhe ndikimi në proceset zgjedhore

Kontratat lobuese dhe shpenzimet përkatëse të partive politike ose politikanëve në Shqipëri karakterizohen nga mungesa e transparencës dhe, në disa raste, kanë qenë objekt hetimesh penale. Një shembull i tillë është rasti i ish-Presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta, i cili është në paraburgim, në pritje të gjykimit për akuza që lidhen me korrupsion dhe pastrim parash. Ai akuzohet se nuk ka deklaruar qindra mijëra dollarë shpenzime për lobim në Shtetet e Bashkuara, të përdorura për të ndikuar politikën amerikane ndaj Shqipërisë dhe ndaj partisë të cilën ai drejton, Partia e Lirisë.⁷³

Marrëdhëniet me lobistë amerikanë shkaktuan polemika edhe në prag të zgjedhjeve parlamentare të 11 majit 2025, kur u bë publike se Partia Demokratike në opozitë, e drejtuar nga ish-Kryeministri Sali Berisha, kishte nënshkruar një kontratë lobimi në vlerën e 6 milionë dollarëve amerikanë në Shtetet e Bashkuara me kompaninë Continental Strategy LLC, e drejtuar nga Carlo Trujillo, ish-këshilltar i Presidentit amerikan Donald Trump. Shuma e konsiderueshme, e cila sipas raportimeve do të paguhej me këste prej 250,000 dollarësh nga një fondacion i përfaqësuar nga një emigrant shqiptaro-amerikan, çoi në nisjen e një hetimi nga SPAK-u.⁷⁴

⁷¹ Kuvendi i Shqipërisë. (2025). *Ligj nr. 47, datë 3.7.2025, Për miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja*. <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202507170801443359Ligj%20nr.%2047%2C%20dt%203.7.2025.pdf>

⁷² Këshilli i Ministrave. (2024). *Vendim nr. 611, datë 02.10.2024, Për miratimin e Udhërrëfyenis për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike*. <https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/VKM-nr-611-date-2.10.2024-Per-miratimin-e-Udherrefyenis-per-Funksionimin-e-Institucioneve-Demokratike.pdf>

⁷³ Hoxhaj, E. (2024, 21 tetor). Akuzat e SPAK: Tre dosjet e korrupsionit që çuan në pranga Ilir Metën. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2024/10/21/akuzat-e-spak-tre-dosjet-e-korrupsionit-qe-çuan-ne-pranga-ilir-meten/>

⁷⁴ Hoxhaj, E. (2025, 27 prill). SPAK heton kontratën e lobimit të PD-së në SHBA. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al>

Pas humbjes në zgjedhjet parlamentare të 2025, Partia Demokratike vijoi strategjinë e saj të ndikimit të jashtëm duke përdorur kompaninë lobuese me vlerë të lartë në Uashington për të sfiduar legjitimitetin e procesit zgjedhor. Përmes kontratës me Continental Strategy, PD-ja synoi të ndërkombëtarizonte pretendimet për manipulim zgjedhor, duke bërë thirrje për një hetim ndërkombëtar dhe për krijimin e një qeverie teknike. Kjo përpjekje synonte të kundërshtonte narrativën dominuese të qeverisë shqiptare mbi legjitimitetin demokratik të zgjedhjeve dhe të konsolidonte një kornizë alternative që e paraqet Shqipërinë si një sistem autokratik të karakterizuar nga korrupsioni, kapja e shtetit dhe krimi i organizuar.⁷⁵

Këto raste nxjerrin në pah disa vulnerabilitete kyçe të lidhura me FIMI-n për procesin zgjedhor në Shqipëri. Ndër to përfshihen përdorimi i lobimit profesional për të projektuar narrativa politike të kontestuara jashtë vendit, mjegullimi i kufirit midis advokimit legjitim dhe përpjekjeve për të delegjitimuar rezultatet zgjedhore në arenën ndërkombëtare, si dhe mungesa e transparencës mbi origjinën e burimeve financiare të përdorura nga aktorë politikë opozitarë për të ndikuar perceptimet e jashtme.

Zgjedhjet nuk janë i vetmi proces demokratik në Shqipëri që ka qenë objekt i fushatave të lobimit të huaj të kontraktuara nga politikanë shqiptarë. Institucionet e drejtësisë dhe antikorrupsionit, veçanërisht SPAK-u, kanë qenë gjithashtu shënjestër e fushatave të dezinformimit dhe propagandës të lidhura me kontrata lobimi dhe marrëdhënie me kompani të huaja PR, të nënshkruara nga politikanë nën hetim penal.

Përtej rasteve më lart, ish-Zëvendëskryeministri Arben Ahmetaj, si dhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, kanë hyrë gjithashtu në kontrata me kompani lobuese dhe PR-i jashtë vendit. Përmbajtje të prodhuara në këtë kuadër janë përkthyer dhe amplifikuar më pas nga media pranë qeverisë në Shqipëri, një praktikë që ekspertët e dezinformimit e përshkruajnë si “pastrim informacioni” (information laundering).⁷⁶

[al/2025/04/27/spak-heton-kontraten-e-lobimit-te-pd-se-ne-shba/](https://www.reporter.al/2025/04/27/spak-heton-kontraten-e-lobimit-te-pd-se-ne-shba/)

⁷⁵ Karaj, V. (2025, 29 maj). Lobimi i PD-së kundër legjitimitetit të zgjedhjeve në SHBA mbart pikëpyetje. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/29/lobimi-i-pd-kunder-legjitimitetit-te-zgjedhjeve-ne-shba-mbart-pikepyetje/>

⁷⁶ Karaj, V. (2025, 16 dhjetor). Fushata ndërkombëtare e PR-it për Veliajn dhe lavatrica mediatike shqiptare. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/12/16/fushata-nderkombetare-e-pr-it-per-veliajn-dhe-lavaticja-mediatike-shqiptare/>

Fusha 3

Media dhe informacioni zgjedhor midis pluralizmit formal dhe rregullimit të fragmentuar

Media dhe mjedisi informativ luajnë një rol qendror në mënyrën se si qytetarët informohen për procesin zgjedhor, aktorët politikë dhe alternativat zgjedhore. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, hapësira mediatike në Shqipëri u karakterizua nga përqendrim i pronësisë, rreshtim editorial, presione ekonomike dhe një ndërthurje e fortë mes medias tradicionale dhe asaj online, shpesh pa standarde të barabarta transparence dhe përgjegjshmërie.

Vulnerabilitetet strukturore të pluralizmit dhe pavarësisë së medias ndikojnë drejtpërdrejt cilësinë e debatit publik dhe krijojnë kushte ku përmbajtja e njëanshme, e manipuluar ose e orientuar politikisht mund të amplifikohet. Në këtë mjedis, media jo vetëm informon, por në disa raste shndërrohet në vektor të përhapjes së narrativave polarizuese dhe të disinformimit, përfshirë ato me burim të jashtëm.

Kjo fushë analizon pesë vulnerabilitete kryesore:

- mungesën e pluralizmit dhe pavarësisë së medias si bazë e vulnerabilitetit ndaj FIMI-t;
- kuadrin ligjor të kufizuar dhe rregullimin joefektiv të mbulimit audioviziv të fushatës zgjedhore;
- rolin e reklamave politike audiovizive në deformimin e konkurrencës zgjedhore;
- hapësirën e parregulluar të medias online dhe ekspozimin ndaj disinformimit; dhe
- praninë dhe ndikimin e mediave të huaja në hapësirën informative shqiptare.

Në tërësi, këto vulnerabilitete përshkruajnë një mjedis informativ të fragmentuar dhe të pabarabartë, ku kufijtë mes informimit, bindjes politike dhe manipulimit bëhen të paqartë, duke rritur rrezikun që FIMI të përhapet përmes kanaleve mediatike ekzistuese dhe të ndikojë perceptimet publike mbi procesin zgjedhor.

Mediat e
përqendruara
dhe të ndikuara
politikisht
dobësojnë
verifikimin dhe
amplifikojnë
manipulimin.

Mungesa e pluralizmit dhe pavarësisë së medias

Mjedisi mediatik në Shqipëri paraqet prej vitesh vulnerabilitete strukturore të thella si përqendrimi i lartë i pronësisë së medias, ndërthurja e interesave politike dhe ekonomike të pronarëve, mungesa e transparencës së financimit–veçanërisht në median online–dhe kushtet e pasigurta të punës për gazetarët. Këto faktorë krijojnë një mjedis ku media shpesh nuk funksionon si një ndërmjetës kritik mes politikës dhe publikut, por si një kanal riprodhimi i narrativave të aktorëve dominues politikë dhe institucionalë.^{77 78}

Sipas Komisioni Evropian, përqendrimi i pronësisë mediatike dhe mungesa e transparencës financiare vazhdojnë të ndikojnë negativisht në pavarësinë e medias në Shqipëri, ndërsa ndërhyrjet politike dhe ekonomike mbeten një shqetësim i vazhdueshëm. Gjetje të ngjashme pasqyrohen edhe në raportin e Monitorimit të Pluralizmit të Medias, i cili e klasifikon tregun mediatik shqiptar në kategorinë “rrezik i lartë” për pluralizmin, për shkak të përqendrimit horizontal të medias audiovizive dhe asaj të shkruar, mungesës së masave efektive rregullatore dhe ndikimit të pronarëve mbi linjat editoriale.⁷⁹ Monitorimet mbi pronësinë mediatike tregojnë se një numër shumë i kufizuar familjesh kontrollojnë shumicën dërrmuese të audiencës televizive dhe një pjesë të konsiderueshme të tregut të shtypit, duke centralizuar fuqinë për të formësuar diskursin publik.⁸⁰

Këto vulnerabilitete strukturore përkthehen drejtpërdrejt në praktika problematike editoriale, veçanërisht gjatë periudhave zgjedhore. Studimet tregojnë një nivel të lartë të përdorimit të materialeve (përmbajtjeve) të gatshme të prodhuara nga institucionet shtetërore, partitë politike dhe zyrat e komunikimit të liderëve politikë, të cilat transmetohen ose publikohen nga mediat si përmbajtje informative pa verifikim të pavarur, pa kontekst dhe, në shumicën e rasteve, pa identifikim të qartë si materiale propagandistike.⁸¹ Kjo praktikë redukton rolin e gazetarit në përpunimin kritik të informacionit dhe e zhvendos median drejt funksionit të shpërndarësit të mesazheve politike, duke zbehur kufirin mes informacionit, opinionit dhe propagandës.

⁷⁷ European Commission. (2025). *Report on Albania 2025* [Raporti për Shqipërinë 2025]. Bruksel. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en

⁷⁸ European Commission. (2025). *Rule of Law Report 2025 – Chapter on Albania* [Raporti për Shtetin e së Drejtës 2025 – Kapitulli për Shqipërinë]. Bruksel. https://commission.europa.eu/document/download/3732ae59-5ab4-48a6-a3e6-0ef9aa593863_en

⁷⁹ Likmeta, B., & Voko, K. (2025). *Monitoring Media Pluralism in the European Union: Results of the MPM2025 – Country report: Albania* [Monitorimi i Pluralizmit të Medias në Bashkimin Evropian: Rezultatet e MPM2025 – Raporti i Shqipërisë]. European University Institute, Centre for Media Pluralism and Media Freedom (CMPF). Florence. <https://cadmus.eui.eu/entities/publication/f5be0d78-00ae-4b29-aadb-b487390cfb2>

⁸⁰ Global Media Registry & BIRN Albania. (2023). *Media Ownership Monitor in Albania* [Monitori i Pronësisë së Medias në Shqipëri]. Tiranë. <https://albania.mom-gmr.org/en/>

⁸¹ Voko, K., Lelo, E., & Shehu, J. (2025). *Audiovisual Media Monitoring Report: Parliamentary Elections in Albania 2025* [Monitorimi i mediave audiovizive: Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri 2025]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/12/Audiovisual-Media-Monitoring-ENG.pdf>

Një faktor tjetër kyç që ndikon në cilësinë e raportimit është pasiguria në punë e gazetarëve. Kushtet e pasigurta të punës, mungesa e kontratave të qëndrueshme dhe presioni ekonomik rrisin vetëcensurën dhe ulin aftësinë e gazetarëve për t'i rezistuar ndërhyrjeve politike dhe ekonomike.⁸² Gjatë vitit 2025, kjo situatë u përkeqësua nga një sërë incidentesh të dokumentuara intimidimi, kërcënimesh dhe sulmesh verbale apo fizike ndaj gazetarëve gjatë fushatës zgjedhore, duke penguar mbulimin e pavarur të aktiviteteve zgjedhore.⁸³ Raste të tilla, të raportuara nga Rrjeti SafeJournalists, tregojnë se presioni ndaj gazetarëve nuk është vetëm strukturor, por edhe i drejtpërdrejtë dhe i lidhur me momente politike sensitive.

Vulnerabilitetet në standardet profesionale dhe etike të gazetarisë përbëjnë një tjetër element kyç të këtij vulnerabiliteti. Mungesa e burimeve, trajnimeve dhe politikave të qarta editoriale për verifikimin e informacionit—veçanërisht për çështje komplekse si politika ndërkombëtare, siguria dhe integrimi euroatlantik—krijon kushte për raportim sipërfaqësor, riprodhim të burimeve të jashtme dhe amplifikim të narrativave manipuluese.⁸⁴ Një shembull domethënës gjatë zgjedhjeve të vitit 2025 ishte rasti i publikimit dhe amplifikimit të analizave të atribuara një “analisteje” fiktive, e cila rezultoi të ishte një identitet i sajuar për të prodhuar legjitimitet artificial për narrativa politike të caktuara—një praktikë që reflekton vulnerabilitete serioze në kontrollin editorial dhe etikën profesionale.⁸⁵

Si pasojë e këtyre faktorëve të ndërthurur, besimi i publikut te media ka pësuar rënie të vazhdueshme. Sondazhet tregojnë se një pjesë e madhe e qytetarëve shqiptarë shprehin mosbesim ndaj medias tradicionale, ndërsa gjithnjë e më shumë informacion konsumohet përmes platformave të rrjeteve sociale, të cilat njëkohësisht përbëjnë një nga burimet kryesore të ekspozimit ndaj dezinformimit.⁸⁶ Ky deficit besimi e bën publikun më të ndjeshëm ndaj narrativave që delegjitojnë median tradicionale dhe e zhvendosin vëmendjen drejt burimeve alternative, shpesh të paqarta ose të manipuluar.

Ky vulnerabilitet përfaqëson një kombinim të **Mundësuesit 7. Mungesë e pluralizmit dhe pavarësisë së mediave, Mundësuesit 9. Gazetari e dobët dhe standarde të ulëta gazetareske dhe Mundësuesit 10. Rënie e besimit te burimet kryesore të lajmeve**. Së bashku, këta faktorë krijojnë një mjedis informativ të brishtë, ku media nuk arrin të filtrojë, verifikojë dhe kontekstualizojë informacionin

⁸² SCiDEV & BIRN Albania. (2024). Annual Report 2024: Tracking Albania's Progress on Media Freedom and Journalistic Safety in Line with EU Standards [Raporti vjetor 2024: Gjurmimi i progresit të Shqipërisë në lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve sipas standardeve të BE-së]. Tiranë. https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/02/Annual-Report-2024_ENG-1.pdf

⁸³ SafeJournalists Network. (2025). *Incidents Against Journalists in Albania: Monthly Reporting and Incident Database, May 2025* [Incidentet ndaj gazetarëve në Shqipëri: Raportim mujor dhe databazë incidentesh, maj 2025]. <https://safejournalists.net/>

⁸⁴ Kaziaj, E., & Keta, V. (2024, October). *The distribution of disinformation narratives by hostile actors against NATO and the EU in the Albanian media* [Distribucioni i narrativave dezinformuese nga aktorë armiqësorë kundër NATO-s dhe BE-së në median shqiptare]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2024/10/The-distribution-of-disinformation-narratives-by-hostile-actors-against-NATO-and-the-EU-in-the-Albanian-media.pdf>

⁸⁵ Karaj, V. (2025, 26 maj). Një cirk tragjik në median shqiptare: Një analiste e fabrikuar bëhet virale. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/26/nje-cirk-tragjik-ne-median-shqiptare-nje-analiste-e-fabrikuar-behet-virale/>

⁸⁶ Regional Cooperation Council. (2024). *Balkan Barometer 2024: Public Opinion Survey* [Balkan Barometer 2024: Opinioni e publikut]. Sarajevo. <https://www.rcc.int/seeds/results/2/balkan-barometer>

politik në mënyrë efektive. Në një mjedis të tillë, narrativat manipuluese–qofshin vendase apo të huaja–kanë më shumë gjasa të qarkullojnë pa u sfiduar, duke e bërë këtë vulnerabilitet një bazë strukturore mbi të cilën ndërtohen dhe amplifikohen format të ndryshme të FIMI-t gjatë proceseve zgjedhore.

Rregullimi i
dobët audioviziv
lejon ekspozim
të pabarabartë
zgjedhor.

Kuadër ligjor i kufizuar për median dhe mbulimin mediatik të fushatës

Pavarësisht disa parashikimeve në Kodin Zgjedhor që synojnë të garantojnë barazi në mbulimin mediatik gjatë fushatës, kuadri ligjor dhe rregullator për mediat audiovizive mbetet i pjesshëm dhe i prapambetur në raport me realitetin aktual të komunikimit politik. OSCE/ODIHR vëren se rregullimi ekzistues fokusohet kryesisht në edicionet informative, duke lënë jashtë vëmendjes pjesën më të madhe të hapësirës mediatike ku zhvillohet, në fakt, debati politik, përfshirë emisionet politike, intervistat e dedikuara dhe transmetimet e drejtpërdrejta të aktiviteteve të fushatës.⁸⁷

Monitorimi i mediave audiovizive nga BIRN Albania gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025 konfirmon se këto formate jo vetëm që zënë një peshë të konsiderueshme në programacionin e televizioneve, por shpesh funksionojnë si kanale kryesore të ekspozimit politik.⁸⁸ Megjithatë, ato nuk i nënshtrohen asnjë kërkesë të qartë ligjore për barazi dhe transparencë të përmbajtjes si të sponsorizuar ose paguar, duke krijuar një hendek të madh mes rregullimit formal dhe praktikës reale. Në mungesë të rregullave specifike, sipas monitorimit, televizione të ndryshme transmetuan intervista të dedikuara, programe “speciale” ose mbulim të zgjatur “live” për aktorë të caktuar politikë, pa asnjë detyrim për të ofruar trajtim të krahasueshëm për subjektet e tjera.⁸⁹

Një tjetër problem i identifikuar lidhet me mungesën e parashikimeve të qarta për ndalimin ose identifikimin e formave hibride të përmbajtjes, që ndodhen në kufirin mes informacionit redaksional dhe promovimit politik. Raportet e OSBE/ODIHR dhe monitorimet e organizatave vendase vërejnë se intervistat e strukturuara, kronikat e gjata apo formatet e personalizuara shpesh u përdorën për të përcjurar mesazhe fushate, pa u shënuar qartë si përmbajtje e sponsorizuar

⁸⁷ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odihr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

⁸⁸ Voko, K., Lelo, E., & Shehu, J. (2025). *Audiovisual Media Monitoring Report: Parliamentary Elections in Albania 2025* [Monitorimi i mediave audiovizive: Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri 2025]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/12/Audiovisual-Media-Monitoring-ENG.pdf>

⁸⁹ Likmeta, B. (2025, 29 prill). Mediat televizive kthehen në zgjatim të propagandës partiake gjatë fushatës. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/04/29/mediat-televizive-kthehen-ne-zgjatim-te-propagandes-partiake-gjate-fushates/>

apo e paguar.^{90 91} Kjo paqartësi cenon transparencën për publikun dhe e bën të vështirë mbikëqyrjen efektive nga autoritetet përgjegjëse.

Edhe në rastet kur u evidentuan shkelje minimale të kuadrit ekzistues, mekanizmat sanksionues rezultuan të dobët. Kodi Zgjedhor nuk parashikon sanksione specifike për shumicën e këtyre praktikave, ndërsa gjobat e aplikueshme për shkelje të tjera janë simbolike dhe shumë të ulëta, duke mos krijuar efekt parandalues për transmetuesit.⁹² Si rezultat, sanksionet e mundshme për shkeljet nuk perceptohen si rrezik real për mediat, por si kosto të papërfillshme operationale gjatë fushatës.

Ky kombinim i rregullimit të cunguar ligjor dhe mungesës së llogaridhënies efektive krijoi kushte për pabarazi të theksuar në mbulimin mediatik të procesit zgjedhor. Monitorimi i BIRN dokumenton diferenca të mëdha në kohë transmetimi dhe dukshmëri mes subjekteve politike, veçanërisht në formatet që nuk përfshihen në llogaritjen formale të mbulimit informativ.⁹³ Kjo pabarazi nuk ishte thjesht pasojë e zgjedhjeve editoriale individuale, por rrjedhojë e drejtpërdrejtë e një kuadri rregullator që nuk i përgjigjet strukturës reale të ekosistemit mediatik.^{94 95}

Nga perspektiva e integritetit zgjedhor dhe FIMI-t, ky vulnerabilitet ka rëndësi të veçantë. Një kuadër ligjor që rregullon vetëm një pjesë të kufizuar të përmbajtjes audiovizive dhe që dështon të adresojë formatet më ndikuese të komunikimit politik krijon hapësirë për manipulim selektiv të dukshmërisë, përforcim të narrativave dominuese dhe delegitimim indirekt të aktorëve më pak të ekspozuar.^{96 97}

⁹⁰ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odhr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

⁹¹ Gjoka, B. (2025, 14 maj). Partitë dhe kandidatët nuk respektuan lirinë dhe transparencën mediatike. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/14/partite-dhe-kandidatet-nuk-respektuan-lirine-dhe-transparencen-mediatike/>

⁹² OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odhr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

⁹³ Voko, K., Lelo, E., & Shehu, J. (2025). *Audiovisual Media Monitoring Report: Parliamentary Elections 2025* [Monitorimi i mediave audiovizive: Zgjedhjet parlamentare 2025]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/12/Audiovisual-Media-Monitoring-ENG.pdf>

⁹⁴ Likmeta, B. (2025, 29 prill). Mediat televizive kthehen në zgjatim të propagandës partiake gjatë fushatës. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/04/29/mediat-televizive-kthehen-ne-zgjatim-te-propagandes-partiake-gjate-fushates/>

⁹⁵ Likmeta, B. (2025, 15 maj). Kontrolli mbi mediat shtroi rrugën për mandatin e katërt të Partisë Socialiste. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/15/kontrolli-mbi-mediat-shtroi-rrugen-per-mandatin-e-katert-te-partise-socialiste/>

⁹⁶ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odhr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

⁹⁷ European Commission. (2025). *Report on Albania 2025* [Raporti për Shqipërinë 2025]. Bruksel. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en

Ky vulnerabilitet lidhet kryesisht me **Mundësuesin 14. Autoritete rregullatore joefektive** dhe **Mundësuesin 15. Boshllëqe në rregullimin e medias dhe internetit**, ndërsa ndërvepron edhe me **Mundësuesin 7. Mungesë pluralizmi dhe pavarësisë së mediave**, duke krijuar kushte strukturore që rrisin vulnerabilitetin e procesit zgjedhor ndaj manipulimit të informacionit.

Në këtë kontekst, analiza e mëposhtme e mbulimit audioviziv gjatë fushatës së zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025 shërben si një rast ilustrues për të ilustruar se si vulnerabilitetet strukturore të pluralizmit, rregullimit dhe praktikave editoriale u përkthyen në pabarazi konkrete zgjedhore, duke krijuar kushte të favorshme për deformimin e konkurrencës politike dhe për amplifikimin e narrativave dominuese.

Rast ilustrues: Pabarazia në mbulimin audioviziv gjatë fushatës zgjedhore

Monitorimi i mediave audiovizive gjatë fushatës së zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025 dokumenton një model të qëndrueshëm dhe të thelluar pabarazie në mbulimin zgjedhor, i cili shkon përtej devijimeve editoriale të zakonshme dhe reflekton një vulnerabilitet strukturor të ekosistemit mediatik shqiptar. Gjetjet nga monitorimi i Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA) të analizuar nga BIRN,⁹⁸ tregojnë se, pavarësisht detyrimeve ligjore për garantimin e pluralizmit dhe aksesit të barabartë, konkurrenca zgjedhore në hapësirën audiovizive u dominua pothuajse tërësisht nga dy subjektet kryesore politike: Partia Socialiste dhe Aleanca për Shqipërinë Madhështore.

Këto dy subjekte përqendruan mbi 75% të kohës së transmetimit në formatet kryesore të mbulimit zgjedhor—përfshirë edicionet informative, transmetimet *live* dhe emisionet politike—duke lënë hapësirë minimale për subjektet e tjera. Pabarazia ishte veçanërisht e theksuar në edicionet e lajmeve, ku dy subjektet dominante përfituan 93.9% të kohës totale të transmetimit, ndërsa të gjithë subjektet e tjera së bashku u kufizuan në vetëm 6.1%. Ky nivel ekspozimi është shumë më poshtë pragut minimal të parashikuar nga Kodi Zgjedhor për garantimin e pluralizmit, i cili synon që subjektet e tjera të kenë të paktën gjysmën e kohës së akorduar për partitë kryesore.

Edhe në median publike, ku detyrimet ligjore për balancë janë më të qarta, shpërndarja e kohës nuk arriti standardet e kërkuara. RTSH 1 dhe RTSH 24 shfaqën një ndarje relativisht më të balancuar krahasuar me transmetuesit privatë, por edhe aty subjektet e vogla zgjedhore përfituan pak më shumë se 17% të kohës në edicionet informative—një nivel ende i pamjaftueshëm për

⁹⁸ Voko, K., Lelo, E., & Shehu, J. (2025). *Audiovisual Media Monitoring Report: Parliamentary Elections 2025* [Monitorimi i mediave audiovizive: Zgjedhjet parlamentare 2025]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/12/Audiovisual-Media-Monitoring-ENG.pdf>

të garantuar barazi reale në aksesin ndaj publikut. Në transmetimet *live* dhe emisionet politike, hendeku u thellua edhe më tej, duke riprodhuar të njëjtin model përqendrimi të dukshmërisë.

Një element thelbësor i këtij rasti lidhet me personalizimin e mbulimit zgjedhor. Analiza tregon se narrativa mediatike u ndërtua kryesisht rreth dy figurave kryesore politike, Edi Rama dhe Sali Berisha, të cilët së bashku përfituan mbi dy të tretat e mbulimit *live* të dedikuar aktorëve individualë. Ky fokus i ngushtë mbi liderët e partive më të mëdha forcoi një logjikë fushate të orientuar drejt figurave dhe jo programeve, duke zhvendosur vëmendjen nga platformat politike, kandidatët e tjerë dhe alternativat politike. Në emisionet politike, kjo prirje u përforcua nga formatet “një-për-një” dhe profilet e kuruara, të cilat rritën ekspozimin individual, por shmangën debatet konkurruese dhe ballafaqimin kritik të ideve.

Monitorimi evidenton gjithashtu kufizime serioze në mbikëqyrjen e mediave lokale dhe rajonale. Edhe pse AMA përfshiu formalisht 57 transmetues audiovizivë në skemën e monitorimit, vëzhgimi i mediave lokale u krye vetëm në mënyrë të pjesshme dhe me rotacion, për shkak të kufizimeve në burime. Kjo e bën të pamundur një vlerësim të plotë mbi rolin e mediave lokale në garantimin e pluralizmit, duke krijuar një “zonë të errët” ku shkeljet potenciale ose pabarazitë strukturore mbeten të padokumentuara.

Këto të dhëna ilustron se si pabarazia ekstreme në mbulimin audioviziv, e kombinuar me personalizimin e diskursit dhe vulnerabilitetet rregullatore, krijojnë një mjedis të favorshëm për delegjitimimin e konkurrencës politike. Kur shumica e aktorëve politikë mbeten praktikisht të padukshëm në median me ndikimin më të madh publik, hapësira zgjedhore ngushtohet artificialisht dhe perceptimi i zgjedhjes demokratike deformohet. Nga perspektiva e FIMI-t, ky konfigurim e shndërron median audiovizive në një pikë strukturore amplifikimi, ku narrativat dominuese fitojnë legjitimitet institucional dhe më pas qarkullojnë e përforcohen në hapësirën digjitale.

Reklamat politike audiovizive dhe deformimi i konkurrencës zgjedhore

Kuadri ligjor shqiptar për rregullimin e reklamave politike në median audiovizive synon, në parim, të garantojë kushte të barabarta gare ndërmjet subjekteve zgjedhore. Kodi Zgjedhor përcakton kufij maksimalë për minutazhin e reklamave që një subjekt mund të transmetojë në secilin operator audioviziv, fashat kohore të lejuara për transmetim, si dhe detyrimin që çmimi për minutë reklamimi të jetë i njëjtë për të gjitha subjektet zgjedhore. Këto dispozita synojnë të kufizojnë avantazhin financiar dhe të parandalojnë dominimin e hapësirës mediatike nga

Reklamimi
televiziv i
pabarabartë dhe
jo transparent
shtrembëron
konkurrencën.

aktorë me burime më të mëdha financiare, duke rritur transparencën dhe barazinë formale të garës zgjedhore.⁹⁹

Megjithatë, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 dhe ato të mëparshme, zbatimi praktik i këtij kuadri ka mbetur i kufizuar. OSBE/ODIHR vëren se, pavarësisht ekzistencës së rregullave të detajuara, mbikëqyrja dhe zbatimi i tyre nuk kanë qenë gjithmonë efektive, duke krijuar hapësira për shmangie dhe për përdorim selektiv të reklamimit politik.¹⁰⁰ Një nga vulnerabilitetet strukturore lidhet me mospërbushjen e detyrimeve ligjore nga subjektet zgjedhore për dorëzimin paraprak të tarifave të reklamimit pranë KQZ-së, duke kufizuar aftësinë e institucioneve për të ushtruar kontroll real gjatë fushatës dhe zhvendosur mbikëqyrjen në një fazë pas-zgjedhore.

Këto problematika u thelluan më tej nga ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, të miratuara pak përpara zgjedhjeve të vitit 2025, të cilat zgjeruan të drejtën për blerjen e kohës televizive jo vetëm për subjektet zgjedhore, por edhe për kandidatët individualë në listat e hapura.¹⁰¹ Ndërsa kjo masë u paraqit si një përpjekje për të rritur konkurrencën brenda listave, në praktikë ajo e bëri monitorimin e reklamimit politik edhe më kompleks dhe e vështirësoi interpretimin e të dhënave të ofruara nga monitorimi i AMA-s. Fragmentarizimi i blerjeve të reklamave mes partive dhe kandidatëve individualë rriti rrezikun e paqartësisë mbi burimin real të fondeve dhe mbi respektimin e kufijve ligjorë të minutazhit dhe koston.

Një precedent domethënës për këto vulnerabilitete u vendos gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021. Në atë cikël zgjedhor, BIRN dokumentoi se partitë politike transmetuan reklama televizive me një vlerë të përlogaritur rreth 5.1 milionë euro, ndërkohë që në raportimet zyrtare të dorëzuara në KQZ u deklaruan vetëm rreth 685 mijë euro shpenzime për reklama.¹⁰² Kjo mospërputhje e theksuar sugjeroi përdorimin e donacioneve në natyrë të padeklaruara dhe kanaleve jo transparente të financimit të fushatës. Si pasojë, për herë të parë në Shqipëri u aplikuan sanksione për shkelje që lidhen me ekspozimin mediatik të padekluarar: në dhjetor 2022, KQZ-ja vendosi gjoba ndaj partive politike dhe sanksionoi disa media audiovizive për tejkallim të kufirit ligjor prej 90 minutash për reklamim politik.

Edhe gjatë zgjedhjeve të vitit 2025, monitorimi audioviziv i BIRN dhe të dhënat e AMA-s tregojnë se problematikat strukturore të reklamimit politik mbetën të pranishme, veçanërisht në aspektin e transparencës, identifikimit të qartë të

⁹⁹ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odhr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

¹⁰⁰ OSCE/ODIHR. (2025). *Preliminary Findings and Conclusions – Parliamentary Elections in Albania, 11 May 2025* [Gjetjet dhe përfundimet paraprake – Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri, 11 maj 2025]. Warsaw. https://odhr.osce.org/sites/default/files/f/documents/4/f/590598_4.pdf

¹⁰¹ Barjamemaj, A. (2025, 11 shkurt). PS-PD miratojnë së bashku rritjen e financimeve dhe kohës televizive në fushatë. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/02/11/ps-pd-miratojne-se-bashku-rritjen-e-financimeve-dhe-kohes-televizive-ne-fushate/>

¹⁰² Likmeta, B. (2021, 11 qershor). Albanian Parties' Election TV Ads Blitz Goes Unsanctioned [Partitë politike shpenzuan miliona euro për propagandën elektorale në TV]. *Balkan Insight*. <https://balkaninsight.com/2021/06/11/albanian-parties-election-tv-ads-blitz-goes-unsanctioned/>

përmbajtjes së paguar dhe respektimit të kufijve ligjorë.¹⁰³ Këto vulnerabilitete, të cilat detajohen në rastin ilustrues më poshtë, krijojnë kushte të favorshme për deformimin e konkurrencës zgjedhore dhe për përforsimin e narrativave delegjtimuese mbi procesin, të cilat e paraqesin atë si të ndikuar nga interesa financiare dhe mediatike të fshehta.

Në këtë kuptim, reklamat politike audiovizive të pabarabarta dhe favorizuese përbëjnë një vulnerabilitet të rëndësishëm ndaj FIMI-t. Vulnerabilitetet në zbatimin e ligjit dhe garantimin e transparencës krijojnë hapësirë për ndikim të fshehtë financiar, për shtrembërim të perceptimit publik dhe për narrativë manipuluese që minojnë besimin te barazia e garës. Ky vulnerabilitet lidhet me **Mundësuesin 2. Rregullim i pamjaftueshëm mbi financimin politik** dhe **Mundësuesin 14. Autoritete rregullatore joefektive**, ndërsa ndërvepron edhe me **Nxitësin 1. Model biznesi mediatik i orientuar nga angazhimi i audiencës**, duke e bërë median audiovizive një pikë kyçe rreziku në ekosistemin e manipulimit informativ gjatë fushatave zgjedhore.

Rast ilustrues: Reklamat politike audiovizive gjatë zgjedhjeve parlamentare 2025

Gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025, reklamat politike në median audiovizive luajtën një rol dytësor krahasuar me format e tjera të komunikimit zgjedhor, si mbulimi në edicionet e lajmeve, apo transmetimet *live* dhe emisionet politike. Monitorimi i 15 televizioneve qendrore private me shtrirje kombëtare—duke përjashtuar transmetuesit publikë, të cilët nuk lejohen ligjërisht të transmetojnë reklama të paguara—tregon se gjatë periudhës zyrtare të fushatës (11 prill–9 maj 2025) u transmetuan gjithsej 1,713 minuta reklama politike, ose pak më shumë se 28 orë përmbajtje. Ky volum relativisht i ulët konfirmon një prirje të njohur në Shqipëri: reklamat e paguara nuk janë instrumenti kryesor i fushatës, ndërsa subjektet politike mbështeten kryesisht në dukshmërinë “e fituar” përmes mediave informative dhe formateve editoriale më pak të rregulluara.¹⁰⁴

Megjithatë, edhe ky volum i kufizuar reklamash u karakterizua nga pabarazi ekstreme në shpërndarje. Dy subjektet kryesore politike—Aleanca për Shqipërinë Madhështore dhe Partia Socialiste—dominuan pothuajse të gjithë hapësirën e reklamimit të paguar. Aleanca për Shqipërinë Madhështore përfitoi 910 minuta reklamim (53.1% e totalit), ndërsa Partia Socialiste 756 minuta (44.1%). Të gjitha subjektet e tjera zgjedhore së bashku u shfaqën për 1.6 minuta reklama, një hapësirë simbolike që nënvizon kufizimet reale të aktorëve të vegjël dhe të rinj politikë për të përdorur këtë format komunikimi. Kjo shpërndarje reflekton jo vetëm diferenca të thella në burime financiare, por edhe një mjedis rregullator që nuk krijon stimuj realë për përdorim më të barabartë të reklamimit audioviziv.

¹⁰³ Voko, K., Lelo, E., & Shehu, J. (2025). *Audiovisual Media Monitoring Report: Parliamentary Elections 2025* [Monitorimi i mediave audiovizive: Zgjedhjet parlamentare 2025]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/12/Audiovisual-Media-Monitoring-ENG.pdf>

¹⁰⁴ Voko, K., Lelo, E., & Shehu, J. (2025). *Audiovisual Media Monitoring Report: Parliamentary Elections 2025* [Monitorimi i mediave audiovizive: Zgjedhjet parlamentare 2025]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/12/Audiovisual-Media-Monitoring-ENG.pdf>

Analiza e të dhënave të detajuara sipas televizioneve tregon se reklamimi politik u përqendrua në një numër të kufizuar kanalesh. Në disa raste, dominimi i një subjekti të vetëm në një kanal ishte i theksuar. Për shembull, në një televizion informativ, Partia Socialiste transmetoi mbi 130 minuta reklama, ndërsa subjekti kryesor rival vetëm pak minuta. Kjo shpërndarje e pabalancuar përforcon perceptimin se aksesimi i reklamimit televiziv është selektiv dhe i lidhur ngushtë me marrëdhënie të konsoliduara mes aktorëve politikë dhe mediave të caktuara.

Përtej pabarazisë në akses, monitorimi evidentoi shkelje të përsëritura të kuadrit ligjor që rregullon reklamën politike. AMA dokumentoi raste të reklamave të transmetuara jashtë fashave kohore të lejuara, tejkalim të kufijve maksimalë të minutazhit, si dhe dështim për të identifikuar qartë përmbajtjen si reklamë politike. Konkretisht, 14 televizione kombëtare dhe lokale transmetuan reklama politike jashtë periudhës së lejuar ligjërisht, ndërsa 10 transmetues shfaqën gjithsej 64 reklama pa asnjë shënim që identifikonte subjektin sponsorizues. Në dy raste të dokumentuara, reklamën politike u integruan brenda edicioneve të lajmeve, duke shkelur parimin themelor të ndarjes mes përmbajtjes editoriale dhe asaj të paguar. Gjithashtu, disa media transmetuan sondazhe zgjedhore pa ofruar informacion bazë metodologjik, duke cenuar transparencën dhe duke rritur rrezikun e manipulimit të perceptimit publik.

Edhe pse përqindja e reklamave të paidentifikuara ishte relativisht e ulët në raport me totalin, vetë ekzistenca e tyre është domethënëse në një mjedis zgjedhor të polarizuar dhe me besim të ulët publik. Reklamën e pa identifikuar e vështirësojnë dallimin mes informacionit dhe propagandës, shtrembërojnë perceptimet mbi mbështetjen reale politike dhe krijojnë hapësira për dyshime mbi burimet financiare të fushatës. Në mungesë të një reagimi të shpejtë dhe sanksioneve efektive gjatë fushatës, këto shkelje prodhojnë efekt kryesisht pas-zgjedhor, duke e kufizuar funksionin parandalues të rregullimit.

Në tërësi, këto të dhëna tregojnë se reklamën politike audiovizive në zgjedhjet e vitit 2025 nuk funksionuan si një mekanizëm për të balancuar konkurrencën, por pasqyruan dhe përforcuan pabarazitë ekzistuese. Dominimi i dy subjekteve kryesore politike, hapësira minimale për partitë e vogla, shkeljet e rregullave të transparencës dhe mungesa e ndërhyrjeve rregullatore e shndërrojnë reklamimin audioviziv në një vulnerabilitet të rëndësishëm ndaj FIMI-t. Në këtë kontekst, vulnerabilitetet në zbatim dhe mbikëqyrje nuk krijojnë domosdoshmërisht manipulim të drejtpërdrejtë të mesazhit, por prodhojnë kushte strukturore ku perceptimi i pabarazisë, ndikimit të fshehtë financiar dhe mungesa e llogaridhënies ushqen narrativa delegjitimimi të procesit zgjedhor dhe minon besimin publik në barazinë e garës.

Hapësira e parregulluar e medias online dhe ekspozimi ndaj disinformimit

Një hapësirë online e parregulluar mundëson amplifikim informacioni me përgjegjësi të ulët.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, media online ishte një hapësirë informimi me mbikëqyrje minimale. Standardet e transparencës (për pronësinë, financimin, sponsorizimin dhe reklamën politike online) mbeten të paformalizuara dhe, në praktikë, të pazbatueshme në mënyrë konsistente. Kjo krijon një mjedis ku përmbajtja me burim të paqartë qarkullon me kosto të ulët dhe me pak rrezik llogaridhënieje, ndërkohë që “gjurmët” e financimit apo origjinës editoriale shpesh nuk janë të verifikueshme. Në këtë kuptim, boshllëqet rregullatore dhe mungesa e një monitorimi të institucionalizuar e shtyjnë fushatën digjitale drejt një logjike “vizibilitet i ulët–përgjegjshmëri e ulët”, ku aktorët mund të prodhojnë dhe shpërndajnë informacion pa transparencë, sidomos përmes ekosistemeve hibride portal–rrjete sociale.¹⁰⁵

Këto kushte ndikojnë drejtpërdrejt në pabarazinë e vizibilitetit dhe në cilësinë e debatit publik. Monitorimi i BIRN për median online gjatë zgjedhjeve të 2025, tregon se mbulimi u karakterizua nga personalizimi i fortë, ritmi i lartë i riprodhimit të deklaratave dhe një strukturë diskursi që i shërben më shumë konkurrencës së liderëve politikë sesa informimit programor.¹⁰⁶ Ky model editorial gjatë fushatës nxori në pah “duopolin” e liderëve dhe subjekteve kryesore politike (me dominim të qartë në hapësirën e lajmeve online) si prirje të qëndrueshme, ndërsa partitë e reja u lanë në periferi të vëmendjes editoriale.^{107 108} Këto praktika e kthejnë garën në një treg të klikimeve dhe replikave politike, duke krijuar terren të favorshëm për fragmentimin e informacionit dhe për qarkullimin e narrativave polarizuese pa filtrat minimalë të verifikimit.

Një dimension i veçantë i vulnerabilitetit lidhet me transparencën e reklamimit politik online. Në raportet financiare të subjekteve zgjedhore për fushatën e vitit 2023 (si precedent i përafërt i analizuar nga BIRN) shpenzimet e deklaruara për rrjetet sociale dhe për komponentë të komunikimit digjital nuk e bëjnë të qartë peshën reale të fushatës online. Ndërsa kategoria specifike e raportimit “media online/digjitale” paraqitet me gjurmueshmëri të kufizuar.¹⁰⁹ Në këtë kontekst, pa

¹⁰⁵ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odhr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

¹⁰⁶ Voko, K., Babameto, S., & Keta, V. (2025). *Online Media Monitoring Report 2025* [Monitorimi online i mediave 2025]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/12/Online-Media-Monitoring-ENG.pdf>

¹⁰⁷ Likmeta, B. (2025, 28 prill). Sy m’sy: Duopoli Rama–Berisha dominon median online gjatë fushatës zgjedhore. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/04/28/sy-msy-duopoli-rama-berisha-dominon-median-online-gjate-fushates-zgjedhore/>

¹⁰⁸ Likmeta, B. (2025, 19 maj). Media online injoroi fushatën e partive të reja në zgjedhjet parlamentare. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/19/media-online-injoroi-fushaten-e-partive-te-reja-ne-zgjedhjet-parlamentare/>

¹⁰⁹ Voko, K., Likmeta, B., & Erebara, G. (2025). *Analysis of the Financial Reports of Electoral Subjects on the 2023 Electoral Campaign* [Analiza e raporteve financiare të subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore 2023]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/01/Analysis-of-the-Financial-Reports-of-Electoral->

standarde të detyrueshme për raportim, tregu i reklamimit politik online mbetet praktikisht i pa-auditueshëm. Në realitet, fushata digjitale është intensive, megjithatë ajo mbetet e padukshme për mekanizmat formalë të kontrollit.

Gjithashtu, këto boshllëqe rrisin ekspozimin e medias online ndaj disinformimit të importuar dhe narrativave me burim të huaj, sepse qarkullimi ndërkuftar i përmbajtjes online ndodh me pak sinjalizime për origjinën, motivimin apo financimin. Raporti i BIRN mbi shpërndarjen e narrativave dezinformuese kundër NATO-s dhe BE-së në median shqiptare thekson se ekosistemi informativ (sidomos në segmentin online) është i ekspozuar ndaj riprodhimit mekanik të materialeve, dobësive në filtrat editoriale dhe mungesës së verifikimit të burimeve—duke krijuar kanale të përshtatshme për përhapjen e narrativave të jashtme pa transparencë.¹¹⁰ Qarkullimi i shpejtë i përmbajtjes së ricikluar dhe i profileve me kredenciale të paqarta tregon se mekanizmat e verifikimit dhe korrigjimit nuk funksionojnë në të njëjtin ritëm me amplifikimin digjital. Si pasojë, legjitimiteti i diskursit mund të prodhohet artificialisht përmes përsëritjes dhe dukshmërisë, duke ndikuar në debatin publik përpara se ndërhyrjet korrigjuese të bëhen të dukshme ose efektive.

Ky vulnerabilitet lidhet drejtpërdrejt me **Mundësuesin 11. Mjedise digjitale të fragmentuara të informacionit** dhe **Mundësuesin 12. Mundësia për t'u shfrytëzuar e teknologjive digjitale dhe të rrjeteve sociale**, sepse mungesa e rregullimit dhe e monitorimit e bën ekosistemin online të lehtë për t'u manipuluar dhe të vështirë për t'u audituar.¹¹¹ Njëkohësisht, ai lidhet me **Nxitësin 1. Modeli i biznesit mediatik i orientuar nga angazhimi i audiencës**, që favorizon viralitetin përballë saktësisë, dhe me **Nxitësit 3 dhe 4. Përdorimi i fondeve të huaja për qëllime mediatike** dhe **Disponueshmëria e përmbajtjes informative nga burime të huaja**, sepse përmbajtja ndërkuftare mund të bëhet pjesë e ekosistemit online dhe të riciklohet pa transparencë dhe pa përgjegjësi editoriale të qarta.

[Subjects-on-the-2023-Electoral-Campaign-.pdf](#)

¹¹⁰ Kaziaj, E., & Keta, V. (2024). *The distribution of disinformation narratives by hostile actors against NATO and the EU in the Albanian media* [Distribucioni i narrativave dezinformuese nga aktorë armiqësorë kundër NATO-s dhe BE-së në mediat shqiptare]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2024/10/The-distribution-of-disinformation-narratives-by-hostile-actors-against-NATO-and-the-EU-in-the-Albanian-media.pdf>

¹¹¹ Voko, K., Babameto, S., & Keta, V. (2025). *Online Media Monitoring Report 2025* [Monitorimi online i mediave 2025]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/12/Online-Media-Monitoring-ENG.pdf>

Rast ilustrues: Pabarazia strukturore dhe reklammat politike në mediat online gjatë zgjedhjeve 2025

Gjatë zgjedhjeve parlamentare të majit 2025, media online në Shqipëri u shfaq si një nga hapësirat më problematike për integritetin e informacionit zgjedhor. Monitorimi i realizuar nga BIRN Albania evidentoi se, ndonëse mediat online janë një ndër burimet kryesore të informacionit për një pjesë të madhe të publikut, ato funksionuan në një mjedis pothuajse tërësisht jashtë rregullimit zgjedhor, pa monitorim institucional sistematik dhe me standarde të paqarta transparence dhe llogaridhënieje¹¹². Kjo situatë krijoi kushte të favorshme për pabarazi të theksuara në mbulim, qarkullim të përmbajtjeve të paidentifikuara dhe rritje të ekspozimit ndaj disinformimit.

Të dhënat nga fushata e vitit 2025 tregojnë se mbulimi online gjatë fushatës u dominua pothuajse plotësisht nga dy subjektet kryesore politike. Diskursi mediatik u personalizua rreth liderëve kryesorë dhe konflikteve mes tyre, ndërsa partitë e reja, kandidatët alternativë dhe temat programore mbetën në periferi të vëmendjes. Në shumë raste, mbulimi për këta aktorë ishte sporadik, reaktiv ose i lidhur me polemika, duke kufizuar ndjeshëm mundësinë e tyre për të komunikuar platforma politike apo për t'u perceptuar si alternativa legjitime nga votuesit. Ky model përforcoi logjikën e një gare politike të mbyllur, ku pluralizmi formal nuk u reflektua në pluralizëm të vërtetë informativ.

Një problem kyç i evidentuar nga monitorimi lidhet me natyrën e përmbajtjes së publikuar. Më shumë se gjysma e artikujve të analizuar përbëheshin nga deklaratat politike të papërpunuara, replika dhe kundërreplika, shpesh pa verifikim faktik, kontekst apo analizë kritike. Kjo qasje e reduktoi median online në një kanal shpërndarjeje të mesazheve politike, duke dobësuar funksionin e saj informues dhe ndërmjetësues. Në mungesë të filtrave editorialë të fortë, narrativat emocionale, polarizuese apo spekulative qarkulluan me lehtësi, duke ndikuar në mënyrën se si publiku i perceptoi aktorët politikë dhe vetë procesin zgjedhor.

Përveç monitorimit të mbulimit editorial, BIRN Albania shqyrtoi vendosjen e reklamave politike në formë baneri në mediat online gjatë periudhës 30-ditore të fushatës. Një total prej 90 reklamash në formë baneri që promovonin subjekte zgjedhore ose kandidatë u regjistruan. Në mënyrë të ngjashme me trendet editoriale, edhe hapësira e reklamave u dominua nga dy subjektet kryesore zgjedhore. Partia Socialiste e Shqipërisë përbënte 45.6% të të gjitha reklamave të regjistruara (41 reklama), e ndjekur nga koalicioni Aleanca për Shqipërinë Madhështore e udhëhequr nga Partia Demokratike, e cila regjistroi 36.7% (33 reklama). Pothuajse gjysma e të gjitha reklamave në formë baneri (48%) të vendosura gjatë fushatës promovonin subjekte zgjedhore ose mesazhe partiake, ndërsa pjesa tjetër u përqendrua në kandidatë specifikë, duke reflektuar një strategji të dyfishtë imazhi, mes fushatës së partisë dhe fushatës së personalizuar.

¹¹² Voko, K., Babameto, S., & Keta, V. (2025). *Online Media Monitoring Report 2025* [Monitorimi online i mediave 2025]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/12/Online-Media-Monitoring-ENG.pdf>

Edhe pse reklamat politike digjitale përbëjnë një komponent gjithnjë e më të rëndësishëm të fushatave moderne, transparenca mbi financimin e tyre mbetet e kufizuar. Kjo mospërputhje mes realitetit të dukshëm dhe raportimit financiar e bën të pamundur verifikimin e barazisë së garës dhe krijon hapësirë për financime të paqarta ose të maskuara, një rrezik i drejtpërdrejtë për integritetin zgjedhor.

Në tërësi, ky rast ilustrues tregon se media online gjatë zgjedhjeve parlamentare 2025 funksionoi si një hapësirë me rrezik të lartë për deformimin e konkurrencës politike dhe për përhapjen e narrativave manipuluese. Kombinimi i mungesës së rregullimit, monitorimit të fragmentuar, pabarazive strukturore në mbulim dhe transparencës së dobët financiare krijoi një mjedis ku aktorët me më shumë burime dhe ndikim dominuan diskursin, ndërsa aktorët e rinj dhe temat alternative mbetën të marginalizuara.

Platformat e
parregulluara
operojnë pa
detyrime të qarta
transparence gjatë
zgjedhjeve.

Prania dhe ndikimi i mediave të huaja në hapësirën informative shqiptare

Një burim i rëndësishëm i vulnerabilitetit të proceseve zgjedhore ndaj FIMI-t në Shqipëri lidhet me integrimin dhe amplifikimin e narrativave me burim të huaj në ekosistemin informativ vendas, përmes mediave online, ripublikimeve dhe rrjeteve digjitale ndërkufitare. Në një treg mediatik me transparencë të kufizuar mbi pronësinë, financimin dhe origjinën editoriale të përmbajtjes, këto prurje të jashtme shpesh riqarkullohen si “lajm vendas”, duke krijuar legjitimitet të rremë dhe duke u bërë pjesë e ciklit informativ dhe atij zgjedhor pa gjurmueshmëri të mjaftueshme.

Vulnerabiliteti zgjedhor nuk qëndron te vetë ekzistenca e mediave të huaja, por te funksioni që përmbajtja e tyre merr gjatë periudhave zgjedhore: si burim bazë që riprodhohet nga media vendase, si material i gatshëm për portale me kosto të ulët riprodhimi dhe si furnizues narrativash gjeopolitike që, në kontekst fushate, aktivizohen shpejt si përmbajtje polarizuese ose delegjitimuese. Për shembull, monitorimet e BIRN kanë dokumentuar se narrativa pro-Kremlinit depërtojnë kryesisht përmes portaleve shqipfolëse dhe ripublikimeve rajonale, duke ndikuar në mjedisin zgjedhor dhe informativ jo drejtpërdrejt përmes thirrjeve zgjedhore, por përmes formësimit të perceptimeve mbi sovranitetin, institucionet dhe orientimin strategjik të vendit.¹¹³

Një logjikë e ngjashme vërehet edhe në përmbajtjen e prodhuar nga media të

¹¹³ Voko, K., & Likmeta, B. (2023). *Russian state-sponsored disinformation narratives in Albania* [Narrativat dezinformuese të sponsorizuara nga shteti rus në Shqipëri]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2023/07/Russian-state-sponsored-disinformation-narratives-in-Albania.pdf>

lidhura me interesa shtetërore anti-perëndimore. Studimi i BIRN dhe SCiDEV mbi diplomacinë publike të Kinës dhe praninë e artikujve të radios së tyre publike në shqip identifikoi një fluks të vazhdueshme narrativash dhe një prani të mirëorganizuar në hapësirën digjitale, e cila ndërton besueshmëri si burim dhe formëson mënyrën se si perceptohen BE-ja, NATO-ja dhe rendi ndërkombëtar.¹¹⁴ Edhe pse jo të lidhura me zgjedhjet, këto narrativa ushqejnë terrenin e konkurrencës politike, duke u shndërruar gjatë fushatave në materiale të riciklueshme për polarizim, relativizim institucional ose delegitimim të aktorëve politikë.

Në mënyrë të ngjashme, analizat e BIRN mbi përmbajtjen me burim iranian në gjuhën shqipe tregojnë se kornizat anti-perëndimore dhe diskursi delegitimues ndaj institucioneve shqiptare rrisin vulnerabilitetin zgjedhor duke normalizuar mosbesimin dhe cinizmin politik. Këto të fundit, mund të shfrytëzohen nga aktorë vendas ose ndërmjetës gjatë fushatës.¹¹⁵ Edhe kur shembujt më të dukshëm lidhen me ngjarje jashtë ciklit zgjedhor, si samite ndërkombëtare apo konflikte rajonale, evidentojnë të njëjtin mekanizëm. Raportimet mbi propagandën ruse rreth Samitit të Komunitetit Politik Evropian në Tiranë dhe mbi dezinformimin në kontekstin e konfliktit Izrael–Iran evidentuan narrativa të jashtme që qarkullojnë shpejt në median vendase dhe bëhen lëndë e gatshme për manipulim zgjedhor.^{116 117}

Ky konfigurim lidhet me **Mundësuesin 11. Mjedise digjitale të fragmentuara të informacionit, Mundësuesin 12. Mundësia për t'u shfrytëzuar e teknologjive digjitale dhe të rrjeteve sociale**, si edhe me **Nxitësin 4. Disponueshmëria e përmbajtjes informative nga burime të huaja**. Këto narrative nuk “përcaktojnë” rezultatin zgjedhor, megjithatë, prania dhe riciklimi i tyre krijon një infrastrukturë të qëndrueshme rreziku, ku delegitimimi, polarizimi dhe manipulimi narrativ mund të aktivizohen lehtësisht gjatë fushatave zgjedhore, kur ritmi i qarkullimit të informacionit është më i lartë dhe kapaciteti korigjues institucional është më i kufizuar.

¹¹⁴ Bino, B., & Likmeta, B. (2023). *China's public diplomacy in Albania* [Diplomacia publike e Kinës në Shqipëri]. BIRN Albania & SCiDEV. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2023/07/Chinas-public-diplomacy-in-Albania.pdf>

¹¹⁵ Bino, B., & Likmeta, B. (2023). *Media analysis: Iran's propaganda in Albanian language* [Analizë mediatike: Propaganda e Iranit në gjuhën shqipe]. BIRN Albania & SCiDEV. https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2023/07/Media-Analysis_Irans-Propaganda-in-Albanian-Language.pdf

¹¹⁶ Karaj, V. (2025, 10 qershor). Propaganda ruse targetoi samitin e Komunitetit Evropian në Tiranë. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/06/10/propaganda-ruse-targetoi-samitin-e-komunitetit-evropian-ne-tirane/>

¹¹⁷ Karaj, V. (2025, 17 qershor). Konflikti midis Izraelit dhe Iranit përmbyt median shqiptare me lajme të rreme. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/06/17/konflikti-midis-izraelit-dhe-iranit-permbyt-median-shqiptare-me-lajme-te-rreme/>

Fusha 4

Hapësira digjitale, platformat dhe rreziku i manipulimit të informacionit zgjedhor

Hapësira digjitale dhe platformat e rrjeteve sociale janë shndërruar në një komponent qendror të konkurrencës politike dhe komunikimit zgjedhor në Shqipëri. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, rrjetet sociale jo vetëm plotësuan median tradicionale, por në shumë raste u kthyen në kanal kryesor për mobilizimin e votuesve, personalizimin e fushatave dhe amplifikimin e mesazheve politike. Pavarësisht këtij transformimi, kuadri rregullator, mekanizmat e mbikëqyrjes dhe kapacitetet institucionale nuk kanë ndjekur të njëjtin ritëm me zhvillimin e teknologjisë dhe praktikave digjitale.

Ndryshe nga fusha e medias tradicionale, për të cilën ka rregulla të konsoliduara për monitorimin e fushatave dhe barazinë në ekspozim, komunikimi politik online në Shqipëri mbetet i fragmentuar, i vetërregulluar dhe vetëm pjesërisht transparent. Kjo krijon një terren veçanërisht të favorshëm për pabarazi strukturore mes aktorëve politikë, përdorimin jo-transparent të reklamave digjitale, ndërhyrjen e palëve të treta dhe për teknika të amplifikimit artificial të audiencës. Të gjitha këto elemente rrisin ndjeshëm vulnerabilitetin ndaj manipulimit të informacionit dhe FIMI-t.

Kjo fushë analizon katër vulnerabilitete që lidhen me rrjetet sociale, platformat dhe hapësirën digjitale, duke përfshirë:

- mungesën e kuadrit rregullator dhe të mbikëqyrjes efektive mbi platformat digjitale;
- pabarazinë në përdorimin e rrjeteve sociale dhe vulnerabilitetet e vetërregullimit të aktorëve politikë;
- mungesën e transparencës dhe llogaridhënies për reklamat politike online; dhe
- rolin e palëve të treta dhe përdorimin e teknikave të amplifikimit artificial të audiencës.

Së bashku, këto vulnerabilitete nxjerrin në pah një mjedis digjital ku platformat e mëdha digjitale, aktorët politikë, strukturat joformale dhe rrjetet e koordinuara të informacionit mund të operojnë pa pasoja, duke cenuar barazinë e garës, transparencën financiare dhe integritetin e komunikimit politik online.

Mungesa e kuadrit ligjor për rregullimin e platformave digjitale

Narrativat me burim të huaj fitojnë legjitimitet vendor përmes ripublikimit digjital.

Hapësira digjitale dhe platformat sociale përbëjnë sot një nga mjediset kryesore të komunikimit politik dhe formësimit të opinionit publik gjatë proceseve zgjedhore. Megjithatë, në Shqipëri, këto platforma mbeten gjerësisht të parregulluara dhe të pambikëqyrura në mënyrë efektive, duke krijuar vulnerabilitete strukturore ndaj manipulimit të informacionit, përfshirë praktikën e FIMI-t.¹¹⁸

Raportet e International IDEA theksojnë se Shqipëria ndodhet ende në një fazë të hershme dhe fragmentare të përafërimit me standardet evropiane për qeverisjen e platformave digjitale. Veçanërisht problematike mbetet mungesa e rregullimit për transparencën e algoritmeve, moderimin e përmbajtjes politike, raportimin e reklamave politike online dhe përgjegjësinë e ndërmjetësve digjitalë.¹¹⁹ Ndërsa Akti për Shërbimet Digjitale (DSA), Akti për Inteligjencën Artificiale (AIA) dhe Akti për Tregjet Digjitale (DMA) vendosin detyrime të qarta për platformat e mëdha në Bashkimin Evropian, këto instrumente nuk janë ende të transpozuar apo të zbatueshme në mënyrë funksionale në kontekstin shqiptar.¹²⁰ Si pasojë, platformat globale operojnë në Shqipëri pa detyrime ligjore të qarta për transparencë, raportim dhe bashkëpunim me autoritetet vendase, duke përfshirë edhe gjatë periudhave zgjedhore.

Mungesa e kuadrit rregullator shoqërohet me një boshllëk të dukshëm në mbikëqyrje dhe mungesë përgjegjshmërie dhe llogaridhënie nga platformat. OSBE/ODIHR vëren se asnjë autoritet nuk ishte i mandatuar për të adresuar përmbajtjet manipuluese dhe sjelljen e koordinuar joautentike në hapësirën digjitale.¹²¹ Ndryshe nga media tradicionale audiovizive, të cilat i nënshtrohen monitorimit të AMA-s gjatë fushatave zgjedhore, hapësira digjitale mbetet praktikisht jashtë çdo regjimi të krahasueshëm.

Në mungesë të detyrimeve ligjore, platformat e mëdha globale nuk kanë alokuar burime të mjaftueshme për moderimin e përmbajtjes në gjuhën shqipe. Raportet e Komisionit Evropian dhe vëzhgimet e shoqërisë civile evidentojnë se platformat si Facebook, Instagram, TikTok dhe YouTube kanë alokuar kapacitete shumë të kufizuara për moderimin proaktiv të përmbajtjeve në shqip, veçanërisht për

¹¹⁸ OSCE/ODIHR. (2025). *Gjetjet dhe përfundimet paraprake – Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri, 11 maj 2025* [Preliminary Findings and Conclusions – Parliamentary Elections in Albania, 11 May 2025]. https://odihr.osce.org/sites/default/files/f/documents/4/f/590598_4.pdf

¹¹⁹ International IDEA. (2025). *Navigating the EU Digital Regulatory Framework – Part II* [Navigimi në kuadrin rregullator digjital të BE-së – Pjesa II]. <https://www.idea.int/sites/default/files/2025-10/navigating-eu-digital-regulatory-framework-part2.pdf>

¹²⁰ European Commission. (2025). *Albania Report 2025* [Raporti për Shqipërinë 2025]. Bruksel. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en

¹²¹ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Zgjedhjet parlamentare në Republikën e Shqipërisë, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odihr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

përmbajtjen politike, disinformimin apo nxitjen e urrejtjes.¹²² Kjo mungesë e moderimit gjuhësor dhe kontekstual rrit ndjeshëm ekspozimin e audiencës shqiptare ndaj narrativave të manipuluar, përfshirë ato me origjinë të huaj, të cilat mund të qarkullojnë nëpër platforma të ndryshme për periudha të gjata pa u identifikuar ose adresuar.

Gjatë ciklit zgjedhor 2025, qeveria mori një vendim për mbylljen e platformës TikTok në Shqipëri për 1 vit, si përgjigje ndaj shqetësimeve mbi mbrojtjen e të miturve. Ky vendim u mor në mungesë të një kuadri ligjor specifik për rregullimin e platformave digjitale, pa transparencë mbi kriteret dhe mekanizmat e zbatimit, dhe u sfidua në Gjykatën Kushtetuese.¹²³

OSBE/ODIHR, në Raportin Final për Zgjedhjet Parlamentare 2025, vëren se ndalimi i TikTok-ut gjatë vitit zgjedhor ngriti shqetësime serioze në lidhje me proporcionalitetin e masës, mungesën e garancive procedurale dhe ndikimin potencial mbi lirinë e shprehjes dhe barazinë e komunikimit politik online. ODIHR thekson se, ndonëse shtetet kanë të drejtë të adresojnë rreziqe në hapësirën digjitale, masat e përgjithshme dhe jo të targetuara rrezikojnë të cenojnë standardet demokratike, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore.¹²⁴

Sipas raportimeve të pavarura, ndalimi i TikTok-ut nuk u zbatua në mënyrë konsistente, ndërsa përdorimi i pajisjes DPI (Deep Packet Inspection) për zbatimin teknik të bllokimit të platformës ngriti shqetësime për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mungesën e bazës ligjore të qartë.^{125 126 127} Gjithashtu, masa nuk u shoqërua me alternativa rregullatore, mekanizma transparence apo politika të qëndrueshme për moderimin e përmbajtjes në platformat e tjera, duke nxjerrë në pah një qasje reaktive dhe të fragmentuar ndaj qeverisjes digjitale, duke e komplikuar peizazhin në kushtet e rregullimit të munguar.

Në këtë kontekst, mungesa e detyrimeve ligjore dhe llogaridhënies nga platformat ka krijuar një mjedis digjital të fragmentarizuar dhe lehtësisht të shfrytëzueshëm, ku aktorë politikë, palë të treta dhe rrjete të koordinuara informacioni, si dhe vetë platformat, mund të operojnë pa pasoja për shkeljet e kryera. Ky fakt lidhet me **Mundësuesin 11. Mjedise digjitale të fragmentuara të informacionit**,

¹²² European Commission. *Albania Report 2025* [Raporti për Shqipërinë 2025]. Bruksel. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en

¹²³ Sinoruka, F. (2025, 20 janar). Kryeministri Rama nën kritika për ndalimin e TikTok në vitin zgjedhor. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/01/20/kryeministri-rama-nen-kritika-per-ndalimin-e-tiktok-ne-vitin-zgjedhor/>

¹²⁴ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 11 May 2025 – Final Report* [Zgjedhjet parlamentare në Republikën e Shqipërisë, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odihr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

¹²⁵ Sinoruka, F. (2025, 23 mars). Ndalimi kontrovers i TikTok në Shqipëri ende nuk po funksionon plotësisht. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/03/23/ndalimi-kontrovers-i-tiktok-ne-shqiperi-ende-nuk-po-funksionon-plotesisht/>

¹²⁶ Bogdani, N. (2025, 25 mars). Vendimi për mbylljen e TikTok në Shqipëri sfidohet në Gjykatën Kushtetuese. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/03/25/vendimi-per-mbylljen-e-tiktok-ne-shqiperi-sfidohet-ne-gjykate-kushtetuese/>

¹²⁷ Bogdani, N. (2025, 7 prill). Masat për mbylljen e TikTok ngrenë shqetësime për cenimin e të dhënave personale. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/04/07/masat-per-mbylljen-e-tiktok-ngrene-shqetesime-per-cenimin-e-te-dhenave-personale/>

Mundësuesin 12. Mundësia për t'u shfrytëzuar e teknologjive digjitale dhe të rrjeteve sociale, Mundësuesin 15. Boshllëqe në rregullimin e medias dhe internetit, dhe Mundësuesin 16. Zbatim i paqartë i normave ndërkombëtare, si dhe krijon terren për **Nxitësin 3. Përdorimi i fondeve të huaja për qëllime mediatike** dhe **Nxitësin 4. Disponueshmëria e përmbajtjes informative nga burime të huaja.**

Në mungesë të mekanizmave të përgjegjësisë dhe të moderimit në gjuhën shqipe, platformat digjitale në Shqipëri mbeten ndër pikat më të dobëta gjatë proceseve zgjedhore. Ky vulnerabilitet nuk manifestohet vetëm në raste të veçanta, por përbën një kusht strukturor që amplifikon rreziqet e manipulimit të informacionit dhe minon transparencën, barazinë dhe integritetin e komunikimit politik online.

Pabarazia në burime dhe kufizimet e vetërregullimit të fushatës digjitale

Gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025, rrjetet sociale u konsoliduan si një nga kanalet kryesore të komunikimit politik në Shqipëri, duke luajtur një rol të drejtpërdrejtë në formësimin e diskursit publik, mobilizimin zgjedhor dhe amplifikimin e mesazheve politike. Megjithatë, shfrytëzimi i tyre nga aktorët politikë u karakterizua nga pabarazi të theksuara strukturore, mungesë transparence dhe raste të përsëritura të keqpërdorimit të komunikimit institucional, duke krijuar një mjedis digjital të pabalancuar dhe vulnerabël ndaj manipulimit të informacionit.

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR konstatoi se subjektet zgjedhore përdorën gjerësisht rrjetet sociale gjatë fushatës, veçanërisht Facebook dhe Instagram, duke kontribuar në intensifikimin e diskursit polarizues pa ekzistencën e mekanizmave të qartë të llogaridhënies. ODIHR vëren se, ndonëse fushata online nuk është e rregulluar nga Kodi Zgjedhor, përdorimi masiv i rrjeteve sociale ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në klimën zgjedhore, ndërkohë që “asnjë autoritet nuk ishte i mandatuar për të identifikuar ose adresuar përmbajtje manipuluese ose sjellje të koordinuara joautentike online”.¹²⁸

Këto gjetje e pozicionojnë hapësirën digjitale si një fushë kyçe ku pabarazitë strukturale dhe boshllëqet rregullatore përkthehen drejtpërdrejt në avantazhe për aktorët dominues.

Në mungesë të rregullimit ligjor të përgjegjësisë së aktorëve politikë, në prag të fushatës zgjedhore 2025, një pjesë e subjekteve politike nënshkruan Kodin e Sjelljes për Fushatat Digjitale. Ky Kod, një mekanizëm vetërregullues i

Pabarazitë e burimeve dhe vetërregullimi i dobët forcojnë dominimin në fushatën digjitale.

¹²⁸ OSCE/ODIHR. (2025). *Preliminary Findings and Conclusions – Parliamentary Elections in Albania, 11 May 2025* [Gjetjet dhe përfundimet paraprake – Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri, 11 maj 2025]. Varshavë. https://odhr.osce.org/sites/default/files/f/documents/4/f/590598_4.pdf

lehtësuar nga shoqëria civile dhe partnerë ndërkombëtarë, synonte promovimin e transparencës, etikës dhe përgjegjësisë në komunikimin online. Megjithatë, Kodi përbën një angazhim politik vullnetar, jo instrument detyrues ligjor.¹²⁹

Gjetjet e monitorimit të BIRN Albania dhe International IDEA-s të fushatës digjitale treguan se vetërregullimi ishte i pamjaftueshëm, pasi nënshkrimi i kodit nuk u shoqërua me ndryshime të dukshme në praktikën e komunikimit online nga partitë dhe kandidatët. U identifikuan shkelje të përsëritura, përfshirë mungesë transparence mbi përmbajtjet e sponsorizuara, përdorim të gjuhës polarizuese dhe përfshirje të palëve të treta në amplifikimin e mesazheve politike (shih rastin ilustrues më poshtë).¹³⁰

Të dhënat nga monitorimi tregojnë një dominim të fortë të dy subjekteve kryesore politike në Facebook dhe Instagram, si në volumin e postimeve, ashtu edhe në angazhimin e gjeneruar (pëlqime, komente, shpërndarje). Gjatë periudhës zyrtare të fushatës, komunikimi digjital u përqendrua në profilet e liderëve politikë dhe faqeve mbështetëse të lidhura me ta, ndërsa subjektet e vogla dhe kandidatët e rinj patën dukshmëri shumë të kufizuar, shpesh të mbështetur vetëm në angazhim organik.

Kjo pabarazi, përveçse me reklamimin e pabarabartë, lidhet edhe me aksesin e ndryshëm në rrjete të koordinuara, staf profesional për menaxhimin e përmbajtjes, si dhe kapacitetin për të prodhuar materiale vizuale të personalizuar dhe të vazhdueshme. Në këtë mënyrë, rrjetet sociale reflektuan dhe përforcuan pabarazitë ekzistuese në median tradicionale, duke krijuar “echo chambers” të liderëve kryesorë politikë.

Një element veçanërisht problematik i kësaj fushate ishte përdorimi i faqeve dhe profileve zyrtare të institucioneve publike në rrjete sociale për qëllime zgjedhore. Monitorimi evidentoi raste ku përmbajtje të publikuara si “informuese” nga institucione publike përkonin qartazi me mesazhet dhe imazhet e fushatës së kandidatëve të mazhorancës.¹³¹

Rastet e dokumentuara nga BIRN Albania, përfshirë përdorimin e faqeve institucionale nga ministra të ndryshëm gjatë fushatës, nxorën në pah mungesën e ndarjes mes informacionit publik dhe propagandës zgjedhore, si dhe qasjen tolerante të institucioneve mbikëqyrëse ndaj këtyre praktikave.^{132 133} Këto raste

¹²⁹ Gjoncaj, M., & Shehu, J. (2025). *Albanian parties adopt code of conduct on digital campaigns* [Partitë shqiptare miratojnë kod sjelljeje për fushatat digjitale]. International IDEA. <https://www.idea.int/news/albanian-parties-adopt-code-conduct-digital-campaigns>

¹³⁰ Likmeta, B., & Voko, K. (2025). *Social media monitoring: Albania's parliamentary elections 2025* [Monitorimi i rrjeteve sociale: Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri 2025]. International IDEA. https://www.idea.int/sites/default/files/2025-07/social-media-monitoring-albanias-parliamentary-elections-2025_0.pdf

¹³¹ Qendra Qytetare (QQ). (2025). *Raport mbi denoncimet e Qendrës “Qëndresa Qytetare” për zgjedhjet për Kuvend, 11 maj 2025*. <https://qq.com.al/wp-content/uploads/2025/06/Raport-mbi-denoncimet-e-zgjedhjeve.pdf>

¹³² Karaj, V. (18 prill 2025). Ministrja Balluku i përdor faqet e institucioneve si mur për posterat e fushatës. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/04/18/ministrja-balluku-i-perdor-faqet-e-institucioneve-si-mur-per-posterat-e-fushates/>

¹³³ Karaj, V. (23 prill 2025). Me natyrë informuese, KQZ i shkel syrin propagandës së institucioneve publike për

tregojnë se pabarazia në shfrytëzimin e rrjeteve sociale nuk buron vetëm nga kapacitetet e subjekteve politike, por edhe nga instrumentalizimi i burimeve publike për qëllime zgjedhore.

Në përgjigje të shqetësimeve në rritje mbi fushatat digjitale, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndërmoi një nismë për të ngritur një njësi të dedikuar për monitorimin e rrjeteve sociale gjatë zgjedhjeve të vitit 2025. Kjo iniciativë synonte të rriste kapacitetet institucionale për të identifikuar shkelje dhe për të përmirësuar transparencën në hapësirën online.

Megjithatë, deri në përfundim të procesit zgjedhor, kjo njësi nuk prodhoi gjetje publike ose raporte të detajuara mbi përdorimin e rrjeteve sociale nga subjektet zgjedhore. Mungesa e kompetencave të qarta ligjore, burimeve teknike dhe ekspertizës së specializuar kufizoi ndjeshëm efektivitetin e kësaj nisme, duke e lënë monitorimin e hapësirës digjitale kryesisht në duart e aktorëve të pavarur.

Në terma të metodologjisë, ky vulnerabilitet lidhet drejtpërdrejt me **Mundësuesin 12. Mundësia për t'u shfrytëzuar e teknologjive digjitale dhe të rrjeteve sociale** dhe **Mundësuesin 13. Politika jo të qëndrueshme dhe të buta të moderimit**, si dhe **Nxitësin 1. Model biznesi mediatik i orientuar nga angazhimi i audiencës** dhe **Nxitësin 2. Tregu i reklamave politike online**. Pabarazia në shfrytëzimin e rrjeteve sociale, e kombinuar me keqpërdorimin e burimeve publike dhe mungesën e mbikëqyrjes efektive, krijon një mjedis ku manipulimi i informacionit dhe ndërhyrjet e palëve të treta mund të vijjnë me pasoja minimale.

Rast ilustrues: Zbatimi i Kodit të Sjelljes për Fushatat Digjitale dhe kufizimet e vetërregullimit

Gjatë periudhës 11 prill–11 maj, BIRN Albania dokumentoi gjithsej 349 shkelje të Kodit të Sjelljes për Fushatat Digjitale nga parti dhe kandidatë që ishin zotuar vullnetarisht ta respektonin Kodin. Pjesa më e madhe e shkeljeve—55%—iu atribuua kandidatëve nga Partia Socialiste në pushtet, pasuar nga Koalicioni i udhëhequr nga Partia Demokratike, Aleanca për Shqipërinë Madhështore, me 17.5%, ndërsa koalicioni Nisma Shqipëria Bëhet dhe Partia Mundësia përbënin përkatësisht 10.9% dhe 6.3% të shkeljeve. Pjesa e mbetur prej 10.3% e shkeljeve, u kryen nga subjektet e tjera zgjedhore. Numri i shkeljeve u rrit ndjeshëm gjatë gjysmës së dytë të fushatës, veçanërisht nga kandidatët e Partisë Socialiste, me afrimin e ditës së zgjedhjeve.¹³⁴

Një nga problematikat më të shpeshta të monitoruara ishte mungesa e transparencës në përmbajtjet e sponsorizuara, ku postime dhe reklama politike

Belinda Ballukun. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/04/23/me-natyre-informuese-kqz-i-shkel-syrin-propagandes-se-institucioneve-publike-per-belinda-ballukun/>

¹³⁴ Likmeta, B., & Voko, K. (2025). *Social media monitoring: Albania's parliamentary elections 2025* [Monitorimi i rrjeteve sociale: Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri 2025]. International IDEA. https://www.idea.int/sites/default/files/2025-07/social-media-monitoring-albanias-parliamentary-elections-2025_0.pdf

u shpërndanë pa identifikim të qartë të sponsorit ose burimit financiar. Kjo praktikë e bëri të vështirë për publikun të dallonte mes komunikimit organik politik dhe përmbajtjes së paguar, duke minuar një nga parimet themelore të Kodit.

Raporti evidenton gjithashtu përdorimin joetik të teknologjisë, në veçanti përhapja e përmbajtjes së gjeneruar nga intelijenca artificiale pa transparencë ose etiketimin përkatës. Një përqindje më e vogël, por domethënëse (9.7%) lidhet me shkeljen e heshtjes zgjedhore, diskursin politik përjashtues dhe shkelje të tjera që cenojnë parimet demokratike.

Kodi i Sjelljes mbeti një instrument vullnetar, jo detyrues ligjor dhe pa një autoritet përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të tij. Shkeljet e dokumentuara nuk u shoqëruan me masa korigjuese apo sanksione, çka e kufizoi ndjeshëm efektin parandalues të këtij instrumenti. Edhe pse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndërmori hapa për të ngritur një njësi të posaçme për monitorimin e rrjeteve sociale, kapacitetet institucionale mbetën të pamjaftueshme për të adresuar volumin dhe kompleksitetin e përmbajtjes digjitale gjatë fushatës.

Në tërësi, monitorimi i Kodit të Sjelljes për Fushatat Digjitale tregon se vetërregullimi, në mungesë të një kuadri ligjor detyrues dhe mekanizmave efektivë të zbatimit, nuk është i mjaftueshëm për të garantuar integritetin e fushatës online. Në mungesë të tyre, hapësira digjitale mbetet veçanërisht e ekspozuar ndaj praktikave FIMI gjatë proceseve zgjedhore në Shqipëri.

Reklamimi digjital
jo transparent
lehtëson
shpenzime të
padeklaruara dhe
ndikim të fshehtë.

Mungesë transparence dhe llogaridhënieje për reklamat politike digjitale

Reklamat politike në platformat digjitale përbëjnë një komponent gjithnjë e më të rëndësishëm të fushatave zgjedhore në Shqipëri, por njëkohësisht edhe një nga zonat më problematike përsa i përket transparencës, kontrollit dhe llogaridhënies. Gjatë cikleve të fundit zgjedhore, përfshirë zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, mungesa e rregullimit specifik për reklamat politike online dhe vulnerabilitetet strukturore në sistemin e deklarimit financiar kanë krijuar një mjedis të favorshëm për shpenzime të padeklaruara, reklama të paidentifikuara dhe ndërhyrje të palëve të treta në komunikimin politik.

Problemet e transparencës nuk janë të reja. Që në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, BIRN Albania dokumentoi se mbi 75% e reklamave politike në platformat Facebook dhe Instagram nuk identifikonin qartë sponsorin ose burimin e financimit, duke shkelur parimet bazë të transparencës dhe duke e bërë të pamundur gjurmimin e shpenzimeve reale të fushatës digjitale.¹³⁵ Ky nivel i

¹³⁵ Likmeta, B. (28 prill 2021). Partitë politike shpenzuan 299 mijë USD gjatë fushatës për reklama në Facebook.

Iartë paqartësie krijoi hapësirë për targetim selektiv të audiencave, përdorim të përmbajtjeve manipuluese dhe shmangie të kontrollit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Edhe gjatë zgjedhjeve vendore të vitit 2023, problemet me deklarin financiar për reklamat online vijuan. Analiza e raporteve financiare të subjekteve zgjedhore tregoi mospërputhje të ndjeshme mes volumit real të aktivitetit në platformat digjitale dhe shifrave të deklaruara zyrtarisht, duke ngritur pikëpyetje serioze mbi procesin e auditimit dhe verifikimin e shpenzimeve.¹³⁶ Monitorimi i rrjeteve sociale gjatë atij procesi zgjedhor konfirmoi se reklamat politike në hapësirën digjitale ishin përdorur gjerësisht, pavarësisht deklarimeve formale që në shumë raste raportonin shpenzime zero.¹³⁷

Raportet e OSCE/ODIHR kanë theksuar në mënyrë të përsëritur se mungesa e transparencës mbi reklamat politike në hapësirën digjitale dhe roli i paqartë i palëve të treta përbëjnë një nga boshllëqet kryesore për integritetin zgjedhor në Shqipëri. Në vlerësimet për zgjedhjet e vitit 2025, ODIHR nënvizon se fushatat në rrjetet sociale mbeten jashtë një kuadri të qartë rregullator dhe se nuk ekziston një mekanizëm efektiv për identifikimin e sponsorëve, monitorimin e shpenzimeve apo zbatimin e sanksioneve për shkeljet e konstatuara.¹³⁸

Në të njëjtën linjë, International IDEA, në analizën e saj mbi përafrimin e legjisllacionit të vendeve të Ballkanit Perëndimor me kuadrin digjital të BE-së, vëren se Shqipëria nuk ka ende mekanizma funksionalë për zbatimin e standardeve që burojnë nga DSA-ja, veçanërisht në lidhje me transparencën e reklamave politike, arkivat publike të reklamave dhe përgjegjësinë e platformave për bashkëpunim me autoritetet zgjedhore.¹³⁹ Kjo situatë e lë kontrollin e reklamimit politik në hapësirën digjitale pothuajse tërësisht në duart e platformave private dhe vetë subjekteve politike.

Gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025, monitorimi i rrjeteve sociale i realizuar nga BIRN Albania dhe International IDEA konfirmoi vazhdimësinë e këtyre problematikave. U identifikuan dhjetëra raste të reklamave politike të paidentifikuara ose të etiketuara në mënyrë të paqartë, përfshirë reklama të

Reporter.al. <https://www.reporter.al/2021/04/28/partite-politike-shpenzuan-299-mije-usd-gjate-fushates-per-reklama-ne-facebook/>

¹³⁶ Barjamemaj, A. (2024). Analiza e raporteve financiare të subjekteve zgjedhore për fushatën elektorale 2023. Reporter.al. <https://www.reporter.al/2024/11/13/raportet-financiare-te-partive-politike-cfare-fshehin-shifrat-zyrtare/>

¹³⁷ Voko, K., Likmeta, B. & Erebara, Gj. (2023). *Albania Local Elections 2023: Social Media Monitoring* [Zgjedhjet Vendore në Shqipëri 2023: Monitorimi i Mediave Sociale]. BIRN Albania. https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/01/Social-Media-Monitoring_Elections-2023_Albania_Eng-1.pdf

¹³⁸ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary elections, 11 May 2025 – Final report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odihr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

¹³⁹ Bojadzievska, I., Cabacenco, P., Ivasyk, S., & Reçi, M. (2025). *Navigating the EU digital regulatory framework – Part II* [Navigimi në kuadrin rregullator digjital të BE-së – Pjesa II]. International IDEA. <https://www.idea.int/sites/default/files/2025-10/navigating-eu-digital-regulatory-framework-part2.pdf>

publikuara nga kandidatë individualë dhe faqe të palëve të treta. Një numër i konsiderueshëm i këtyre reklamave vijuan të qarkullonin edhe gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, duke minuar parimin e barazisë në garë dhe efektivitetin e rregullave ekzistuese (shih rastin ilustrues më poshtë).¹⁴⁰

Në terma metodologjikë, ky vulnerabilitet lidhet me **Mundësuesin 12. Mundësia për t'u shfrytëzuar e teknologjive digjitale dhe të rrjeteve sociale** dhe **Mundësuesin 13. Politika jo të qëndrueshme dhe të buta të moderimit**. Njëkohësisht, ai ndërvepron me **Nxitësin 1. Model biznesi mediatik i orientuar nga angazhimi i audiencës** dhe **Nxitësin 2. Tregu i reklamave politike online**, duke krijuar stimuj të fortë për përdorimin e reklamave të dyshimta, të padeklaruara ose të maskuara si përmbajtje organike.

Rast ilustrues: Reklamat politike online gjatë zgjedhjeve parlamentare 2025

Monitorimi i reklamave politike online gjatë zgjedhjeve parlamentare të 11 majit 2025 konfirmon se, pavarësisht rritjes relative të transparencës në platformat Meta përmes Ad Library, hapësira digjitale mbetet thellësisht e pabalancuar, e personalizuar dhe vetëm pjesërisht e auditueshme, duke krijuar kushte për shmangien e rregullave për mbrojtjen e integritetit zgjedhor.

Gjatë periudhës së monitoruar të fushatës, kandidatët për deputetë dhe subjektet politike zhvilluan gjithsej 4,651 reklama politike në platformat Meta (Facebook, Instagram, Audience Network dhe Messenger). Këto përfshinin reklama të publikuara drejtpërdrejt nga partitë politike dhe reklama të sponsorizuara nga kandidatët individualë. Në terma financiarë, subjektet dhe kandidatët shpenzuan gjithsej 265,985 USD për reklama në platformat Meta. Nga kjo shumë, 64,528 USD u shpenzuan nga partitë politike, ndërsa 201,457 USD nga kandidatët individualë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpenzoi 2,432 USD për fushata informuese për votuesit.

Gjatë fushatës, Partia Socialiste dhe Partia Demokratike zhvilluan reklama politike edhe në platformat Google. Sipas Google Ad Transparency Centre, secila parti publikoi nga pesë reklama, kryesisht në formën e banerave dhe videove. Megjithatë, mungesa e të dhënave mbi shpenzimet, audiencën dhe shtrirjen e këtyre reklamave e bën të pamundur vlerësimin e ndikimit të tyre.

Monitorimi i BIRN Albania identifikoi gjithashtu dy fushata masive përmes postës elektronike. Megjithëse përmbajtja ishte qartësisht promovuese dhe synonte mobilizimin elektoral, nuk ka të dhëna publike mbi shtrirjen, listat e shpërndarjes apo kostot financiare të tyre.

¹⁴⁰ Likmeta, B., & Voko, K. (2025). *Social media monitoring: Albania's parliamentary elections 2025* [Monitorimi i rrjeteve sociale: Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri 2025]. International IDEA. https://www.idea.int/sites/default/files/2025-07/social-media-monitoring-albanias-parliamentary-elections-2025_0.pdf

Pavarësisht një paralajmërimi publik të lëshuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve më 10 maj, monitorimi i BIRN Albania identifikoi 77 kandidatë dhe një subjekt politik që vijuan publikimin e reklamave politike gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore (10–11 maj). Këto reklama u shpërndanë kryesisht në Facebook dhe Instagram dhe përfshinin si përmbajtje të sponsorizuara ashtu edhe materiale video të fushatës.

Gjithashtu, gjatë gjithë fushatës, u identifikuan 165 reklama politike të publikuara nga kandidatë pa deklarimet e kërkuara të transparencës. Mungesa e deklarimeve minon të drejtën e votuesve për të kuptuar kush qëndron pas mesazheve politike dhe dobëson llogaridhënien financiare të fushatës.

Ky rast ilustrues tregon se, edhe pse platformat Meta ofrojnë një nivel minimal transparence, reklamimi politik online në Shqipëri mbetet i fragmentuar, i personalizuar dhe i vetëm pjesërisht i monitorueshëm. Kanale të tjera (p.sh. platforma të tjera si Google) mbeten jashtë çdo mekanizmi auditimi, ndërsa shkeljet gjatë heshtjes zgjedhore dhe reklamimet pa identifikim tregojnë kufizimet e qasjes aktuale rregullatore dhe vetërregulluese. Në mungesë të detyrimeve ligjore gjithëpërfshirëse dhe mekanizmave efektivë të mbikëqyrjes, reklamimet politike online vazhdojnë të përbëjnë një nga pikat më të dobëta të transparencës dhe barazisë në procesin zgjedhor.

Palët e treta dhe ndërhyrja jo-transparente në fushatat digjitale

Një nga boshllëqet kyçe në kuadrin zgjedhor në Shqipëri lidhet me rolin dhe përfshirjen e palëve të treta në proceset zgjedhore. Pavarësisht rekomandimeve të përsëritura të OSBE/ODIHR ndër vite, përfshirë zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 dhe zgjedhjet vendore të vitit 2023, legjislacioni zgjedhor nuk ka adresuar në mënyrë të plotë transparencën, raportimin financiar dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të palëve të treta që angazhohen në fushata politike ose komunikim zgjedhor paralel me subjektet zyrtare politike.¹⁴¹

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 shënuan një moment kritik në ekspozimin publik të këtij vulnerabiliteti. Investigimi i BIRN i titulluar “Para të errëta’ dhe këshilltarë izraelitë pas zgjedhjeve shqiptare”, dokumentoi përdorimin sistematik të fondeve të padeklaruara dhe përfshirjen e konsulentëve të huaj politikë në

Rrjetet e palëve të treta dhe amplifikimi artificial shtrembërojnë perceptimin publik.

¹⁴¹ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary elections, 11 May 2025 – Final report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odhr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

fushatat e dy partive kryesore.¹⁴² Investigimi identifikoi një rrjet faqesh anonime në Facebook, të cilat shpërndanë reklama politike të targetuara kundër figurave të opozitës pa deklaruar burimin e financimit. Këto faqe arritën mbi 51 milionë shikime në një periudhë relativisht të shkurtër, pavarësisht se kishin vetëm disa mijëra ndjekës, duke sugjeruar përdorim intensiv të reklamimit të paguar nga burime të padeklaruara.

Të dhënat treguan gjithashtu se administratorët e disa prej këtyre faqeve ndodheshin jashtë Shqipërisë, kryesisht në Izrael, ndërsa të paktën tetë konsulentë politikë të huaj rezultuan të përfshirë drejtpërdrejt në fushatat zgjedhore. Këto praktika anashkaluan politikat e transparencës së vetë platformave digjitale dhe mekanizmat kombëtarë të raportimit financiar, duke krijuar një kanal paralel dhe të pauditueshëm ndikimi mbi opinionin publik.

Problematikat e identifikuara në vitin 2021 vijuan të paadresuara edhe në ciklet zgjedhore pasuese. Gjatë zgjedhjeve vendore të vitit 2023, shpenzimet për reklama politike, veçanërisht në hapësirën digjitale, vazhduan të ishin të nënraportuara ose të fshehura përmes palëve të treta, ndërsa procesi i auditimit financiar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbeti i kufizuar në verifikime formale.¹⁴³ ¹⁴⁴ Gjithashtu, gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025, BIRN monitoroi një prani të gjerë palësh të treta të përfshira në fushatë digjitale dhe teknika amplifikimi të audiencës (shih rastin ilustrues më poshtë).

Këto zhvillime e vendosin çështjen e palëve të treta në qendër të rrezikut për ndërhyrje të huaja dhe manipulim të informacionit zgjedhor dhe FIMI-t. Mungesa e rregullimit të aktivitetit dhe përfshirjes në fushatë e palëve të treta në fushatë dhe e transparencës së burimeve financiare lidhet me **Mundësuesin 12. Mundësia për t'u shfrytëzuar e teknologjive digjitale dhe të rrjeteve sociale** dhe **Nxitësin 5. Manipulimi i informacionit për "me porosi"** dhe **Nxitësin 6. Punë/role të dedikuara në fushën e manipulimit të informacionit.**

Gjatë 2024–2025, Shqipëria ndërmori angazhimet politike të para për adresimin e këtij boshllëku. Strategjia Kombëtare Kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Disinformimit, e miratuar në korrik 2025, e identifikon rregullimin e palëve të treta dhe forcimin e mekanizmave të raportimit financiar si një objektiv prioritar.¹⁴⁵ Gjithashtu, Udhërrëfyesi për Funksonimin e Institucioneve Demokratike (VKM

¹⁴² Likmeta, B. (2021, 1 qershor). Untold story: Dark money, Israeli advisers and an Albanian election [‘Para të errëta’ dhe këshilltarë izraelitë pas zgjedhjeve shqiptare]. *Balkan Insight*. <https://balkaninsight.com/2021/06/01/untold-story-dark-money-israeli-advisers-and-an-albanian-election/>

¹⁴³ Likmeta, B. (2021, 23 nëntor). Partitë fshehen miliona euro shpenzime për propagandë elektorale në zgjedhje. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2021/11/23/partite-fshehen-miliona-euro-shpenzime-per-propagande-elektorale-ne-zgjedhje/>

¹⁴⁴ Barjamemaj, A. (2024, 13 nëntor). Analiza e raporteve financiare të subjekteve mbi fushatën elektorale 2023, 2024. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2024/11/13/raportet-financiare-te-partive-politike-cfare-fshehin-shifrat-zyrtare/>

¹⁴⁵ Kuvendi i Shqipërisë. (2025). *Ligj nr. 47, datë 3 korrik 2025, për miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja*. <https://kuvendwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202507170801443359Ligj%20nr.%2047%2C%20dt%203.7.2025.pdf>

nr. 611/2024) parashikon, ndër të tjera, masa për rritjen e transparencës dhe parandalimin e ndikimeve të padeklaruar në proceset zgjedhore.¹⁴⁶ Megjithatë, këto angazhime nuk janë reflektuar ende në legjislacionin zgjedhor.

Në mungesë të kuadrit të detyrueshëm ligjor për palët e treta, hapësira digjitale dhe rrjetet sociale vazhdojnë të funksionojnë si terren ideal për fushata të koordinuara informale, financim të padeklaruar dhe ndërhyrje të aktorëve të huaj. Kjo e bën këtë vulnerabilitet një nga pikat më kritike për integritetin zgjedhor në Shqipëri dhe një element kyç për analizën e rrezikut të FIMI-t.

Rast ilustrues: Palët e treta dhe teknikat e amplifikimit artificial të audiencës gjatë zgjedhjeve 2025

Gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, BIRN i kushtoi vëmendje të veçantë aktivitetit të palëve të treta në rrjetet sociale—faqe dhe llogari që nuk përfaqësonin subjekte zyrtare politike, kandidatë apo media të verifikuara, por që megjithatë u angazhuan aktivisht në promovimin ose sulmin ndaj aktorëve politikë gjatë fushatës.

Gjatë fushatës, u identifikuan 58 faqe të tilla të palëve të treta që ushtronin aktivitet politik të qartë. Këto faqe u angazhuan në një sërë praktikash problematike, përfshirë përhapjen e përmbajtjeve manipuluese ose disinformuese, përdorimin e reklamave të paguara pa deklarime transparente, amplifikimin artificial të përmbajtjes përmes sjelljes joautentike, si dhe fushata reklamuese që targetonin diasporën shqiptare, veçanërisht në Itali¹⁴⁷.

Një karakteristikë e përbashkët e shumicës së këtyre faqeve ishte mungesa e të dhënave të besueshme mbi shpenzimet. Shumë prej tyre operuan jashtë klasifikimit të platformës Meta si “çeshtje politike ose sociale” (Meta Ad Library), duke shmangur kështu mekanizmat ekzistues të transparencës. Megjithatë, në disa raste u identifikuan të dhëna të pjesshme: faqja “Team Edi Rama” shpenzoi rreth 1,222 dollarë amerikanë; “themuslimvote.al” rreth 115 dollarë amerikanë; “Gratë votojnë Gratë” rreth 200 dollarë amerikanë; ndërsa faqja “Shqipëria në BE” shpenzoi rreth 2,663 euro, kryesisht për reklama që targetonin votuesit në diasporë.

Megjithëse shumë nga këto faqe kishin një numër relativisht të ulët ndjekësish, angazhimi i gjeneruar dhe shtrirja e tyre ishin disproporcionalë, falë përdorimit të reklamave, përmbajtjeve emocionale dhe teknikave të amplifikimit artificial. Një rast ilustrues është faqja në Facebook “Team Edi Rama”, e krijuar më 19 mars 2025, pak para fillimit zyrtar të fushatës. Deri më 10 maj, faqja kishte rreth 6,600

¹⁴⁶ Këshilli i Ministrave. (2024). *Vendim nr. 611, datë 2 tetor 2024, për miratimin e Udhërrëfyesit për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike*. <https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/VKM-nr-611-date-2.10.2024-Per-miratimin-e-Udherrefyesit-per-Funksionimin-e-Institucioneve-Demokratike.pdf>

¹⁴⁷ Likmeta, B., & Voko, K. (2025). *Social media monitoring: Albania's parliamentary elections 2025* [Monitorimi i rrjeteve sociale: Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri 2025]. International IDEA. https://www.idea.int/sites/default/files/2025-07/social-media-monitoring-albanias-parliamentary-elections-2025_0.pdf

ndjekës, por arriti 4.6 milionë shikime video dhe mbi 70,000 ndërveprime në më pak se dy muaj. Analiza e të dhënave tregon “shpërthime” të qarta aktiviteti në fillim të prillit, në fillim të majit dhe në ditët e fundit të fushatës—modele që sugjerojnë promovim të koordinuar ose rritje artificiale të audiencës.

Monitorimi identifikoi gjithashtu strategji të koordinuara të amplifikimit artificial, veçanërisht në faqet që vepronin jashtë strukturave zyrtare partiake. Në rastin e “Team Edi Rama”, nivelet jashtëzakonisht të larta të shikueshmërisë dhe ndërveprimit, krahasuar me numrin e ndjekësve, u shoqëruan me evidenca të përdorimit të rrjeteve të koordinuara dhe *bot-eve*. Shumë nga llogaritë që ndërvepronin me përmbajtjen ish-in nga Vietnamit dhe vende të tjera të Azisë Juglindore, ndërsa simulonin angazhim organik përmes pëlqimeve, shpërndarjeve dhe komenteve me qëllim rritjen e audiencës.

Këto taktika nuk u kufizuan vetëm tek faqet e palëve të treta. Më 9 maj 2025, gjatë transmetimit *live* në Facebook të intervistës finale televizive të Kryeministrit Edi Rama në emisionin Opinion (TV Klan), u vërejt një vërshim i menjëhershëm komentesh nga profile të dyshimta, me karakteristika të ngjashme me ato të identifikuar më herët në faqet e palëve të treta. Modelet e sjelljes sugjerojnë përdorimin e të njëjtave metoda amplifikimi për të krijuar perceptimin e mbështetjes masive publike¹⁴⁸.

Këto gjetje tregojnë se palët e treta përbëjnë një nga pikat më të ndjeshme të manipulimit digjital në Shqipëri. Ato operojnë në një zonë rregullatore gri, me kosto të ulët dhe rrezik minimal ndëshkimi, duke shfrytëzuar fragmentimin e hapësirës digjitale dhe mungesën e mekanizmave efektivë të llogaridhënies. Përdorimi i faqeve dhe profileve anonime, reklamave të paidentifikuara dhe sjelljes joautentike krijon një mjedis ku perceptimi publik mund të deformohet në mënyrë të qëllimshme, pa transparencë dhe pa llogaridhënie.

Fusha 5

Digjitalizimi i proceseve zgjedhore dhe siguria kibernetike

Digjitalizimi i proceseve zgjedhore në Shqipëri ka avancuar ndjeshëm gjatë cikleve të fundit zgjedhore, duke përfshirë identifikimin elektronik të votuesve, testimin e teknologjive të reja për numërimin, regjistrimin dhe votimin e diasporës, si dhe përdorimin e platformave digjitale për raportimin financiar dhe administrimin e

¹⁴⁸ Karaj, V. (2025, 10 maj). Profilet në Facebook nga Vietnamit përmbysin intervistën e Ramës në Opinion. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/10/profilet-ne-facebook-nga-vietnami-permbytin-intervisten-e-rames-ne-opinion/>

të dhënave zgjedhore. Këto zhvillime synojnë të rrisin efikasitetin, integritetin dhe transparencën e procesit zgjedhor, por njëkohësisht krijojnë edhe forma të reja vulnerabiliteti, veçanërisht në mungesë të auditimit të pavarur, komunikimit publik të qartë dhe kapaciteteve të konsoliduara të sigurisë kibernetike.

Kjo fushë fokusohet në dy vulnerabilitete kryesore:

- rreziqet që burojnë nga digjitalizimi i proceseve zgjedhore dhe kapacitetet e kufizuara për auditim, transparencë dhe përdorim të sigurt të sistemeve; dhe
- ekspozimin e infrastrukturës zgjedhore ndaj sulmeve kibernetike dhe kërcënimeve hibride, përfshirë keqpërdorimin e të dhënave dhe ndikimin e tyre në besimin publik.

Analiza lidhet drejtpërdrejt me **Mundësuesin 6. Ndjeshmëria e audiencës ndaj manipulimit**, **Mundësuesin 15. Boshllëqe në rregullimin e medias dhe internetit** dhe **Mundësuesin 16. Zbatim i paqartë i normave ndërkombëtare**, duke theksuar se siguria kibernetike dhe komunikimi publik janë komponentë thelbësorë të rezistencës demokratike ndaj FIMI-t.

Digjitalizimi i proceseve zgjedhore dhe rreziqet ndaj manipulimit të informacionit

Digjitalizimi i proceseve zgjedhore në Shqipëri në ciklet e fundit zgjedhore ka përfshirë identifikimin elektronik të votuesve, administrimin digjital të listave zgjedhore, regjistrimin dhe votimin e diasporës, si dhe përdorimin e platformave online për raportimin financiar dhe menaxhimin e të dhënave nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Këto zhvillime synojnë rritjen e efikasitetit dhe integritetit të procesit zgjedhor, por njëkohësisht krijojnë edhe forma të reja vulnerabiliteti, veçanërisht në mungesë të auditimit të pavarur, transparencës dhe komunikimit të qartë publik mbi funksionimin dhe kufizimet e sistemeve digjitale.

Përdorimi i teknologjive zgjedhore në Shqipëri, përfshirë identifikimin biometrik, është menaxhuar përgjithësisht pa incidente që cenojnë rezultatin zgjedhor. Megjithatë, OSBE/ODIHR thekson se proceset teknologjike janë shoqëruar nga mungesë transparence mbi testimet e sigurisë, auditimet e pavarura dhe shpjegimin publik të mekanizmave mbrojtës, duke ndikuar në perceptimin e besueshmërisë së tyre nga një pjesë e elektoratit. Këto paqartësi teknike nuk përbëjnë domosdoshmëri të dobësi funksionale, por krijojnë hapësirë për

Digjitalizimi zgjedhor ecën më shpejt se mekanizmat e transparencës dhe mbikëqyrjes.

keqinterpretim, dyshim dhe instrumentalizim politik të teknologjisë zgjedhore.¹⁴⁹

Një element kyç në këtë kontekst është historiku i shkeljeve të të dhënave personale në Shqipëri.¹⁵⁰ Rrjedhjet e mëparshme të databazave shtetërore dhe keqpërdorimi i të dhënave të votuesve nga aktorët politikë kanë ndikuar në normalizimin shoqëror të shkeljeve të privatësisë dhe kanë ulur ndjeshmërinë publike ndaj rreziqeve që lidhen me përdorimin e të dhënave personale për qëllime politike. Ky historik i dokumentuar i keqpërdorimit të të dhënave personale krijon një sfond problematik mbi të cilin ndërtohen sot proceset e reja të digjitalizuara zgjedhore, duke e bërë më të vështirë ndërtimin e besimit publik edhe kur sistemet përfshijnë masa të avancuara sigurie.

Megjithëse Shqipëria ka miratuar një kuadër ligjor të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, të përafuar gjerësisht me standardet e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR) të Bashkimit Evropian, raportet e Komisionit Evropian dhe analizat e organizatave të shoqërisë civile theksojnë se zbatimi efektiv i këtij kuadri mbetet i dobët, ndërsa kapacitetet institucionale për mbikëqyrje, hetim dhe sanksionim janë të kufizuara.¹⁵¹ Udhëzimet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ekzistojnë në nivel normativ,¹⁵² por ndërgjegjësimi dhe respektimi i tyre nga institucionet publike dhe aktorët politikë mbeten të fragmentuara, veçanërisht në kontekste të ndjeshme si fushatat zgjedhore.¹⁵³ Raporte të pavarura mbi teknologjitë digjitale në ciklin zgjedhor nënvizojnë se digjitalizimi ka avancuar më shpejt sesa ndërtimi i mekanizmave të besueshëm për kontroll, transparencë dhe llogaridhënie mbi përdorimin e të dhënave.

Një faktor shtesë që amplifikon këtë vulnerabilitet është niveli i ulët i njohurive digjitale në segmente të ndryshme të shoqërisë, përfshirë votuesit, administratën publike dhe aktorët politikë.¹⁵⁴ Mungesa e njohurive bazë mbi funksionimin

¹⁴⁹ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary elections, 11 May 2025 – Final report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odhr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

¹⁵⁰ DCAF. (2024). *Accountability in cybersecurity* [Llogaridhënia në sigurinë kibernetike]. <https://www.dcaf.ch/accountability-cybersecurity>

¹⁵¹ Brojka, A. (2025). *Digital Technologies in the Election Cycle: The case of Albanian parliamentary elections in 2025* [Teknologjitë digjitale në ciklin zgjedhor: Rasti i zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri 2025]. Institute for Democracy and Mediation. https://idmalbania.org/wp-content/uploads/dlm_uploads/2025/09/Policy-Brief-Digital-Technologies-in-the-Election-Cycle.pdf

¹⁵² Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (IDP). (2024). *Udhëzues për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore*. https://www.idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Udhezues_Faqosur-4-prill.pdf

¹⁵³ Bojadzievska, I., Cabacenco, P., Ivasyk, S., & Reçi, M. (2025). *Navigating the EU digital regulatory framework – Part II* [Navigimi i kuadrit rregullator digjital të BE-së – Pjesa II]. International IDEA. <https://www.idea.int/sites/default/files/2025-10/navigating-eu-digital-regulatory-framework-part2.pdf>

¹⁵⁴ Likmeta, B., & Voko, K. (2025). *Monitoring Media Pluralism in the European Union: Results of the MPM2025 - Country report: Albania* [Monitorimi i Pluralizmit të Medias në Bashkimin Evropian: Rezultatet e MPM2025 – Raporti i Shqipërisë]. European University Institute, Centre for Media Pluralism and Media Freedom (CMPF). Florence. <https://cadmus.eui.eu/entities/publication/f5be0d78-00ae-4b29-aadb-b487390fcbf2>

e sistemeve digjitale dhe mbi të drejtat që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale rrit njëkohësisht skepticizmin dhe vulnerabilitetin ndaj narrativave dezinformuese.¹⁵⁵ Në një mjedis të tillë, edhe procese teknike të menaxhuara në mënyrë korrekte mund të portretizohen si të pasigurta ose të manipuluar, duke minuar besimin publik në integritetin e zgjedhjeve.

Në këtë kuadër, digjitalizimi i proceseve zgjedhore në Shqipëri përfaqëson një vulnerabilitet të dyfishtë: nga njëra anë, rrezikun teknik dhe institucional që lidhet me mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e sistemeve; dhe nga ana tjetër, rrezikun për keqinformim që buron nga mungesa e transparencës, historiku i shkeljeve dhe komunikimi i pamjaftueshëm publik. Ky kombinim krijon kushte të favorshme për amplifikimin e narrativave të frikës dhe delegitimimit të proceseve zgjedhore.

Në aspektin metodologjik, këto problematika janë të lidhura me **Mundësuesin 6. Ndjeshmëria e audiencës ndaj manipulimit, Mundësuesin 15. Boshllëqe në rregullimin e medias dhe internetit dhe Mundësuesin 16. Zbatim i paqartë i normave ndërkombëtare.**

Rast ilustrues: Platforma elektronike e raportimit financiar të shpenzimeve të fushatës zgjedhore

Për herë të parë në zgjedhjet vendore të 14 majit 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vuri në funksion **Platformën Elektronike të Raportimit Financiar** (PERF), përmes së cilës subjektet zgjedhore dhe kandidatët u detyruan të dorëzonin raportet financiare të fushatës në mënyrë digjitale. Kjo nismë u përshëndet gjerësisht si një hap i rëndësishëm drejt rritjes së transparencës dhe përmbushjes së angazhimeve afatgjata të KQZ-së për modernizimin e administrimit zgjedhor dhe përmirësimin e aksesit publik në të dhënat financiare të fushatave.

Platforma u konceptua si një mjet që jo vetëm standardizonte raportimin financiar, por gjithashtu u ofronte akses të drejtpërdrejtë gazetarëve, studiuesve dhe qytetarëve për të shqyrtuar deklaratimet financiare të subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve. Megjithatë, zbatimi praktik i saj nxori në pah një sërë problematikash strukturore. Ndërsa një pjesë e konsiderueshme e subjekteve dhe kandidatëve nuk dorëzuan raporte financiare, për ata që i dorëzuan, platforma nuk mundësonte shkarkimin e të dhënave në formate të përpunueshme. Raportet ishin të aksesueshme vetëm në format PDF, duke kufizuar ndjeshëm mundësinë për analiza krahasuese, përpunim statistikor dhe mbikëqyrje sistematike nga aktorë të pavarur. Për më tepër, dizajni i platformës lejonte që disa fusha të

¹⁵⁵ IDRA Research & Consulting & Communication Progress. (2024). *Assessing municipal and public e-readiness in Albania: National report* [Vlerësimi i gatishmërisë digjitale të bashkive dhe institucioneve publike në Shqipëri: Raporti kombëtar]. https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2024-09/dra_national_report_final_eng.pdf

rëndësishme të mbeteshin të paplotësuara ose të raportoheshin në mënyrë jo konsistente, pa sinjalizime automatike për mospërputhje apo mangësi.¹⁵⁶

Duke marrë parasysh këto kritika, KQZ-ja u angazhua të riformatonte platformën para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025, për ta përafuar me parimet e të dhënave të hapura dhe për të përmirësuar funksionalitetet për kërkim, filtrim dhe shkarkim të informacionit financiar. Megjithatë, këto përmirësime nuk u realizuan në kohë. Si pasojë, raportimi financiar për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025–me afat dorëzimi më 4 nëntor 2025–u krye sërish përmes versionit të vjetër të platformës.

Kjo situatë, jo vetëm riprodhoi problematikat e evidentuara në vitin 2023, por krijoi edhe vështirësi shtesë për transparencën dhe mbikëqyrjen. Publiku, gazetarët dhe studiuesit nuk patën akses në filtra specifike navigimi, apo mundësi për të kërkuar kandidatët sipas emrit në databazë, si dhe hasën vështirësi teknike në identifikimin e shpenzimeve të lidhura drejtpërdrejt me zgjedhjet e vitit 2025. Paralelisht, vetë subjektet zgjedhore dhe kandidatët raportuan vështirësi në përdorimin e sistemit, duke zgjedhur alternativa raportimi jashtë platformës digjitale.

Sipas të dhënave të ofruara nga KQZ-ja, nga 38 subjekte zgjedhore të regjistruara për zgjedhjet parlamentare të 2025-ës, raportet financiare u dorëzuan si vijon: 11 subjekte nëpërmjet platformës elektronike PERF, 20 subjekte përmes formatit standard të miratuar nga Komisioni Rregullator i Zgjedhjeve, ndërsa 7 subjekte nuk dorëzuan fare raport financiar në KQZ. Fakti që shumica e subjekteve nuk e përdorën platformën elektronike e dobësoi ndjeshëm funksionin e saj si instrument transparence dhe e kufizoi aftësinë e institucioneve, medias dhe shoqërisë civile për të ushtruar mbikëqyrje efektive mbi financimin e fushatës.

Ky rast ilustron se digjitalizimi, në mungesë të funksionalitetit të plotë, përdorshmërisë së gjerë dhe standardeve të të dhënave të hapura, mund të ofrojë vetëm transparencë formale. Pa investime të mjaftueshme në dizajn, testim, trajnime dhe komunikim publik, platformat digjitale rrezikojnë të thellojnë hendekun mes ambicieve institucionale dhe kontrollit real demokratik mbi proceset zgjedhore.

¹⁵⁶ Voko, K., Likmeta, B., & Erebara, G. (2025). *Analysis of the financial reports of electoral subjects on the 2023 electoral campaign* [Analiza e raporteve financiare të subjekteve zgjedhore mbi fushatën elektorale 2023]. BIRN Albania. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2025/01/Analysis-of-the-Financial-Reports-of-Electoral-Subjects-on-the-2023-Electoral-Campaign-.pdf>

Siguria kibernetike e infrastrukturës zgjedhore dhe ekspozimi ndaj sulmeve hibride

Dobësitë kibernetike rrisin cenueshmërinë e sistemeve zgjedhore.

Siguria kibernetike e infrastrukturës zgjedhore përbën një komponent kritik të integritetit të proceseve demokratike, veçanërisht në një kontekst ku proceset zgjedhore mbështeten gjithnjë e më shumë në sisteme digjitale për administrimin e të dhënave, komunikimin institucional dhe ofrimin e shërbimeve për votuesit. Në Shqipëri, kjo fushë është shoqëruar me rreziqe të shtuara gjatë vitit zgjedhor 2025, duke nxjerrë në pah vulnerabilitete strukturore në kapacitetet e parandalimit, reagimit dhe komunikimit publik përballë incidenteve kibernetike.

Gjatë fushatës për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve deklaroi se platformat e tij digjitale ishin objekt i sulmeve kibernetike¹⁵⁷. Sipas deklarimeve zyrtare të Kryekomisionerit, këto sulme synuan faqen zyrtare dhe disa sisteme mbështetëse, duke krijuar ndërprerje të përkohshme të aksesit dhe rritur nevojën për masa emergjente mbrojtëse. Edhe pse autoritetet theksuan se nuk kishte prova për komprometim të të dhënave zgjedhore apo manipulim të rezultateve, vetë fakti i sulmeve gjatë një periudhe kritike të ciklit zgjedhor ka rëndësi të veçantë për vlerësimin e riskut dhe perceptimit publik.

Raportet e pavarura vënë në dukje se incidente të tilla, edhe kur menaxhohen teknikisht pa pasoja direkte, kanë ndikim disproporcional në besimin publik. OSBE/ODIHR nënvizon se mungesa e informacionit të detajuar dhe e komunikimit proaktiv mbi natyrën e sulmeve, masat mbrojtëse dhe auditimet pas incidenteve krijon hapësirë për spekulime dhe narrativa dezinformuese mbi integritetin e proceseve zgjedhore¹⁵⁸. Në këtë kuptim, rreziku nuk kufizohet vetëm te dëmi teknik potencial, por shtrihet edhe në sferën e informacionit dhe perceptimit publik.

Vulnerabiliteti i sigurisë kibernetike duhet parë gjithashtu në dritën e kontekstit më të gjerë të kërcënimeve hibride ndaj institucioneve publike në Shqipëri. Sulmi i madh kibernetik i vitit 2022 ndaj sistemeve shtetërore, i atribuar aktorëve të huaj, ka ekspozuar dobësi strukturore në arkitekturën e sigurisë digjitale dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e ndjeshmërisë politike dhe shoqërore ndaj incidenteve të ngjashme. Edhe pse sulmet e raportuara ndaj Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vitin 2025 nuk janë zyrtarisht lidhur me aktorë të huaj, ato zhvillohen në një mjedis ku memoria institucionale dhe publike e sulmeve të mëparshme e amplifikon ndikimin e tyre simbolik.

Raportet e Komisionit Evropian dhe analizat e pavarura mbi qeverisjen digjitale

¹⁵⁷ Hoxhaj, E. (2025, 22 maj). Celibashi: Platformat e KQZ u përballën me sulme kibernetike gjatë zgjedhjeve. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2025/05/22/celibashi-platformat-e-kqz-u-perballen-me-sulme-kibernetike-gjate-zgjedhjeve/>

¹⁵⁸ OSCE/ODIHR. (2025). *Republic of Albania: Parliamentary elections, 11 May 2025 – Final report* [Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 – Raporti përfundimtar]. <https://odihr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

në Shqipëri theksojnë se, pavarësisht progresit normativ, siguria kibernetike mbetet e fragmentuar ndërmjet institucioneve, me nivele të pabarabarta gatishmërie dhe koordinimi.¹⁵⁹ Kapacitetet për reagim ndaj incidenteve, auditim të pavarur dhe transparencë pas sulmeve mbeten të kufizuara, veçanërisht në institucione që administrojnë procese të ndjeshme si zgjedhjet.¹⁶⁰ Këto dobësi rrisin rrezikun që incidentet kibernetike të shfrytëzohen nga aktorë të tretë për të prodhuar ose amplifikuar narrativa destabilizuese, edhe në mungesë të një komprometimi real të sistemeve.

Një element shtesë shqetësues lidhet me mungesën e protokolleve të qarta dhe të publikuara për komunikimin gjatë incidenteve kibernetike. Në rastin e sulmeve ndaj platformave zgjedhore në vitin 2025, informacioni i bërë publik ishte i kufizuar dhe i përgjithshëm, duke mos adresuar në mënyrë të plotë pyetje kyçe mbi shkallën e sulmeve, burimin e tyre të mundshëm dhe masat e marra për parandalimin e incidenteve të ngjashme në të ardhmen. Kjo qasje ndaj komunikimit publik dhe transparencës kontribuon në rritjen e pasigurisë informative dhe ul rezistencën institucionale ndaj manipulimit të perceptimit publik.

Në këtë kuadër, siguria kibernetike e infrastrukturës zgjedhore në Shqipëri përbën një vulnerabilitet të qartë ndaj ndërhyrjeve të huaja. Çdo incident (real ose i perceptuar) mund të shërbejë si katalizator për narrativa që vënë në dyshim integritetin e zgjedhjeve, besueshmërinë e institucioneve dhe legjitimitetin e rezultateve. Kjo përputhet me **Mundësuesin 15. Boshllëqe në rregullimin e medias dhe internetit**, si dhe lidhet ngushtë me **Mundësuesin 6. Ndjeshmëria e audiencës ndaj manipulimit**, duke qenë se incidentet kibernetike ndikojnë drejtpërdrejt në perceptimin publik dhe besimin në proceset digjitale zgjedhore.

¹⁵⁹ European Commission. (2025). *Albania report 2025 [Raporti për Shqipërinë 2025]*. Bruksel. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en

¹⁶⁰ Bojadzievska, I., Cabacenco, P., Ivasyk, S., & Reçi, M. (2025). *Navigating the EU digital regulatory framework – Part II [Navigimi i kuadrit rregullator digjital të BE-së – Pjesa II]*. International IDEA. <https://www.idea.int/sites/default/files/2025-10/navigating-eu-digital-regulatory-framework-part2.pdf>

PËRFUNDIME

Ky raport synoi të vlerësojë vulnerabilitetet strukturore të proceseve zgjedhore në Shqipëri që mund të shfrytëzohen për ndërhyrje dhe manipulim të mjedisit të informacionit gjatë ciklit zgjedhor. Duke u mbështetur në metodologjinë globale të International IDEA, analiza nuk synon të provojë/nuk provon praninë e ndërhyrjes së huaj në çdo rast konkret, por të identifikojë kushtet sistemike që e bëjnë një proces zgjedhor më të ekspozuar ndaj FIMI-t, qoftë nga aktorë të huaj, qoftë përmes rrjeteve ndërmjetëse vendase.

Gjetjet e raportit tregojnë se vulnerabilitetet e identifikuara gjatë zgjedhjeve parlamentare 2025 nuk janë episodike, por pjesë e një konfigurimi më të gjerë institucional, rregullator, mediatik dhe digjital që prodhon ekspozim të përsëritur ndaj manipulimit të informacionit. Në këtë kuptim, FIMI nuk shfaqet si një fenomen i jashtëm apo i importuar rastësisht, por si një rrezik që ndërvepron me dobësi të brendshme të sistemit.

Së pari, analiza tregon se integriteti zgjedhor në Shqipëri mbështetet në një arkitekturë normative që ofron parime formale, por jo gjithmonë mbrojtje efektive ndaj formave bashkëkohore të ndikimit informativ. Kuadri ligjor dhe rregullator, sidomos në fushën e financimit politik, reklamimit online, rolit të palëve të treta dhe transparencës digjitale, mbetet i papërgatitur për t'u përgjigjur ndaj problematikave të fushatave moderne dhe FIMI-t.

Së dyti, gjetjet konfirmojnë se paqëndrueshmëria rregullatore dhe reformat e vonshme gjatë ciklit zgjedhor rrisin pasigurinë, pabarazinë e garës dhe hapësirat për kontestim. Ndryshimet e minutës së fundit në rregullat e financimit, shpenzimeve dhe komunikimit zgjedhor nuk janë vetëm probleme të “ndershmërisë” klasike të garës, por edhe faktorë që rrisin vulnerabilitetin ndaj FIMI-t, duke e bërë mjedisin më të favorshëm për ndikim të fshehtë dhe për narrativa delegjtimuese.

Së treti, analiza tregon se transparenca financiare funksionon kryesisht si proces formal, jo si mekanizëm i vërtetë llogaridhënieje. Raportimi pas-zgjedhor, auditimi i vonuar dhe mungesa e sanksioneve dekurajuese krijojnë një situatë ku mosraportimi ose nën-raportimi nuk prodhon pasoja reale për subjektet zgjedhore apo kandidatët. Nga perspektiva e FIMI-t, kjo dobësi krijon hapësira për financime dhe shpenzime të paidentifikueshme, përfshirë shpenzime digjitale, dhe prodhon terren narrativ për akuza dhe kontestime mbi “para të errëta” dhe manipulim zgjedhor.

Së katërti, mjedisi mediatik dhe digjital rezulton i fragmentuar, i polarizuar dhe ekonomikisht i ndjeshëm dhe i orientuar ndaj logjikës së vëmendjes, duke amplifikuar ndikimin e përmbajtjeve emocionale, antagoniste ose manipuluese. Mungesa e rregullimit për reklamën politike online, roli i palëve të treta, faqeve “surrogate” dhe përdorimi i influencerëve dhe rrjeteve ndërmjetëse e zbehin kufirin midis komunikimit politik transparent dhe ndikimit të maskuar.

Së fundi, dimensionin ndërkufitar—përmes fushatave që shënjestrojnë diasporën apo lobimit jashtë vendit—rezulton një nga aspektet më pak të rregulluara dhe njëkohësisht më të ndjeshme. Këto praktika tregojnë se ndikimi politik nuk kufizohet më brenda juridiksionit kombëtar dhe se mungesa e transparencës në këto zona të parregulluara krijon rreziqe të shtuara për FIMI-n.

Në tërësi, gjetjet e raportit tregojnë se një pjesë domethënëse e mundësuesve dhe nxitësve kyç të metodologjisë globale së International IDEA ishin të pranishëm gjatë ciklit zgjedhor të vitit 2025, duke përfshirë:


- mundësuesit institucionalë dhe rregullatorë si mungesa e besimit në institucione, rregullimi i pamjaftueshëm për financimin politik, autoritete rregullatore jo plotësisht efektive;
- mundësuesit e lidhur me mjedisin shoqëror dhe politik, si polarizimi, diskursi antagonizues dhe ndjeshmëria e audiencës ndaj manipulimit;
- mundësuesit mediatikë, përfshirë mungesën e pluralizmit, standardet e dobëta profesionale dhe rënien e besimit te burimet kryesore të lajmeve;
- mundësuesit digjitalë, si fragmentimi i mjedisit informativ, shfrytëzimi abuziv i platformave dhe politikat e paqëndrueshme të moderimit;
- mundësuesit ligjorë dhe ndërkombëtarë, veçanërisht boshllëqet në rregullimin e medias/internetit dhe zbatimin e paqartë të normave ndërkombëtare dhe të BE-së;
- nxitësit ekonomikë të ekonomisë së vëmendjes, ku modeli i biznesit i medias dhe tregu i reklamimit politik online shpërblejnë përmbajtjen polarizuese dhe me angazhim të lartë;
- aksesin në burime ndërkufitare, përfshirë financimin, informacionin dhe shërbimet profesionale të ndikimit; dhe
- industrinë e manipulimit të informacionit, ku shërbime të dedikuara (PR, lobim, marketing politik dhe digjital) mund të përdoren për të prodhuar dhe amplifikuar narrativa të caktuara.

Kjo tregon se ekspozimi ndaj FIMI-t nuk lidhet me një vulnerabilitet të vetëm, por me ndërveprimin kumulativ të shumë mundësuesve dhe nxitësve, të shpërndarë në fusha të ndryshme të sistemit vendas, të cilët riprodhohen nga një cikël zgjedhor në tjetrin.

Në përmbledhje, gjetjet e këtij raporti tregojnë se rezilienca zgjedhore në Shqipëri mbetet e pjesshme. Sistemi ofron pengesa formale ndaj shkeljeve klasike, ndërsa është më pak i përgatitur për format hibride të ndikimit që kombinojnë financim jo-transparent, amplifikim digjital, ndërmjetësim narrativ dhe veprim ndërkufitar.

Në këtë kontekst, FIMI nuk duhet parë si një kërcënim i jashtëm i shkëputur nga realiteti vendas, por si një fenomen që shfrytëzon boshllëqe ekzistuese, i përforcuar nga polarizimi politik, nga ekonomia e vëmendjes dhe nga mungesa e përputhjes me standardet evropiane të rregullimit digjital.

Këto përfundime mund të shërbejnë për të informuar diskutime të mëtejshme mbi mënyrat se si rezilienca demokratike mund të forcohet—jo vetëm përmes reformave ligjore, por edhe përmes zbatimit efektiv, transparencës së mirëfilltë dhe rritjes së kapaciteteve institucionale dhe shoqërore për të përballuar manipulimin informativ në zgjedhjet e ardhshme.



ZGJEDHJET 2025 NË SHQIPËRI: VULNERABILITETET NDAJ NDËRHJRJEVE TË HUAJA DHE MANIPULIMIT TË INFORMACIONIT

